



RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR PËR PROJEKTIN
“NDERTIMI I BY-PASS-eve FIER & VLORË ”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI PËRPUTHSHMËRINË
E PROJEKTIT
“NDERTIMI I BY-PASS-eve FIER & VLORË”
NË
AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR

QERSHOR 2022

Përmbajtja	faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	12
II. HYRJA	14
1. Objekti i auditimit.....	14
2. Qëllimi i auditimit	14
3. Identifikimi i çështjes:	14
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:	14
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	15
6. Kriteret e vlerësimit.....	15
7. Standardet e auditimit.....	15
8. Metodatat e auditimit.....	15
9. Dokumentimi i auditimit	16
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	17
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM	17
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT	18
2.1 Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve dhe raportimi i tyre.....	18
2.2 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësin.	28
2.3 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimin e fondeve publike.....	32
2.4 Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.....	36
2.5 Mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe realizimin e punimeve civile.	60
2.6 Mbi administrimin e veprave të përfunduara.	81
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	84
V. ANEKSE	96

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi në Autoritetin Rrugor Shqiptar, zyrën e PMU, Projektin “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale” në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr.7/1 datë 18.01.2022, me afat auditimi nga data 18.01.2022 deri me datë 22.04.2022, për periudhën nga fillimi i Projektit deri më 31.12.2021. Konkretisht u audituan marrëveshjet financiare dhe ndryshimet e tyre, shkalla e arritjes së objektivave dhe komponentëve të Programit, menaxhimi financiar i Projektit, shkalla e realizimit të disbursimeve financiare kundrejt atyre të programuara dhe raportimi i tyre në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe zbatimi i kontratave në drejtim të realizimit të punimeve. Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 8 akte të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda afatit të periudhës së auditimit datë 22.04.2022. Me shkresat e protokolluar në KLSH me nr.7/5 datë 10.05.2022, nr.7/6 datë 10.05.2022, 7/7 datë 10.05.2022, nr.7/8 datë 11.05.2022, 7/9 datë 11.05.2022, nr.7/10 datë 11.05.2022, 7/11 datë 12.05.2022, nr.7/12 datë 16.05.2022, 7/13 datë 16.05.2022, nga subjekti janë paraqitur observacionet e akteve të mbajtura. Me shkresën nr. 7/14 datë 18.05.2022 është dërguar Projektraporti i Auditimit dhe me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 7/15 prot. datë 23.05.2022 subjekti i auditimit ka paraqitur observacione për Projektraportin, ku pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga ana e grupit të auditimit të KLSH, u morën në konsideratë ato raste për të cilat kishin mbështetje ligjore me dokumentacion, ndërsa rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentin e duhur ligjor, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për marrjen e masave në përmirësimin e punës. Për sa i takon Takimit Përmbyllës, midis niveleve drejtuese të KLSH-së, grupit të auditimit dhe subjektit të audituar, është njoftuar me e-mail datë 20.06.2022 personi i kontaktit për projektin dhe në vijim po me email datë 21.06.2022 është konfirmuar se ky takim nuk do të zhvillohet pasi nga ana e subjektit nuk është vlerësuar e arsyeshme.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Sipas nenit 2 të Marrëveshjes data e fundit e disponueshërisë së kredisë është 30.04.2015. Nga auditimi rezulton se me shkresën nr.9280/1.prot, date 23/06/2015 Ministri i Financave i ka kërkuar përfaqësuesit të BERZH shtyrja e afatit të kredisë deri në 2017 me argumentin se sipas marrëveshjes, Data e Fundit e Disponueshmërisë së Transhit A të Huasë, është data 30 prill 2015. Fillimi i zbatimit të pjesës së projektit që lidhet me ndërtimin e Bypass – it të Fierit, pjesë e cila financohet nëpërmjet Transhit A të Huas, ka hasur vonesa të ndryshme. Për rrjedhojë kontrata përkatëse e punimeve e lidhur në muajin Maj 2013 përfundon në muajin Shkurt 2017 (duke përfshirë edhe periudhën e garancisë së defekteve). Mbështetur në sa më sipër Ministri i Financave ka kërkuar shtyrjen e Datës së Fundit të Disponueshmërisë së Transhit A të Huas deri në 30 prill 2017.			

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p><i>Deri në përfundim të auditimit nuk u paraqit ndonjë dokument që vërteton se kur është aprovuar shtyrja e afatit nga BERZH. Nga ana e ARRSH dhe Ministrisë së Financave nuk janë marrë masat e nevojshme për zgjatjen e afatit të disbursimit të projektit në kohë duke vendosur në pasigurinë e vazhdimet të disbursimit.</i></p> <p>- Me Amendamentin Nr.1, datë 14.02.2019, e cila është përcjell me shkresë nr. 149/5, datë 11.07.2019, është miratuar afati i fundit për kryerjen e disbursimeve për transhin A të marrëveshjes së huasë datën 31 Janar 2021. <i>Nga auditimi konstatohet se ka një periudhë prej 21 muajsh pa marrë miratimin e shtyrjes së disbursimeve.</i></p> <p>ARRSH ka një korrespondencë të vazhdueshme me Ministrinë ku ka kërkuar kryerjen e procedurave për zgjatjen e afatit të disbursimeve por referuar amendamentit, Ministria e ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të disbursimeve në 26.12.2018 (19 muaj më vonë nga kërkesa e parë e ARRSH) në kundërshtim me Ligjin e Marrëveshjes.</p> <p>Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur asnjë kërkesë për disbursime dhe nuk është kryer asnjë disbursim nga ARRSH pasi kompania e ndërtimit ka ndërprerë punimet “S..... Co..... Spa” dhe ARRSH është duke zhvilluar procedurën e ritenderimit.</p> <p>- Me Amendamentin nr. 2, datë 26.11.2021 (Vendimi i KM nr. 444, datë 22.07.2021) është shtyrë afati i disbursimeve deri në 30.06.2022. Referuar shkresës së disbursimit Ministria e Financave i është drejtuar BERZH në 12.04.2021 ose 6 muaj më vonë se ARRSH ka paraqitur kërkesën e saj. (Me shkresën nr. 7721, datë 14.10.2020 ARRSH ka kërkuar shtyrje të afatit të kredisë së BERZH deri në 30.06.2022).</p> <p>Mosamendimi i marrëveshjes brenda afateve të përcaktuara është në kundërshtime me nenin 2 të ligjit nr. 8/2012, datë 09.02.2012 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)”</p>	Faqe 18-28	E LARTË	ARRSH në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (ministria e linjës) dhe Ministrinë e Financave (si përfaqësuese e huamarrësit) të marrin masa që të bashkërendojnë punën dhe në çdo rast të kryejnë kërkesat për amendimin e marrëveshjeve të huave brenda afateve të marrëveshjeve duke ulur riskun e ndërprerjes së financimit.
2.	<p>Nga auditimi rezulton se nuk është realizuar objektivi i përgjithshëm i marrëveshjeve të financimit:</p> <p>a. Ndërtimi i një by passi 22 km në qytetin e Fierit i cili referuar kontratës së punimeve civile për By Passin e Fierit punimet duhet të kishin përfunduar brenda datës 03.06.2018, por afati është shtyrë disa herë dukë sjellë si pasojë shtyrjen në kohë të</p>			

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>arritjes së objektivave dhe përfitimeve nga zbatimi i këtij projekti.</p> <p>b. Ndërtimi i një by passi 29 km në qytetin e Vlorës, i cili referuar kontratës së punimeve civile për By Passin e Vlorës, punimet duhet të kishin përfunduar në 30.06.2018, por afati është shtyrë, duke sjellë si pasojë shtyrjen në kohë të arritjes së objektivave dhe përfitimeve nga zbatimi i këtij projekti.</p> <p>Nevoja për shtyrjen e afateve është argumentuar me problematikat që lidhen kryesisht me shpronësimet për pronat ku kalon gjurma e projektit, si dhe mos bashkëpunimi i Bashkisë Vlorë në lidhje me pajisjen me dokumentacionin e pronësisë për banorët që preken nga ndërtimi i By-Pass-it të Vlorës, problemeve ligjore me kontraktorin "S.....", si dhe mungesa e financimit për By Passin e Fierit nga BEI si pasojë e vonesave të shkaktuara nga Qeveria Shqiptare për shtyrjen e marrëveshjes së financimit, veprime të cilat kanë dhënë ndikim negativ për të gjithë projektin. Gjithashtu si pasojë e problematikave të hasura dhe vonesave në zbatimin e projektit nga ana e kontraktorit të punimeve mund të ngrihet pretendimi për llogaritje (claim) në të ardhmen pasi disa prej vonesave janë si pasojë e kontraktuesit. Sa më lart është në kundërshtim me Ligjin Nr.8/2012, datë 09.02.2012 "Marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)", Ligjin nr. 80/2012 "Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)"; Ligjin nr. 109/2014 datë 31.07.2014 "Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By-Passin e Vlorës" dhe kontratat e zbatimit të punimeve nr. 9946 datë 08.11.2018, appendix to tender; nr. 9719 datë 05.11.2018, appendix to tender.</p>	Faqe 28-32	E LARTË	ARRSH të marrë masa që për projektet në proces si dhe për projekte që do të financohen në të ardhmen, të zbatohen me korrektësi detyrimet kontraktore, duke zgjidhur praktikisht çështjet që kanë të bëjnë me shpronësimin për interes publik, problematika të cilat kanë lidhje me administrimin e pushtetit vendor, ndikimin në mjedis, si dhe problematika të cilat kanë lidhje me shtyrjen në kohë të afatit të disbursimeve etj., me synim minimizimin e riskut të vonesave, të cilat shoqërohen me mos arritjen e objektivave dhe kosto shtesë për Projektin.
3.	<p>Nga auditimi i nivelit të disbursimeve deri më datë 31.12.2021, të Projektit "Ndërtimi i By-pass-ëve Fier-Vlorë"konstatohet se, për përfundimin e tij do të duhen fonde shtesë në shumën totale 2,834,313.02 euro konkretisht:</p> <p>a) Për përfundimin e kontratës së ndërtimit të punimeve të by-pass-it të Vlorës do të nevojiten fonde shtesë në shumën 2,195,593.08 euro. Konkretisht për realizimin e kësaj kontrate financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 53,000,000 euro nga të cilat është disbursuar shuma 41,114,098.94 euro ose në masën 77.5%. Nga ky fond mbetet për t'u</p>	Faqe 36-60	E LARTË	ARRSH në rolin e Njësisë së Zbatimit të Projektit të informojë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për sigurimin e fondeve shtesë për përfundimin e Projektit me qëllim shmangien e riskut për ndërprerjen e punimeve.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>disbursuar shuma 11,885,901 euro ndërkohë që për përfundimin e kësaj kontrate duhen fonde në shumën 14,081,494.08 euro. Për financimin e kontratës së supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 700,000 euro gjithashtu me amendimet e kontratës ka pasur edhe mbështetje buxhetore në shumën 3,158,500 euro ku totali i financimit shkon në shumën 3,858,500 euro nga të cilat është disbursuar shuma 3,126,585 euro ose më masën 81%. Nga ky fond mbetet për t'u disbursuar shuma 731,915 euro.</p> <p>b) Për përfundimin e kontratës së ndërtimit të punimeve të by-pass-it të Fierit do të nevojiten fonde shtesë në shumën 224,062.34 euro. Konkretisht për realizimin e kësaj kontrate financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 70,000,000 euro nga të cilat është disbursuar shuma 68,562,437 euro ose në masën 97.9%. Nga ky fond mbetet për t'u disbursuar shuma 1,437,563euro ndërkohë që për përfundimin e kësaj kontrate duhen fonde në shumën 1,661,625.34 euro. Për financimin e kontratës së supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 858,210 euro gjithashtu me amendimet e kontratës ka pasur edhe mbështetje buxhetore në shumën 1,621,959. euro ku totali i financimit shkon në shumën 2,480,169.4 euro nga të cilat është disbursuar shuma 2,480,169.4 euro ose më masën 10%. Nga ky fond mbetet për t'u disbursuar shuma 414,657.6 euro. Në lidhje me këtë situatë është parashikuar në marrëveshjet e financimit në rast se do të duhen vonde shtesë për përfundimin e Projektit do të mbulohen me financim nga Qeveria Shqiptare. Gjithashtu kjo situata ka ardhur si pasojë edhe e ndërprerjes së punimeve nga OE “S..... C..... S.p.A”.</p>			
4.	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, si pasojë e pezullimit të punimeve nga OE “S..... C..... S.p.A” dhe lidhja e kontratave të reja për ndërtimin e punimeve, ka çuar mos përfundimin brenda afateve të parashikuara në marrëveshjet e financimit duke shtyrë njëkohësisht në kohë edhe afatet e përfundimit të kontratave të mbikëqyrjes së punimeve duke krijuar një kosto shtesë për Projektin në shumën totale 3,516,301 euro konkretisht: a) Për realizimin e komponentit “Punime dhe mbikëqyrje e punimeve të by-pass-it të Vlorës” midis KE dhe Shoqërisë “E..... O....” S.a është lidhur kontrata nr. 2013/332-025, datë 22.11.2013, me vlerë fillestare 1,663,300euro pa</p>	Faqe 36-60	E LARTË	<p>Nga ARRSH të merren masat për përfundimin e punimeve në afatet e përcaktuara, me qëllim eliminimin e rritjes së vlerës së kontratave të konsulentit, të cilat janë rritur me 3,516,301 euro, si edhe në të ardhmen për projektet me financime të huaja të zbatojnë me korrektësi afatet kohore për realizimin e projekteve sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet financiare.</p>

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>TVSH dhe me vlerë të amenduar 3,858,500 euro pa TVSH. Me amendimin nr. 6, datë 14.09.2021, nr. 2013/332-025/ 2018/401-331, është shtyrë afati i disbursimit deri më datën 15.10.2023, me 22.5 muaj si dhe është amenduar vlera e kontratës prej një shtese në shumën 700,000 euro nga Qeveria Shqiptare, ku vlera e kontratës shkon 3,858,500 ose 1,493,500 euro nga parashikimi i financimit në marrëveshjen e Grantit (3,858,500 euro - 2,365,000 euro = 1,493,500 euro) si pasojë e shtyrjes së afatit të punimeve, vlerë e cila përbën kosto shtesë për Projektin. b) Për realizimin e komponentit “Punime dhe mbikëqyrje e punimeve të by-pass-it të Fierit” midis ARRSH dhe BOE “S..... srl & SWS C..... E..... srl & T..... spa” është lidhur kontrata më datë 21.07.2010, me vlerë fillestare 715,800 euro pa TVSH dhe me vlerë të amenduar 2,894,827 euro pa TVSH. Shtyrja e afatit të kontratës së konsulentit është shoqëruar me shtesë së vlerës së saj (me 7 shtesa kontrate) duke bërë që vlera e rishikuar të jetë 2,881,011 euro pa TVSH ose 2,165,211 Euro më shumë se vlera fillestare. Shtesa e kontratës së konsulencës dhe mbikëqyrjes ka sjell një kosto shtesë për buxhetin e Projektit në shumën 2,022,801 euro. Shuma 858,210 euro është mbuluar me financim nga Coperacione italiane dhe shuma 2,022,801 euro nga Qeveria Shqiptare.</p>			
5.	<p>Marrja në dorëzim e aksit kryesor të “By-pass-it të Fierit” nga Autoriteti Rrugor Shqiptar është kryer nëpërmjet procesverbalit të datës 19.07.2021, i mbajtur ndërmjet Komisionit të Marrjes në Dorëzim i ngritur në zbatim të urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së me shkresën nr. 7259/1 prot., datë 20.11.2014, dhe OE “C..... G..... C..... Co” së bashku me Supervizorin e Punimeve J.V “S.....-T.....-SWS”. Deri më datë 31.12.2021, datë e cila përkon me fundin e vitit ushtrimor 2021, nga ARRSH nuk është bërë regjistrimi si aset të “Rrugës kryesore të by-pass-it të Fierit” në regjistrat e kontabilitet me veprim ekstra kontabël në momentin e marrjes në dorëzim referuar procesverbalit të datë 19.07.2021, dhe duke u bazuar në këtë regjistrim fillestar të kryhet regjistrimi përfundimtar në pasqyrat financiare të vitit 2021. Gjithashtu ky regjistrim nuk është kryer as në program financiar në kushtet kur nga ARRSH nuk disponohet program financiar për mbajtjen e kontabilitetit. Regjistrimi si aset është i domosdoshëm që nga momenti në të cilën fillon jetën e dobishme aktivi si dhe llogaritja e amortizimit që nga momenti vendosjes në funksion (vlerë e cila mund të përlllogaritet deri në mbylljen</p>	Faqe 86-89	E LARTË	ARRSH / Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrë masa që, të kryej regjistrimin e asetëve të përfunduara të Projektit në regjistrat e kontabilitetit me veprim ekstra kontabël në momentin e marrjes së dorëzimit prej saj me qëllim përlllogaritjen e amortizimit në momentin në të cilën fillon jetën e dobishme aktivi dhe më pas të kryhet regjistrimi në pasqyrat financiare sipas vitit ushtrimor përkatës.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	e pasqyrave financiare). Ky regjistrim është kryer në muajin mars periudhë në të cilën përfundon afati për mbylljen e pasqyrave financiare për vitin 2021, të cilat janë depozituar pranë MIE dhe MFE me shkresën nr. 4094 prot., datë 29.03.2022.			
6.	Në kontratën me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Vlorë”, për periudhën objekt auditimi u konstatuan se, nga ana e punëdhënësit janë miratuar 26 (njëzetë e gjashtë) Urdhër Ndryshime por në disa prej tyre ka patuar vonesa në miratimin e tyre të cilat ndikojnë në realizimin e projektit në kohë dhe me cilësi. Konkretisht, urdhër ndryshimi nr.2 (VO.2) miratuar nga supervizori, Nr. 1174 datë 02.04.2020 është miratuar afërsisht pas 5 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr.51, datë. 25.11.2019, urdhër ndryshimi nr.6 (VO.6) miratuar nga supervizori, Nr. 1031 datë 13.02.2020 është miratuar afërsisht pas 4 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr.28, datë 03.06.2020, urdhër ndryshimi nr.8 (VO.8) miratuar nga supervizori Nr. 1174 datë 02.04.2020 është miratuar afërsisht pas 2 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr. 28, datë 03.06.2020, urdhër ndryshimi nr.10 (VO.10) miratuar nga supervizori Nr. 1266 datë 30.04.202 është miratuar afërsisht pas 1,5 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr. 28, datë 03.06.2020. Për sa më sipër, vonesat në miratimin e urdhër ndryshimeve nga ana e Këshillit Teknik, ndikojnë në realizimin e punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Këto vonesa nuk bëjnë të mundur përfundimin e projektit sipas ligjit nr. 80/2012 datë 13.09.2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)” neni 6, pika 6.02“Përmbushja e projektit” dhe kontratës së zbatimit të punimeve nr. 9719 prot. datë 05.11.2018. “Kushte të Përgjithshme të Kontratës” nën klauzola 1.1.3.3 “Koha e përfundimit” (Time for Completion).	Faqe 60-86	E LARTË	ARrSh të marri masa për shmangen e vonesave në miratimin e urdhër ndryshimeve duke përcaktuar afate kohore për miratimin e tyre nga të gjitha shkallët dhe ana e Këshillit Teknik në një kohë sa më optimale, për realizimin e projekteve sipas afateve të përcaktuara në kontratat e tyre.
7.	Në objektin “Ndërtimi i By-Pass-it Fier”, sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe OE “C.....G.....C”-K..... me nr. 9719 datë 05.11.2018, për zbatimin e punimeve civile, me vlerë me vlerë 37,944,221.56 Euro pa TVSH, me afat përfundimi të punimeve 455 ditë, realizimi i punimeve civile deri në fund të periudhës së audituar është në masën 99%. Nga auditimi i dokumentacionit dhe verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (mbikëqyrësi i punimeve)rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm (IPC nr. 27) volume pune	Faqe 60-86	E LARTË	Nga ana e ARrSh të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 8,348.38 Euro pa TVSH ndaj sipërmarrësit OE “C....G...C”-K....., për punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve, të

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>të pasqyruara në librezat e masave dhe të situacionuara por të pakryera në fakt, për 3 (tre) zëra punimesh, në shumën 8,348.38 Euro pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 21.07.2010.</p>			<p>lidhur sipas aktit me nr. 9719 datë 05.11.2018 me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Fier”.</p>
8.	<p>Në objektin “Ndërtimi i By-Pass-it Vlorë”, sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe BOE "G @" Shpk & "I..... di C..... Ing. E. M....." me nr. 9946 datë 08.11.2018, për zbatimin e punimeve civile, me vlerë me vlerë 35,874,357.4 Euro pa TVSH, me afat përfundimi të punimeve 823 ditë, realizimi i punimeve civile deri në fund të periudhës së audituar është në masën 92%. Nga auditimi i dokumentacionit dhe verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (mbikëqyrësi i punimeve)rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm (IPC nr. 13) volume pune të pasqyruara në librezat e masave dhe të situacionuara por të pakryera në fakt deri në këtë fazë të projektit, për 2 (dy) zëra punimesh, në shumën 59,904 Euro pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 22.11.2013, Kreu, “Detyrimet e kontraktuesit” shtojca 1 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, neni 7, “Detyrime të Përgjithshme”, pika 7.4, Shtesa e kontratës Nr. 5 datë 12.11.2018 artikulli 4, “Qëllimi i punimeve” “Scope of Work” pika 4.2.2.</p>	<p>Faqe 60-86</p>	<p>E LARTË</p>	<p>ARrSh dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa për reflektimin e volumeve të punimeve të situacionuara por të pa kryera në fakt, në situacionin pasardhës deri në atë përfundimtar në vlerën 59,904 Euro pa TVSH e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit deri në këtë fazë të projektit, të përfituara më tepër nga sipërmarrësi i punimeve sipas kontratës nr. 9946 datë 08.11.2018. Në rast se këto reflektime nuk kryhen deri në situacionin përfundimtar ana e ARrSh të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës.</p>
9.	<p>Në kontratën me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Fier” është miratuar me Urdhër Ndryshimin nr.1 (VO.1) kërkesa e punëdhënësit, operim pjesor për trafik. Me letrën Nr. 1871 Prot, datë 25.02.2019,</p>			

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>“Operim pjesor për trafik” ARRSH i kërkon supervizorit të udhëzojë kontraktorin të marri masa për rishikimin e grafikut të punimeve që të bëjë të mundur funksionimin e njërën krah të By-Pass-it të Fierit deri në Qershor 2019. Kjo për të evituar trafikun gjatë sezonit turistik. Gjithashtu nga ana e punëdhënësit, në këtë letër, kërkohet që kontraktori të përgatisë një plan për menaxhimin e trafikut. Referuar nën-klauzolës 3.3 “Udhëzimet e inxhinierit” (Instructions of the Engineer) me letrën Prot.AL/FI-LE/048/19 datë 26.02.2019 ka urdhëruar kontraktorin të marri masa për këto ndryshime në përputhje me nën-klauzolën 13.3 “Procedurat e ndryshimit”(Variation Procedure). Kontraktori me letrën A-59 datë 12.03.2019 “Operim pjesor për trafik” krahas miratimeve që kërkohen për materiale në pikën 3, “Kosto shtesë për përfundimin e kontratës në prezencë trafiku”, thekson se operimi pjesor i trafikut do të ketë efekte në aktivitet e mbetura të kontraktorit për përfundimin e kontratës. Gjithashtu, kontraktori thekson se, zona e punimit do të jetë e reduktuar, pjesë të aktivitetit duhet të modifikohen dhe do të kërkohen masa për mirëmbajtjen e rrugës. Në VO. 1 është miratuar edhe zëri “Plani i menaxhimit të trafikut” me kosto totale 297,868.20 Euro i cili ka ardhur si rezultat i kërkesës së ARRSH Nr. 1871 Prot, datë 25.02.2019, “Operim pjesor për trafik”. Zëri, “Plani i menaxhimit të trafikut” nuk është në funksion ose i lidhur me zërat e tjerë të parashikuar në kontratën e lidhur midis ARRSH dhe “C..G..C”-K..., nr. 9719 datë 05.11.2018 si dhe në marrëveshjen financiare të ratifikuar me ligjin nr. 80/2012 datë 13.09.2012. ARRSH me letrën Nr. 3711/1 datë 12.06.2019 ka njoftuar miratimin e VO.1 në parim sipas Vendim të Këshillit Teknik Nr.19, datë. 10/06/2019, si dhe miratimi (no-objection) nga BERZH është më datë 12.11.2019. Referuar punimeve shtesë, që do të kryhen sipas ndryshimeve të miratuara në VO. 1, me VO. 1.1 është miratuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve me 122 ditë, me kosto totale shtesë 334,876.83 Euro ku nga këto 67 ditë shtohen si rezultat i miratimit të zërit “Plani i menaxhimit të trafikut. Për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 67 ditë si rezultat i kërkesës së ARRSH-së për “Operim pjesor për trafik” ka kosto shtesë në vlerë 244,476.33 Euro. Pra, për sa më sipër, vlera e projektit nga kërkesa e punëdhënësit, për “Operim pjesor për trafik”, është rritur në total me (297,868.20 Euro+244,476.33 Euro) 542,344.53 Euro pa TVSH. Në urdhër ndryshimin nr.4 VO.4 është miratuar edhe kërkesa e Bashkisë</p>	<p>Faqe 60-86</p>	<p>E LARTË</p>	<p>ARRSH të marri masa që në të ardhmen, për Projektet në proces dhe të reja, të mos miratojë ndryshime, që nuk janë të lidhura me zbatimin teknik të punimeve dhe të pa parashikuar në objektivat e financimit, që risin koston e tyre.</p>

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>Fier me Nr. 9363 Prot. datë 13.11.2019 për rehabilitimi e rrugës hyrëse në perëndim të Fierit me vlerë totale 116,640 Euro. Nga ana e ARRSH-së rehabilitimi i rrugës hyrëse me fondet e projektit është bërë me Vendimin e Këshillit Teknik Nr.36 datë 20.07.2020 si dhe miratimi (no-objection) nga BERZH është më datë 08.09.2020. Bashkia Fier si pronare e rrugës duhet ta riparonte atë me financime të tjera pa u prekur fondet e projektit pasi në asnjë pikë të specifikimeve të projektit nuk përcaktohet rehabilitimi i rrugëve dytësore (lidhëse) me rrugën në ndërtim. Pra, për sa më sipër, vlera e projektit nga kërkesa e Bashkisë Fier, për rehabilitimin e rrugës hyrëse, është rritur me 116,640 Euro pa TVSH. Pra në total vlera e rritur e projektit është 658,984.53 Euro e cila konsiderohet shpenzim pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve të projektit. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 80/2012 datë 13.09.2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)” neni 6, pika 6.02 ‘Përbushja e projektit’, dhekontratën e zbatimit të punimeve nr. 9719 prot. datë 05.11.2018.</p>			
10.	<p>ARRSH me Nr.5349/1, datë 08.06.2021 ka përcjellë te Supervizori kërkesa e Policisë së Shtetit Nr.1097/8, datë 02.06.2021 në të cilën kërkohet mbështetja e MIE dhe ARRSH për përdorimin e aksit të By-Pass-it të Vlorës gjatë sezonit turistik Korrik-Shtator 2021. Supervizori bazuar në klauzolën 13.3 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, “Procedurat e ndryshimit”(Variation Procedure), me shkresën Nr.2206, datë 10 Qershor 2021 instrukttoi Kontraktorin të prezantojë një propozim gjithëpërfshirës me synimin që Supervizori të bëjë vlerësimin e kushteve nën të cilat mund të përdoret gjurma e By-Pass-it për kalimin e trafikut gjatë sezonit veror. Vlerësimi i kontraktorit për punime shtesë, për hapjen e trafikut gjatë sezonit turistik, është 1,000,000 Euro ku në të përfshihen dhe punime përfundimtare të cilat janë pjesë e kontratës. Duke zbritur këto punime përfundimtare vlera e kostos shtesë është afërsisht 700,000 Euro. Pas vlerësimit të propozimit të kontraktorit për hapjen e trafikut gjatë sezonit turistik në By-Pass-in e Vlorës supervizori ka paraqitur për miratim këtë urdhër ndryshim me vlerë 440,485.01 Euro tek punëdhënësi pasi vlera e saj e kalon 1% të vlerës së kontratës. Autoriteti Kontraktor (ARRSh) me Vendimin e Këshillit Teknik Nr. 24 datë 08.07.2021 ka miratuar në parim planin e menaxhimit të trafikut, sinjalistikën vertikale</p>	<p>Faqe 60-86</p>	<p>E LARTË</p>	<p>ARRSH të marri masa që në të ardhmen, për Projektet në proces dhe të reja, të mos miratojë ndryshime, që nuk janë të lidhura me zbatimin teknik të punimeve dhe të pa parashikuar në objektivat e financimit, që risin koston e tyre dhe gjithashtu të marri masa për krijim e kushteve që punimet të mbarojnë sipas afateve kontraktuale duke shmangur një hapje tjetër provizore e cila rrit edhe më shumë kostot e projektit.</p>

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>provizore si dhe masat e sigurisë duke vlerësuar një kosto përfundimtare pas vlerësimit dhe saktësisht të volume të punimeve shtesë për hapjen e trafikut. Hapja e trafikut ka sjell reduktimin e punimeve të kontraktorit e cila sipas tij do të kërkojë një shtyrje afati prej 77 ditë të përfundimit të kontratës e për rrjedhojë do të shoqërohet me kosto shtesë për zërat e përgjithshëm të saj (garancia e punimeve, menaxhimi i projektit etj.) si dhe kosto shtesë për supervizionimin e punimeve. Vlera prej 440,485.01 Euro pa TVSH e miratuar për hapjen e trafikut gjatë sezonit veror, përbën rritje të kostos së projektin e By-Pass-it Vlorë dhe nga grupi i auditimit konsiderohet shpenzim i fondeve të projektit pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 109/2014 datë 31.07.2014 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By Pass-in e Vlorës” neni 6, pika 6.02 si dhe kontratën e zbatimit të punimeve nr. 9946 prot. datë 08.11.2018.</p>			

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së projektit “Ndërtimi i By-Pass-eve Fier-Vlorë”, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë¹

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë², i mbështetur në ligjin nr. 154/2012 miratuar në datën 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, standardet INTOSAI dhe në manualin e auditimit të përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Autoriteti Rrugor Shqiptar për projektin “Ndërtimi i By-Pass-eve Fier-Vlorë”, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale dhe jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë.***

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000³)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikes së KLSH-së. Auditimi

¹Mbështetur mbi ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

²Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e opinionit të kundërt ose një refuzim të opinionit.

³ISSAI 4000 – Udhërrëfyese i Auditimit të Përputhshmërisë.

ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra mbi veprimtarinë e projektit rezultoi se:

Autoritetin Rrugor Shqiptar ka të meta dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë së tij që lidhen me menaxhimin e projektit. a. Strukturat drejtuese të ARrSh nuk dorëzojnë tek Banka informacion në formatin e kërkuar në marrëveshje; nuk mban libra dhe regjistra të rregullt llogarish, ku të pasqyrohen saktë hyrje të plota dhe të sakta për të gjitha transaksionet financiare dhe nuk është kryer asnjë auditim dhe të jetë paraqitur raport nga auditues të pavarur. b. Palët e përfshira në implementimin e projektit, ARrSh dhe Konsulentët nuk kanë kryer një vlerësim të objektivave të përcaktuara në marrëveshjet e financimit me qëllim vlerësimin e rezultateve të punës së deritanishme. Objektivat e përcaktuara në marrëveshjen e ratifikuar për projektet e sipërpërmendura nuk janë objektiva konkrete dhe të matshme. c. Në 44 raste janë konstatuar vonesa në likuidimin e TVSH-së dhe në 35 raste Raportimet për realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve nuk janë dorëzuar në MFE. Gjithashtu në të dy projekte, ku punimet janë në proces, nga ana e mbikëqyrësve të punimeve në pagesat e ndërmjetme janë certifikuar punime të pa kryera në vlerën totale 68,252.38 Euro pa TVSH si rritje e kostove të tyre e pa parashikuar në vlerën 4,615,797.54 Euro pa TVSH.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 7/1 Prot. datë 18.01.2022, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 18.01.2022 deri me datë 22.04.2022, në subjektin *Autoriteti Rrugor Shqiptar, Projekti “Ndërtimi i By-Pass-eve Fier-Vlorë”*, për periudhën nga fillimi i Projektit deri më 31.12.2021, u krye auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë” nga:

Grupi i auditimit me përbërje:

1. S H, Përgjegjës Grupi
2. I S, Audituese
3. M H, Auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Objekti kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit që Autoriteti Rrugor Shqiptar me strukturat përkatëse ka bërë me fondet në dispozicion, në bazë të Marrëveshjeve Financiare si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullshmërinë, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të zbatimit të Projektit.

2. Qëllimi i auditimit

Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës* duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet si dhe nëse janë arritur apo jo objektivat e Projektit. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë* ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. *Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).*

3. Identifikimi i çështjes:

Autoriteti Rrugor Shqiptar duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për arritjen në cilësi të punimeve/shërbimeve të ofruara nga Projekti duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Menaxhmenti është përgjegjës për kryerjen e transaksioneve financiare në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore dhe që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me Projektin, konkretisht Ligjin nr. 109/2014 “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By-Pass-in e Vlorës”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së përgjithshme”, pika 119. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit mbi çështjet nën auditimin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike si dhe është planifikuar dhe kryer auditimi sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

6. Kriteret e vlerësimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH; Ligji nr. 8/2012 datë 09.02.2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të By-Pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, Ligji nr. 80/2012 datë 13.09.2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI) për projektin “Ndërtimi i by-pass të Fierit”, Ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për menaxhimin e rrjetit rrugor shtetëror, Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, Ligji nr. 52/2015 datë 14.05.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së grandit nëpërmjet RSH dhe BERZH, nga llogaria EU/IPA e By-Pass Vlorë, për By-Pass e Vlorës”, Ligji nr. 109/2014 datë 31.07.2014 “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By-Pass-in e Vlorës

7. Standardet e auditimit

-Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI (100)** “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parime themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI (400)** “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë” që përcakton parime themelore **ISSAI (100)** dhe zhvillon më tej ato, duke përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI (4000)** “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe **ISSAI (4200)**;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Federata Ndërkombëtare kontabilisteve (IFAC);
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI¹;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve;

8. Metodatat e auditimit

- Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.
- Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të

vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

□ Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH^{-së} nr. 196, datë 29.12.2015 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) është krijuar me Ligjin Nr. 10164, date 15/10/2009, “Për autoritetin rrugor shqiptar”. Qëllimi i Ligjit ishte krijimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar me kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e tij. Ky ligj beri shndërrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Autoritetin Rrugor Shqiptar. Misioni i kësaj drejtorie ishte organizimi, zhvillimi, shfrytëzimi mirëmbajtja, ri-veshja dhe realizimi i programit të investimeve në rrjetin rrugor kombëtar.

Institucioni i ARRSH-së, ka pësuar ndryshime në strukturë sipas VKM nr. 276, datë 16.05.2018 “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”, sipas të cilit marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve të tjerë dhe punonjësve të Autoritetit në nivel Qendror dhe rajonal rregullohen në bazë të dispozitave të Ligjit 7961, datë 12.07.1995 ”Kodi i Punësi RSH”, i ndryshuar.

Misioni i kësaj strukture është organizimi, zhvillimi, shfrytëzimi mirëmbajtja, ri-veshja dhe realizimi i programit të investimeve në rrjetin rrugor kombëtar. ARRSH, si një institucion i akredituar për administrimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit si dhe nga donatorë të huaj si: Banka Botërore, Banka Evropiane për Zhvillim dhe Ndërtim, Banka Evropiane e Investimeve, Qeveria Italiane, Qeveria Kuvajtiane, Banka Islamike etj., ka realizuar disa objekte të rëndësishme në rrjetin rrugor nacional.

Realizimi i projektit “Ndërtimi i By-Pass-eve të Fierit dhe Vlorës” është bashkëfinancim nga 5 donator, në formë huaje nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Evropiane e Investimeve (BEI), Qeverisë Italiane nëpërmjet Cooperazione Italiana, grand nga llogaria EU/IPA (kanalizuar nga BERZH) si dhe kontribut i Qeverisë Shqiptare, në vlerën totale 145,165,000 Euro.

Objekti kryesor i projektit është, ndërtimi i dy By-Pass-eve; By-Pass Fierit me gjatësi 22 km dhe By-Pass Vlorës me gjatësi 29 km. Qëllimi kryesor i projektit është të përmirësohet udhëtimi kohor dhe i sigurt, në veçanti përmes trafikut, si dhe për të lehtësuar kongestionin dhe problemet mjedisore në Fier dhe Vlorë.

By Pass-i i Fierit lidh autostradën Lushnjë-Fier, e cila përfundon në Mbrostar, me autostradën Levan-Vlorë ku bashkohet me rrugën Levan-Tepelenë me gjatësi totale, përafërsisht 22 km, të kategorisë "B" Ekstra Urbane me 2 drejtime. Gjerësia totale e rrugës është 22 m dhe me 2x2 korsi nga 3,75 m secila, 2x0.5 m bankina të asfaltuar. Sinjalistika është vertikale dhe horizontale, mbrojtëset anësore (guard rail) janë të tipi H2, H3 dhe në urat e rrugës të tipit H4. Projekti parashikon ndërtimin e 3 urave të mëdha L=80m, 4 kryqëzime me 2 nivele, 21 nënkalime dhe 108 tombino rrethore. Paketa e shtresave të rrugës është, tapet asfaltik 4cm, binder 6cm, bazë asfaltike 15cm, stabilizant 30cm dhe shtresë nën-bazë 30cm. Gjithashtu ka rrugë paralele, pothuajse, në të gjithë gjatësinë e rrugës në të dy krahët. Në këtë kontratë (seksioni C) është shtuar dhe rehabilitimi i rrugës që lidh By-Pass-in me parkun arkeologjik të Apolonisë.

By-Pass-i i Vlorës lidh autostradën Levan-Vlorë me rrugën nacionale bregdetare Vlorë-Sarandë, pjesa jugore e Vlorës. Gjatësia e këtij aksi është 29 km dhe fillon nga rreth-rrotullimi në fund të autostradës Levan Vlorë. Profili gjatësor i rrugës, afërsisht 7 km e para, është i sheshtë (me pjerrësi të vogël). Në km 7+500, gjurma fillon në ngjitje në terren kodrinor, ullishte, përgjatë gjithë rrugës deri në kryqëzimin me rrugën ekzistuese në Kaninë në km 10+070. Rruga anashkalon Kaninë në pjesën perëndimore mbi Vlorë, rreth 300 m nën kështjellë. Në pjesën e rrugës pasi kalon fshatin Kaninë afërsisht deri mbi Radhimë terreni është shkëmbor dhe në këtë pjesë do të ndërtohen dy ura. Pjesa tjetër e rrugës me gjatësi, afërsisht 12 km, kalon në toka bujqësore. Gjithashtu në këtë rrugë

janë parashikuar sheshpushime çdo 1.5 km. Rruga do të ketë një karrexhatë të vetme e kompozuar me 2 korsi (1 për çdo sens lëvizje), si dhe me një korsi të tretë shtesë në ngjitje në seksionet me pjerrësi të madhe. Për këtë rrugë janë parashikuar të ndërtohen 15 kryqëzime të tipeve të ndryshëm (p.sh. rreth-rrotullime, të tipit T, etj.); 27 mure mbajtës b/a me gjatësi totale, afërsisht, 1600 metra; 22 mure me dhe të armuar me gjatësi totale, afërsisht, 2000 metra dhe 5 ura kryesore me gjatësia 50 -150m.

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

2.1 Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve dhe raportimi i tyre.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se:

Realizimi i projektit “Ndërtimi I By-Passeve të Fierit dhe Vlorës” është bashkëfinancim nga 5 donator, në formë huaje nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Evropiane e Investimeve (BEI), Qeverisë Italiane nëpërmjet Cooperazione Italiana, grand nga llogaria EU/IPA (kanalizuar nga BERZH) si dhe kontribut i Qeverisë Shqiptare, në shumat gjithsej: 127,016,910 Euro.

Financimi total i projektit sipas donatorëve paraqitet si më poshtë:

Euro				
Financimi për Projektin “By-pass-in e Fier-Vlorë”				
Nr.	Ligji Burimi i financimit	Shuma	Disbursuar	Realizuar në %
1	Hua nga BERZH	53,000,000	49,635,991.63	93.6%
2	Hua nga BEI	35,000,000	35,000,000	100%
	Hua nga BEI	18,000,000	13,500,000	75%
3	Grand nga fondet IPA për punimet e by-pass-it të Vlorës	17,000,000	14,543,659.12	85.5%
4	Grand nga fondet IPA për supervizionin e mbikëqyrjen e punimeve të by-pass-it Vlorë	2,365,000	2,365,000	100%
5	Grand nga Cooperacioni Italian (me ndryshime)	858,210	858,210	100%
Totali		126,223,210	102,402,860.75	81.1%

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Projekti ka filluar në vitin 2012 dhe për ndjekjen dhe zbatimin e tij është caktuar Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) si Njësi e Zbatimit të Projektit. Projekti ka ndaluar dhe nuk është zhvilluar për shkak të performancës së dobët të kontraktorit dhe ka rifilluar pas ri tenderimit të kontratave në nëntor 2018.

1. Titulli i Gjetjes: Ekspozimi i projektit ndaj riskut të ndërprerjes së disbursimeve.

Situata: Sipas nenit 2 të Marrëveshjes data e fundit e disponueshërisë së kredisë është 30.04.2015. Nga auditimi rezulton se me shkresën nr.9280/1.prot, date 23/06/2015 Ministri i Financave i kërkon përfaqësuesit të BERZH shtyrja e afatit të kredisë deri në 2017.

“Sipas marrëveshjes, Data e Fundit e Disponueshmërisë së Transhit A të Huasë, është data 30 prill 2015. Fillimi i zbatimit të pjesës së projektit që lidhet me ndërtimin e Bypass – it të Fierit, pjesë e cila financohet nëpërmjet Transhit A të Huasë, ka hasur vonesa të ndryshme. Për rrjedhojë kontrata përkatëse e punimeve është lidhur në muajin Maj 2013 dhe përfundon në muajin Shkurt 2017 (duke përfshirë edhe periudhën e garancisë së defekteve).

Mbështetur në sa më sipër kërkojmë shtyrjen e Datës së Fundit të Disponueshmërisë së Transhit A të Huasë deri në 30 prill 2017.” Deri në përfundim të auditimit nuk u vendos në dispozicion se kur është aprovuar shtyrja e afatit nga BERZH.

Nga auditimi rezulton se nga ana e ARRSH dhe Ministrisë së Financave nuk janë marrë masat e nevojshme në për zgjatjen e afatit të disbursimit të projektit në kohë duke vendosur në pasigurinë e vazhdimet të disbursimet. Me shkresën nr. 4280 prot., datë 24.05.2017 “Projekti për Bypass – in e Fierit dhe të Vlorës” ku Drejtor i Përgjithshëm i ARRSH i është drejtuar MTI duke e informuar

mbi ecurinë e projektit dhe i kërkon që të shtyhet afati i disbursimit për 2 – 3 vjet respektivisht për Fierin dhe Vlorën. Me shkresën nr. 5937, datë 20.07.2017 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit & Vlorës” mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së kredive BEI & BERZH” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë dhe se kanë kaluar afatet e lejuara. Me shkresën nr. 5937/1, datë 28.08.2017 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit & Vlorës” mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së kredive BEI & BERZH” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë pasi deri në 28.08.2017 nuk është bërë asnjë kërkesë, dhe se kanë kaluar afatet e lejuara. Me shkresën nr. 7293, datë 15.09.2017 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit & Vlorës” kërkesë mbi shtyrjen e afatit të kredive” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë me 2 – 3 vjet respektivisht për Fierin dhe Vlorën. Me shkresën nr. 8627, datë 27.10.2017 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit & Vlorës” kërkesë mbi shtyrjen e afatit të kredive” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë me 2 – 3 vjet respektivisht për Fierin dhe Vlorën. Me shkresën nr. 4968, datë 06.06.2018 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit” kërkesë mbi shtyrjen e afatit të kredive BEI & BERZH” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë deri në 31.01.2021.

Me shkresën nr. 7309, datë 27.08.2018 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit” kërkesë mbi shtyrjen e afatit të kredisë midis Qeverisë Shqiptare dhe BERZH” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë deri në 31.01.2021.

Me Amendamenti Nr.1, datë 14.02.2019, e cila është përcjell me shkresë nr. 149/5, datë 11.07.2019, miratohet afati i fundit për kryerjen e disbursimeve për transhin A të marrëveshjes së huasë datën 31 Janar 2021. Nga auditimi konstatohet se ka një periudhë prej 21 muajsh pa marr miratimin e shtyrjes së disbursimeve, ARRSH ka një korrespondenë të vazhdueshme me Ministrinë ku kërkon kryerjen e procedurave për zgjatjen e afatit të disbursimeve por referuar amendamentit Ministria e ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të disbursimeve në 26.12.2018 (19 muaj më vonë nga kërkesa e parë e ARRSH) veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin e Marrëveshjes. Sqarohet se gjatë kësaj periudhe nuk ka patur asnjë kërkesë për disbursime dhe nuk është kryer asnjë disbursim nga ARRSH pasi kompania e ndërtimit ka ndërprerë punimet “S..... C..... Spa” dhe ARRSH ishte duke zhvilluar procedurën e ritenderimit. Me shkresën nr. 7721, datë 14.10.2020 “Ndërtimi i segmentit rrugor “ByPass i Fierit” kërkesë për shtyrje e afatit të marrëveshjes së kredisë së BERZH-it” ARRSH ka kërkuar shtyrje të afatit të kredisë së BERZH deri në 31.06.2022. Amendimi nr 2, datë 26.11.2021 (Vendimi i KM nr. 444, datë 22.07.2021) është shtyrë afati i disbursimeve deri në 30.06.2022. Referuar shkresës së disbursimit Ministria e Financave i është drejtuar BERZH në 12.04.2021 ose 6 muaj më vonë se ARRSH ka paraqitur kërkesën e saj.

Kriteri: Neni 2 i Ligjit nr. 8/2012, datë 09.02.2012 Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Ndikimi/Efekti: Ekspozimi i projektit ndaj riskut të ndalimit të disbursimeve.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Mos zbatimi i afateve.

Rekomandim: ARRSH në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (ministria e linjës) dhe Ministrinë e Financave (si përfaqësuese e huamarrësit) të marrin masa që të bashkërendojnë punën dhe në çdo rast të kryejnë kërkesat për amendimin e marrëveshjeve të huave brenda afateve të marrëveshjeve duke ulur riskun e ndërprerjes së financimit.

2. Titulli i Gjetjes: Mos dokumentimi i plotësisht të kushteve të marrëveshjes.

Situata: Referuar Ligjit të marrëveshjes ARRSH duhet:

“Plan i veprimit për rivendosjen për komponentin 1” nënkupton planin e veprimit të rivendosjes për komponentin 1, të përfunduar nga ARRSH dhe të dorëzuar Bankës nga ARRSH-ja në emër të Huamarrësit, plani i të cilit do të zbatohet në përputhje me kërkesat e politikës sociale dhe mjedisore të Bankës.

“Plan i veprimit për rivendosje për komponentin 2” nënkupton planin e veprimit për rivendosje për komponentin 2, i cili do të bihet dakord me Bankën përpara datës së fillimit të transhit B.

“Planet e veprimit për rivendosje” nënkupton planin e veprimit për rivendosje për komponentin 1 dhe planin e veprimit për rivendosje për komponentin 2.

“Strategjia e taksave rrugore” nënkupton strategjinë e taksave rrugore për Shqipërinë, të përgatitur nga konsulentët për Huamarrësin. Strategjia e taksave rrugore do të formulojë politikën e taksave rrugore dhe do të identifikojë seksionet që mund të jenë të përshtatshme për taksim rrugor në Shqipëri.

“Studim i qëndrueshëm i transportit” nënkupton studimin e qëndrueshëm të transportit të përgatitur nga konsulentët për Huamarrësin. Politika e qëndrueshme e transportit do të identifikojë masat për përmirësimin e qëndrueshmërisë së sektorit të transportit në Shqipëri.

Nga auditimi u konstatua që deri në fund të periudhës objekt auditimi nuk u vendosën në dispozicion dokumentat e kërkuara pasi stafi aktual është emëruar rishtazi në detyrë dhe nuk disponojnë dokumentet e mësipërme.

Kriteri: Neni 2 i Ligjit nr. 8/2012, datë 09.02.2012 Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Ndikimi/Efekti: Mos dokumentim i dokumentave zyrtare të marrëveshjes.

Rëndësia: E mesme.

Shkaku: Mungesa e dokumentacionit.

Rekomandim: ARRSH të marrë masa për krijimin e arkivës për projektet me financim të huaj ku të arkivohen të gjitha dokumentat nga fillimi i projektit me qëllim dokumentimin e vijueshmërisë së projektit.

3. Titulli i Gjetjes: Mungesa e burimeve njerëzore (EZP) për zbatimin e projektit në përputhje me Marrëveshjet e Financimit.

Situata: Nga auditimi rezultoi se aktualisht Ekipi i Zbatimit të Projektit përbëhet nga staf i strukturës së ARRSH me profesion inxhinier konkretisht:

- nga përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja
- një specialiste e Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja i cili ndjek zbatimin e kontratës së Fierit

- një specialiste e Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Brendshme e cila referuar Urdhrit nr. 94 datë 18.06.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH përveç detyrave funksionale në këtë sektor do të ndjekë edhe detyrat e specialistes së Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja, detyra që lidhen me ndjekjen e projektit të ndërtimit të By Passit Vlorë. Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 276 datë 16.05.2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe statutit të “Autoritetit Rrugor Shqiptar””, këto njësi janë në varësi të Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes dhe nuk e kanë të specifikuar llojin e arsimimit të kërkuar për specialistët. Në Rregulloren e Brendshme nr. 7493/2, datë 04.09.2018 miratuar me vendim bordi nr .10 datë 04.09.2018 përcaktohen qëllimi dhe detyrat e Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja i cili menaxhon zbatimin e projekteve të zhvillimit sipas specifikimeve të kontratës dhe në bazë të kuadrit rregullues /ligjor të shtetit /donatorëve, për të siguruar që punimet janë kryer në mënyrë të kënaqshme sipas kontratës dhe që kontraktorët përmbushin detyrimet kontraktuale. Pra, referuar rregullores së brendshme detyrat e këtij sektori kanë të bëjnë me marrjen e masave për të siguruar

që punimet janë kryer në mënyrë të kënaqshme sipas kontratës. Sektori i Menaxhimit të Projekteve të Huaja nuk ka në përbërjen e tij një specialist/ekonomist, dhe aktualisht ana financiare e projektit ndiqet nga specialistët e sektorit të financës në Drejtorinë e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës. Mungesa e specialistit të financës është në kundërshtim me marrëveshjen financiare në të cilat përcaktohet se njësia e zbatimit duhet të marrë masa për mbajtjen e llogarive të projektit, librave kontabël dhe hartimit të pasqyrave financiare të projektit.

Kriteri: Neni 3 seksioni 03 i ligjit nr. 8/2012, datë 09.02.2012 marrëveshja e ratifikuar e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)

Ndikimi/Efekti: Mos krijimi një njësie me staf të dedikuar për projektin.

Shkaku: Mos krijimi një njësie me staf të dedikuar për projektin.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: ARRSH me qëllim eliminimin e problemeve të cilat mund të dalin si pasojë e mos ngritjes së njësisë së zbatimit të projektit sipas kushteve të përcaktuara dhe të rëna dakord ndërmjet palëve në marrëveshje, si dhe referuar faktit se projekti është drejt përfundimit, të marrë masa që në të ardhmen të respektohet dhe përcaktohet struktura permanente e Njësisë së Zbatimit të Projektit me specialistët e fushës, sipas kushteve të specifikuara në marrëveshjet e ratifikuara.

1. Ligjin nr. 8/2012, datë 09.02.2012 është ratifikuar marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), 53,000,000 Euro.

Huaja përbëhet nga dy transhe:

Transhi A në shumën 35,000,000 Euro

Transhi B në shumën 18,000,000 Euro

Shuma minimale e tërheqjes është 300,000 Euro

Sipas nenit 2 të Marrëveshjes data e fundit e disponueshërisë së kredisë është 30.04.2015.

Me shkresën Nr.9280/1.prot, date 23/06/2015 Ministri i Financave i kërkon përfaqësuesit të BERZH shtyrja e afatit të kredisë deri në 2017.

“Sipas marrëveshjes, Data e Fundit e Disponueshmërisë së Transhit A të Huasë, është data 30 prill 2015. Fillimi i zbatimit të pjesës së projektit që lidhet me ndërtimin e By ass – it të Fierit, pjesë e cila financohet nëpërmjet Transhit A të Huasë, ka hasur vonesa të ndryshme. Për rrjedhojë kontrata përkatëse e punimeve është lidhur në muajin Maj 2013 dhe përfundon në muajin Shkurt 2017 (duke përfshirë edhe periudhën e garancisë së defekteve).

Mbështetur në sa më sipër kërkojmë shtyrjen e Datës së Fundit të Disponueshmërisë së Transhit A të Huasë deri në 30 prill 2017.”

Deri në përfundim të auditimit nuk u vendos në dispozicion se kur është aprovuar shtyrja e afatit nga BERZH. Nga auditimi rezulton se nga ana e ARRSH dhe Ministrisë së Financave nuk janë marrë masat e nevojshme në për zgjatjen e afatit të disbursimit të projektit në kohë duke vendosur në pasigurinë e vazhdimit të disbursimet. Korespondenca për shtyrjen e afatit të disbursimit si më poshtë:

Me shkresën nr. 4280 prot. datë 24.05.2017 “Projekti për Bypass – in e Fierit dhe të Vlorës” ku Drejtor i Përgjithshëm i ARRSH i është drejtuar MTI duke e informuar mbi ecurinë e projektit dhe i kërkon që të shtyhet afati i disbursimit për 2 – 3 vjet respektivisht për Fierin dhe Vlorën.

Me shkresën nr. 5937, datë 20.07.2017 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit & Vlorës” mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së kredive BEI & BERZH” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë dhe se kanë kaluar afatet e lejuara.

Me shkresën nr. 5937/1, datë 28.08.2017 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit & Vlorës” mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së kredive BEI & BERZH” ARRSH i është drejtuar

MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë pasi deri në 28.08.2017 nuk është bërë asnjë kërkesë, dhe se kanë kaluar afatet e lejuara.

Me shkresën nr. 7293, datë 15.09.2017 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit & Vlorës” kërkesë mbi shtyrjen e afatit të kredisë” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë me 2 – 3 vjet respektivisht për Fierin dhe Vlorën.

Me shkresën nr. 8627, datë 27.10.2017 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit & Vlorës” kërkesë mbi shtyrjen e afatit të kredisë” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë me 2 – 3 vjet respektivisht për Fierin dhe Vlorën.

Me shkresën nr. 4968, datë 06.06.2018 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit” kërkesë mbi shtyrjen e afatit të kredisë BEI & BERZH” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë deri në 31.01.2021.

Me shkresën nr. 7309, datë 27.08.2018 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit” kërkesë mbi shtyrjen e afatit të kredisë midis Qeverisë Shqiptare dhe BERZH” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë deri në 31.01.2021.

Me Amendamenti Nr.1, datë 14.02.2019, e cila është përcjell me shkresë nr. 149/5, datë 11.07.2019, miratohet afati i fundit për kryerjen e disbursimeve për transhin A të marrëveshjes së huasë datën 31 Janar 2021.

Nga auditimi konstatohet se ka një periudhë prej 21 muajsh pa marr miratimin e shtyrjes së disbursimeve, ARRSH ka një korrespondenë të vazhdueshme me Ministrinë ku kërkon kryerjen e procedurave për zgjatjen e afatit të disbursimeve por referuar amendamentit Ministria e ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të disbursimeve në 26.12.2018 (19 muaj më vonë nga kërkesa e parë e ARRSH) veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin e Marrëveshjes. Sqarojmë se gjatë kësaj periudhe nuk ka patur asnjë kërkesë për disbursime dhe nuk është kryer asnjë disbursim nga ARRSH pasi kompania e ndërtimit ka ndërprerë punimet “S..... C..... Spa” dhe ARRSH ishte duke zhvilluar procedurën e ritenderimit.

Me shkresën nr. 7721, datë 14.10.2020 “Nërtimi i segmentit rrugor “ByPass i Fierit” kërkesë për shtyrje e afatit të marrëveshjes së kredisë së BERZH-it” ARRSH ka kërkuar shtyrje të afatit të kredisë së BERZH deri në 31.06.2022.

Amendimi nr 2, datë 26.11.2021 (Vendimi i KM nr. 444, datë 22.07.2021) është shtyrë afati i disbursimeve deri në 30.06.2022. Referuar shkresës së disbursimit Ministria e Financave i është drejtuar BERZH në 12.04.2021 ose 6 muaj më vonë se ARRSH ka paraqitur kërkesën e saj.

Me shkresën nr. 1175/3, datë 04.11.2013 “Mbi projektin e Bypass – it të Fierit dhe të Vlorës” MF i është drejtuar MTI (sot MIE) për informacion në lidhje me plotësimin e parakushteve.

Me shkresën Nr. 757/2, datë 12.11.2013 “Për kompetencë” MTI (sot MIE) i ka kërkuar ARRSH informacion.

Me shkresën nr. 5109, datë 19.11.2013 “Projekti për ByPass e Fierit dhe të Vlorës” ARRSH i ka përcjell informacionin Ministrisë mbi plotësimin e pjeshëm të kushteve.

U vendos në dispozicion vetëm një shkresë me nr. 3150, datë 14.06.2013 e Drejtorit të Përgjithshëm i cili ka përcjell disa dokumenta mbi vlerësimin mjedisor dhe social të projektit Bypass i Vlorës.

Huamarrësi shlyen huan e transhit A në 24 (njëzet e katër) këste të barabarta (ose pothuajse sa më të barabarta që të jetë e mundur) gjashtëmujore në datat 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti, me datën e parë të shlyerjes së huas për transhin A që bie në datën e ardhshme të pagimit të interesit pas përvjetorit të tretë të kësaj Marrëveshjeje.

Huamarrësi shlyen huan e transhit B në 24 (njëzet e katër) këste të barabarta (ose pothuajse sa më të barabarta që të jetë e mundur) gjashtëmujore në datat 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti, me datën

e parë të shlyerjes së huas për transhin B që bie në datën e ardhshme të pagimit të interesit pas përvjetorit të tretë të datës së fillimit të transhit B.

Norma e tarifës së detyrimit financiar është 0.5% në vit. Tarifa e detyrimit financiar për huan e transhit B është e pagueshme nga data e fillimit të transhit B.

Huaja i nënshtrohet një norme të ndryshueshme interesi. Pavarësisht nga sa më sipër, si alternativë ndaj interesit të pagueshëm në një normë të ndryshueshme interesi mbi të gjithë ose ndonjë pjesë të huas në atë kohë të papaguar, Huamarrësi mund të zgjedhë të paguajë interes në një normë fikse interesi për këtë pjesë të huas, në përputhje me seksionin 3.04(c) të termave dhe kushteve standarde. Referuar Seksionit 3.07 Shpeshtësia e Raportimeve dhe kërkesat e paraqitjes

a) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi dhe derisa shuma e plotë e huas të jetë shlyer ose anuluar, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i paraqet Bankës raportet vjetore mbi çështjet mjedisore dhe sociale që lindin në lidhje me Huamarrësin ose projektin brenda 90 ditësh pas përfundimit të vitit kur raportohen.

Këto raportime janë dërguar me email tek Banka (për Bypass-in e Fierit) konkretisht: me email datë 13.03.2020 është dërguar aporti për vitin 2019; email i datës 28.05.2021 është dërguar raporti për vitin 2020 (58 ditë me vonesë) në kundërshtim me Seksionin 3.07, pika a të marrëveshjes dhe me i emailin e datës 08.03.2022 është dërguar raporti për vitin 2021.

Këto raportime janë dërguar te Banka (për Bypass-in e Vlorës) konkretisht:

Me shkresën nr. 1096, datë 05.03.2020 është dërguar raporti për Bypass-in e Vlorës për vitin 2019.

Me emailin e datës 28.05.2021 është dërguar raporti për vitin 2020

Me emailin e datës 12.01.2022 është dërguar raporti për vitin 2021

b) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i paraqet raporte periodike tremujore të projektit të përmendura në seksionin 4.04 “a” “iv” të termave dhe kushteve standarde, brenda 45 ditësh pas përfundimit të periudhës së raportimit deri në përfundimin e projektit. Një diagram i progresit në formë grafiku, bazuar në skedulën e zbatimit të projektit, e cila tregon progresin në çdo pjesë të projektit dhe përfshin një grafik të shpenzimeve aktuale dhe të planifikuara.

Nga auditimi rezulton se në përgjithësi raportet janë dorëzuar brenda afatit 45 ditë, vetëm në 1 rast rezulton se nuk është zbatuar afati konkretisht: Me shkresën nr. 562/1, datë 05.04.2019 raporti i tetor – dhjetor 2018 (50 ditë vonesë).

Në marreveshje kërkohet të raportohet.

c) Menjëherë pas ndodhjes së çdo incidenti ose aksidenti në lidhje me Huamarrësin, ose projektin, që ka ose mund të ketë ndikim të konsiderueshëm negativ në mjedis ose në shëndetin publik ose profesional, ose sigurinë, Huamarrësi do të informojë Bankën dhe menjëherë më pas, do të njoftojë Bankën për këtë, duke përcaktuar natyrën e këtij incidenti ose aksidenti dhe të çdo hapi që Huamarrësi merr për përmirësimin e kësaj situate

Nga auditimi dhe dekaratat e stafit të dedikuar nga ARRSH për projektin rezulton se nuk është bërë ndonjë raportim veçantë për çdo ngjarje por në raportet progresive në kundërshtim me pikën e mësipërme të marrëveshjes.

d) Huamarrësi njofton menjëherë Bankën për çdo kundërshtim të fuqishëm nga punëtorët ose anëtarët e publikut të drejtuar për ose në lidhje me Huamarrësin ose projektin, që mund të kishte ndikim negativ material te Huamarrësi ose projekti, ose që është bërë ose mund të bëhet njoftim publik nëpërmjet publikimit në media apo ndryshe.

Brenda dhjetë ditësh pas këtij njoftimi, Huamarrësi do të paraqesë një raport të pranueshëm për Bankën, i cili përcakton rezultatin e hetimit të Huamarrësit për këtë kundërshtim dhe çdo hap të

marrë ose që propozohet të merret nga Huamarrësi për zgjidhjen e çështjeve të ngritura në kundërshtim.

Nga auditimi rezulton se nuk ka asnjë raport të tillë të kryer nga ARRSH në kundërshtim me pikën e mësipërme.

Nga auditimi konstatohet se ARRSH nuk ka mbajtur pasqyra financiare për projektin në përputhje me standardet e kontabilitetit të pranuar ndërkombëtarisht, operacionet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me projektin dhe për të monitoruar dhe regjistruar progresin e projektit (duke përfshirë kostot e tij dhe përfitimet që rrjedhin nga projekti) por ato janë të integruara në pasqyrat financiare të vet ARRSH si dhe nuk janë kryer auditime të pasqyrave dhe nuk është informuar Banka në kundërshtim me *Seksioni 4.01 të ligjit të Marrëveshjes.*

“Të dhënat dhe raportet financiare

a) Në lidhje me departamentet ose agjencitë e Huamarrësit, përgjegjëse për kryerjen e projektit ose ndonjë pjese të tij, Huamarrësi shfrytëzon procedura, të dhëna dhe llogari të mjaftueshme për të reflektuar në përputhje me standardet e kontabilitetit të pranuar ndërkombëtarisht, operacionet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me projektin dhe për të monitoruar dhe regjistruar progresin e projektit (duke përfshirë kostot e tij dhe përfitimet që rrjedhin nga projekti).

b) Huamarrësi:

1. ia nënshtron të dhënat dhe llogaritë e përmendura në seksionin 4.01(a) për çdo vit fiskal, auditimit nga auditë të pavarur të pranueshëm për Bankën, në përputhje me parimet dhe standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht;

2. i jep Bankës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti fiskal, raportin e këtij auditit nga këta auditë dhe fushën e veprimit dhe në hollësi që Banka mund të kërkojë; dhe

3. i jep Bankës çdo informacion tjetër në lidhje me këto të dhëna dhe llogari, dhe auditin e tyre, që Banka mund të kërkojë herë pas here.”

Nga auditimi rezulton se nga ARRSH dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (sot MIE) nuk janë marrë masa që të jenë kryer të gjitha shpronësimet dhe të jetë marrë drejta mbi tokën ku do të zhvillohet projekti në kundërshtim me nenin 6, seksioni 6.01 pika “c” dhe seksioni 6.04, pika “i” *Seksioni 6.01. Kushtet pararendëse për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe disponueshmëria e transhit A*

c. Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se të gjitha të drejtat e truallit, të nevojshme për zbatimin e komponentit 1, janë marrë nga Huamarrësi dhe janë vënë në dispozicion të kontraktorit të punimeve civile (ose se Huamarrësi ka të drejtë të fitojë këto të drejta trualli në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm shqiptar dhe se shumata e mjaftueshme janë rezervuar nga Huamarrësi për fitimin e këtyre të drejtave të truallit në kohën e duhur) dhe konfirmim se plani i veprimit të rivendosjes për komponentin 1 është duke u zbatuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara të performancës.

Seksioni 6.04. Kushtet për disponueshmërinë e transhit B

i) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se të gjitha të drejtat e truallit të nevojshme për zbatimin e komponentit 2 janë fituar nga Huamarrësi dhe janë vënë në dispozicion të kontraktorit të punimeve civile (ose se Huamarrësi ka të drejtë të fitojë këto të drejta trualli në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm shqiptar dhe se shumata e mjaftueshme janë rezervuar nga Huamarrësi për fitimin e këtyre të drejtave të truallit në kohën e duhur) dhe konfirmim se plani i veprimit të rivendosjes është duke u zbatuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara të performancës.

2. Me ligjin nr. 80/2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)”.

Kostoja totale e projektit sipas vlerësimit të Bankës është 81,200,000 Euro (tetëdhjetë e një milionë e dyqind mijë Euro) dhe Huamarrësi ka deklaruar se synon të financojë projektin si më poshtë:

Burimi	Shuma (mln Euro)
Kredi nga Banka	35;
Hua nga BERZH-i	35;
Grant nga Kooperacioni Italian	1.8;
Fondet e veta	9.4;
TOTALI	81.2.

Për të përmbushur planin financiar të paraqitur në paragrafin hyrës 2, Huamarrësi ka kërkuar nga Banka një kredi prej 35,000,000 Eurosh (tridhjetë e pesë milionë Euro). Nënkuptohet se kreditimi nga Banka do të përdoret vetëm për financimin e komponentëve të projektit të lidhura me punimet civile të përshkruara në përshkrimin teknik, që gjithashtu do të bashkëfinancohet nga huaja e BERZH-it.

Banka, duke marrë parasysh se financimi i projektit përfshihet në objektin e funksioneve të saj dhe duke marrë parasysh deklaratimet dhe faktet e cituara në këta paragrafë hyrës, ka vendosur të realizojë kërkesën e Huamarrësit duke i dhënë një kredi në shumën prej 35,000,000 Eurosh (tridhjetë e pesë milionë Euro) sipas kësaj kontrate financimi (kontrata), me kusht që shuma e huas së Bankës në asnjë rast nuk do të kalojë 50% (pesëdhjetë për qind) të kostos totale të projektit sipas paragrafit hyrës 2. Me anë të kësaj kontrate, Banka akordon në favor të Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon kredinë në shumën 35,000,000 Euro (tridhjetë e pesë milionë Euro) për financimin e projektit (kredia).

Procedura e disbursimit: Banka do të disbursojë kredinë deri në 10 (dhjetë) transhe. Vlera e secilit Transh, nëse nuk është balanca e pa tërhequr e kredisë, do të jetë një vlerë minimale prej 3,000,000 Euro (tre milionë Euro).

“Datë përfundimtare e vlefshmërisë” është 15 qershor 2017.

Interesin që do të akumulohet gjatë asaj periudhe, nëse do të llogaritet në normën e rivendosjes, më pak se 0.15% (pesëmbëdhjetë pikë bazë).

Angazhimet e projektit.

Huamarrësi do të përdorë dhe do të sigurojë që Zbatuesi të përdorë të gjitha shumat e marra nga ai sipas huas për përmbushjen e projektit.

Huamarrësi do të sigurojë që atij dhe Zbatuesit t'i vihen në dispozicion fonde të tjera të renditura në paragrafin hyrës 2 dhe që këto fonde të shpenzohen në masën e kërkuar për financimin e projektit.

Me shkresën nr. 4280 prot., datë 24.05.2017 “Projekti për By Pass-in e Fierit dhe të Vlorës” ku Drejtor i Përgjithshëm i ARRSH i është drejtuar MTI duke e informuar mbi ecurinë e projektit dhe i kërkon që të shtyhet afati i disbursimit për 2 – 3 vjet respektivisht për Fierin dhe Vlorën.

Me shkresën nr. 5937, datë 20.07.2017 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit & Vlorës” mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së kredive BEI & BERZH” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë dhe se kanë kaluar afatet e lejuara.

Me shkresën nr. 5937/1, datë 28.08.2017 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit & Vlorës” mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së kredive BEI & BERZH” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë pasi deri në 28.08.2017 nuk është bërë asnjë kërkesë, dhe se kanë kaluar afatet e lejuara.

Me shkresën nr. 7293, datë 15.09.2017 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit & Vlorës” kërkesë mbi shtyrjen e afatit të kredive” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë me 2 – 3 vjet respektivisht për Fierin dhe Vlorën.

Me shkresën nr. 8627, datë 27.10.2017 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit & Vlorës” kërkesë mbi shtyrjen e afatit të kredisë” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë me 2 – 3 vjet respektivisht për Fierin dhe Vlorën.

Me shkresën nr. 4968, datë 06.06.2018 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit” kërkesë mbi shtyrjen e afatit të kredisë BEI & BERZH” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë deri në 31.01.2021.

Me shkresën nr. 7312, datë 27.08.2018 “Ndërtimi i Segmenteve Rrugore “By Pass i Fierit” kërkesë mbi shtyrjen e afatit të kredisë BEI” ARRSH i është drejtuar MTI për të kryer tek MF kërkesën për shtyrjen e kredisë deri në 31.01.2021.

Amendimi nr. 1, datë 31.12.2019 i miratuar me Vendimin e KM nr. 94, datë 05.02.2020 “Për miratimin e dokumentit të ndryshimit nr.1” me anën e të cilit është zgjatuar afati i disbursimit deri në 31.01.2021.

Nga auditimi rezulton se zgjatja e periudhës së disbursimit të projektit 30 muaj pas përfundimit të kësaj periudhe të përcaktuar në Ligjin e marrëveshjes në kundërshtim me Ligjin e Marrëveshjes.

Me shkresën nr. 7720 prot, datë 14.10.2020 “Ndërtimi i segmentit rrugor “By Pass i Fierit”, kërkesë për shtyrjen e afatit të marrëveshjes së kredisë së BEI - it”

Amendimi nr. 2, datë 31.07.2021 i miratuar me Vendimin e KM nr. 654, datë 03.11.2021 “Për miratimin e Marrëveshjes ndryshuese nr.2” me anën e të cilit është zgjatuar afati i disbursimit deri në 31.12.2021

Nga auditimi rezulton se shtyrja e afatit të disbursimit është kryer 6 muaj pas përfundimit të afatit. Nga auditimi rezulton se nga ARRSH nuk janë kryer raportimet periodike të Huadhënesi BEI sipas llojeve dhe afateve të parashikuara në marrëveshje por janë kryer vetëm disa lloj raportimesh tek BERZH e thënë kjo nga specialistët e GZP.

Sipas nenit 3 të marrëveshjes së financimit, huamarrësi, duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar se në çdo kohë gjatë ekzekutimit të projektit, të jetë në funksionim një Ekip i Zbatimit të Projektit (EKP) me burime të mjaftueshme dhe personel të kualifikuar. Aktualisht rezulton se Ekipi i Zbatimit të Projektit përbëhet nga staf i strukturës së ARRSH me profesion inxhinier konkretisht:

- nga përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja
- një specialiste e Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja i cili ndjek zbatimin e kontratës së Fierit

- një specialiste e Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Brendshme e cila referuar Urdhrit nr.94 datë 18.06.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH përveç detyrave funksionale në këtë sektor do të ndjekë edhe detyrat e specialistes së Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja, detyra që lidhen me ndjekjen e projektit të ndërtimit të By Pass-it Vlorë.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 276 datë 16.05.2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe statutit të “Autoritetit Rrugor Shqiptar”, këto njësi janë në varësi të Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes dhe nuk e kanë të specifikuar llojin e arsimimit të kërkuar për specialistët. Sektori i Menaxhimit të Projekteve të Huaja nuk ka në përbërjen e tij një specialist/ekonomist, dhe aktualisht ana financiare e projektit ndiqet nga specialistët e sektorit të financës në Drejtorinë e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës.

Mungesa e specialistit të financës është në kundërshtim me marrëveshjen financiare në të cilat përcaktohet se njësi e zbatimit duhet të marrë masa për mbajtjen e llogarive të projektit, librave kontabël dhe hartimit të pasqyrave financiare të projektit.

3. Me ligjin nr. 109/2014 datë 31.07.2014 “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By-Pass-in e Vlorës”.

Nëpërmjet kësaj Kontrate Banka jep në favor të Huamarrësit, dhe Huamarrësi pranon, një kredi në shumën 18,000,000.00 Euro (tetëmbëdhjetë milionë Euro) për financimin e Projektit (“Kredia”). Banka do ta disbursojë Kredinë në deri 6 (gjashtë) transhe. Shuma e çdo Transhi, nëse nuk është balanca e pa tërhequr e Kredisë, do të ketë një shumë minimale prej 3,000,000.00 Euro (tre milionë Euro). Periudha e vlefshërisë është 48 muaj pas lidhjes së marrëveshjes ose deri në 20.06.2018.

Me kërkesën nr. 4967, datë 06.06.2018 “Ndërtimi i segmentit rrugor “By Pass i Vlorës”, mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së kredisë së BEI & BERZH”, duke kërkuar shtyrjen e afatit të disbursimeve deri në 31.03.2022. Me Vendimin e KM nr. 194, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentit të ndryshimit nr. 1 të kontratës financiare. ndërmjet RSH dhe BEI” (18 muaj pas kërkesës është marr miratimi)

Me kërkesën nr. 267, datë 12.01.2022 “Mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BEI për projektin “Ndërtimi i By Pass – it të Vlorës”” me anën e të cilës është kërkuar shtyrja e afatit deri në 31.03.2023.

4. Me ligjin nr. 52/ 2015 datë 14.05.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për investimin, nga llogaria EU/IPA e by-pass-it Vlorë, për by-pass-in e Vlorës.

Në përputhje me këtë Marrëveshje, Banka bie dakord të financojë Marrësin me një grant nënjësisë prej 17.000.000 Eurosh (shtatëmbëdhjetë milionë Euro) (Granti i By Pass-it të Vlorës IPA);

Granti do të sigurohet nga Banka vetëm për qëllimet e financimit të Objekteve të Financuara nga Granti, të cilat duhet të prokurohen në përputhje me seksionin 3.05 (Prokurimi) të kësaj Marrëveshjeje. Sipas seksionit 5.05 (Rastet e Rimbursimit) të kësaj Marrëveshjeje, Granti është i parimbursueshëm. Konfirmohet dhe bihet dakord shprehimisht se Banka nuk do të detyrohet të bëjë asnjë lloj disbursimi ndaj personave të tretë apo pagesa të llojeve të tjera, në përputhje me këtë Marrëveshje, vetëm në rast se kjo sasi monetare vihet në përdorim në lidhje me Marrëveshjen dhe një disbursim i tillë nën Grantin e by-pass-it të Vlorës IPA, është i disponueshëm në llogarinë e by-pass-it të Vlorës IPA për këtë qëllim. Data e fundit të vlefshmërisë së Grantit është 30.11.2017.

Me shkresën nr. 7426, datë 21.09.2017 “Ndërtimi i By – Passit të Vlorës, për grantin IPA, zgjatje e afatit të vlefshmërisë së Grantit” ARRSH ka kërkuar zgjatjen e afatit të vlefshmërisë deri në gusht 2020. Me shkresën nr. 980/1, datë 25.02.2019 “Mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BERZH për fondet EU/IPA 2011 për projektin “Ndërtimi i By – Pass-it të Vlorës”” është kërkuar shtyrje e afatit të vlefshmërisë së grantit deri në 28.02.2022. Me shkresën nr. 11150, datë 12.06.2019 Ministria ka përcjell shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së grantit deri në 30.11.2021. (miratuar 14 muaj me vonesë).

Sipas Neni 4 të Ligjit parashikohet se ARRSH do të ruajë të dhënat dhe llogaritë veçantë për Grantin në përputhje me standardet e kontabilitetit, nga auditimi rezulton se ARRSH nuk i ka mbjtur veçantë këto llogari por janë brenda bilancit të ARRSH në kundërshtim me Nenin 4

Marrëveshjet Financiare dhe Operacionale

Seksioni 4.01. Të Dhënat Financiare dhe Raportet

a) Marrësi duhet të sigurojë se ARRSH-ja do të ruajë të dhënat dhe llogaritë, veçmas në lidhje me Grantin, , të pranueshme nga Banka dhe të zbatueshme në mënyrë të vazhdueshme.

Marrësi, nëpërmjet ARRSH-së, do të sigurojë se informacioni i dhënë ndaj Bankës dhe të dhënat e ruajtura nga ARRSH-ja janë në përputhje me detyrimet e Marrësit në cilësinë e tij si Huamarrës, sipas seksionit 4.01 (Të Dhënat dhe Raportimet Financiare) të Marrëveshjes së Huas, si dhe seksionit 5.02 (c) (i) (Raportimi) të Rregullave dhe Kushteve Standardë:

1. përfshin informacion të detajuar në lidhje me Grantin dhe përdorimin e tij, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën;

2. përfshin informacion të nevojshëm për të mundësuar ndjekjen e mënyrës së përdorimit të Grantit nga Financimi i Huas;

3. përfshin informacion në lidhje me të dhënat, llogaritë dhe statuset financiare për të cilat Banka mund të drejtojë herë pas here kërkesë të arsyeshme.

c) Marrësi, nëpërmjet ARRSH-së, deri të paktën pesë (5) ditë pas datës së përfundimit të Projektit, do të kryejë detyrat e mëposhtme:

1. të mbajë dokumentet e llogarive dhe të dhëna në lidhje me aktivitetet e financuara nga Granti; si dhe

2. t'i vëre në dispozicion Bankës dhe/ose Donatorit, sipas kërkesës, të gjithë informacionin financiar, duke përfshirë statusin e llogarive, në lidhje me Projektin.

Nga auditimi rezulton se ARRSH deri në përfundim të periudhës objekt auditimi nuk ka raportuar në lidhje me përdorimin e fondeve të Grantit.

5. Me ligjin nr. 9342, datë 10.02.2005 "Për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mediocredito centrale (MCC s.p.a), për financimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnjë-Fier dhe mbikëqyrjen e punimeve për dy segmentet rrugore Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë".

Shuma në total e kredisë financiare të dhënë nga Qeveria Italiane është në vlerën 24.35 milionë Euro dhe ka si qëllim realizimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugorë Lushnje-Fier dhe supervizionin për dy segmentet e vazhdueshme Lushnje-Fier dhe Fier- Vlorë.

Nga auditimi u konstatua se shuma e akorduar për konsulencë, Supervizionim dhe mbikëqyrjen për By-pass e Fierit është në shumën 1 (një) milionë Euro dhe jo në shumën 1.8 milionë Euro, gjithashtu kjo shumë nuk është në formë grandi si është përcaktuar në marrëveshjen e BEI, por është pjesë e kredisë financiare të dhënë nga Qeveria Italiane nëpërmjet bankës Mediocredito centrale (MCC spa). Deri në fund të auditimit rezulton se nga Kredia janë akorduar për Supervizionim e By – Pass Fier 858,210 Euro

(Për sa më sipër Aktkonstatimi nr. 1, datë 22.04.2022).

2.2 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësin.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatuan problematika dhe vonesa në zbatimin e punimeve për By-Pass e Fierit dhe të Vlorës të cilat në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

Projekti "Ndërtimi i by-pass-eve të Fierit dhe Vlorës" është bashkë financim i Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Bankës Europiane të Investime (BEI), Qeverisë Italiane nëpërmjet Cooperazione Italia, Grandit nga llogaria EU/IPA (kanalizuar nga BERZH) dhe Kontribut Lokal nga Qeveria Shqiptare. Me këtë financim Qeveria Shqiptare nëpërmjet ARRSH-së në rolin e Njësisë Zbatuese të Projektit synon të zbatoj projektin:

a) Ndërtimin e një by-pass-i prej 22 km në qytetin e Fierit;

b)Ndërtimin e një by-pass-i prej 29 km në qytetin e Vlorës;

1. Për ndërtimin e "By-pass-it të Fierit", është lidhur Kontrata e Punimeve Civile me nr. 9719 prot., datë 05.11.2018, ndërmjet ARRSH-së dhe Kontraktorit "C....G....C....ing Co", me vlerë fillestare 37,944,221.56 Euro pa TVSH dhe vlerë të amenduar 48,971,853.7 Euro pa TVSH, me datë fillimi punimesh 16.11.2018, dhe me afat të amenduar të përfundimit të punimeve deri më datën 22.03.2022, kontratë e cila përfshin punimet: Rrugën kryesore, rrugët sekondare dhe rrugën lidhëse me Parkun Arkeologjik të Apolonisë.

1.1 "Rruga kryesore": Deri më datën 31.12.2021, ky segment ka përfunduar duke u bazuar në Certifikatën Përfundimtare të Punimeve të datës 15.06.2020, të lëshuar nga Supervizori i Punimeve

J.V. “S.....-Tecnic-SWS”. Marrja në dorëzim si aset nga ARRSH është kryer nëpërmjet procesverbalit të datës 19.07.2021, me objekt “Mbi marrjen përfundimtare në dorëzim të punimeve të kontratës “Ndërtimi i Segmentit Rrugor by-pass-i Fierit (Aksi kryesor)”, i mbajtur ndërmjet Komisionit të Marrjes në Dorëzim i ngritur në zbatim të urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së me shkresën nr. 7259/1 prot., datë 20.11.2014.

1.2 “Rrugët sekondare”: Nga Supervizori i Punimeve nga Mbikëqyrësi i Punimeve J.V. “S.....-Tecnic-SWS” është lëshuar Certifikata e Përkohshme e Punimeve e datës 22.02.2021. Aktualisht (deri më datën 31.12.2021), ky segment është në periudhën e garancisë.

1.3 “Rruga lidhëse e Apollonisë”: Deri më datën 31.12.2021, ky segment është në proces zbatimi punimesh.

2. Për ndërtimin e “By-pass-it të Vlorës”, është lidhur Kontrata e Punimeve Civile me nr. 9946 prot., datë 08.11.2018, ndërmjet ARRSH-së dhe Kontraktorit “G..... ” SHPK & “I..... di C..... ING M.....” S.p.A, me vlerë fillestare 35,874,357 Euro pa TVSH dhe vlerë të amenduar 47,004,710.80 Euro pa TVSH, me datë fillimi punimesh 22.11.2018, dhe me afat të amenduar të përfundimit të punimeve deri në muajin qershor 2022. Deri më datën 31.12.2021, ky segment është në proces zbatimi punimesh.

Objektivat

By-Passi i Vlorës do të ndihmojë në: (i) përmirësimin e integritetit rajonal, (ii) në facilitet e tregtisë, (iii) mbështetjen e zhvillimit të turizmit në pjesën jugore të Shqipërisë, (iv) përmirësimin e kushteve të transportit rrugor në zonën e Vlorës, (v) redukton ngjeshjen/ngarkesën/mbipopullimin e trafikut në qytetin e Vlorës si dhe në rrjetin rrugor të bregdetit jugor të Shqipërisë.

Rruga konsiston në një karrexhatë të vetme e kompozuar me 2 korsi (1 për çdo sens lëvizje), si dhe me një korsi të tretë shtesë ngjitëse në seksionet me pjerrësi të madhe. Kjo rrugë përbëhet nga 15 kryqëzime të tipeve të ndryshëm (p.sh. rreth rrotullime, të tipit T, etj); 27 mure mbajtës b/a me gjatësi totale 1600 metra; 22 mure me dhë të armuar me gjatësi totale 2000 metra; 5 Ura kryesore me gjatësia 50 -150m.

Në total disbursimet deri më datën 31.12.2021, për Projektin “Ndërtimi i by-pass-it të Vlorës”, në mënyrë analitike paraqitet si më poshtë:

Euro

Projekti “Ndërtimi i by-pass-it të Vlorës”									
Kontratat	Kontraktori	Vlera e kontratës pa TVSH	Disbursuar në total	Financimi nga donatorët sipas marrëveshjeve respektive					Realizimi në % sipas kontratave
				BEI	BERZH	IPA	IPA për supervizionin e punimeve	Kontribut Lokal nga Qeveria Shqiptare	
				18,000,000	18,000,000	17,000,000	3,158,500	700,000	
Disbursuar sipas donatorëve									
Punimet Civile e Vjetër	S.....	35,289,872.6	5,190,494.03	1,919,705.23	1,682,071.14	1,588,717.66	-	-	14.7%
Punimet Civile e Re	G.....	49,082,896.67	35,154,697.59	8,484,223.63	13,715,532.49	12,954,941.46	-	-	71.6%
Facilitetet	E..... O.....	74,000	74,000	74,000	-	-	-	-	100%
Asistencë Teknike e Vjetër	E.....	375,202.33	375,202.33	375,202.33	-	-	-	-	100%
Asistencë Teknike e Re	E.....	473,000	319,705	319,705	-	-	-	-	67.5%
Supervizioni i Punimeve	E..... O.....	3,858,500	3,126,585	-	-	-	3,126,585	-	81%
Totali		89,153,471.6	44,240,683.95	11,172,836.19	15,397,603.63	14,543,659.12	3,126,585	0	
Totali sipas realizimit të financimit në %				62%	85.5%	85.5%	98.9%	0%	
Financimi sipas donatorëve				18,000,000	18,000,000	17,000,000	3,158,500	700,000	56,858,500
Disbursuar sipas donatorëve				11,172,836.19	15,397,603.63	14,543,659.12	3,126,585	0	44,240,683.94

Diferenca e mbetur për t'u disbursuar sipas donatorëve	6,827,163.81	2,602,396.37	2,456,340.88	31,915	700,000	11,918,516.06
Diferenca për t'u disbursuar në %	38%	15.5%	15.5%	1.1%	100%	
Mbi realizimin e financimit të Projektit						
Kontratave	Punimeve Civile + Facilitetet + Asistencë Teknike				Supervizioni i Punimeve	
Financimi nga donatorët në total	53,000,000				3,858,500	
Disbursuar në total	41,114,098.94				3,126,585	
Shuma e cila mbetet ende nga financimet e donatorëve për kontratat	11,885,901				731,915	
Mbetet për t'u disbursuar për realizimin e kontratave	14,081,494.08				731,915	
Fonde të cilat duhet ende për realizimin e kontratave	2,195,593.08				0	

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me shkresën nr. 7234 datë 05.08.2021 “Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA 2022-2024 (Faza e Dytë)” Drejtori i Planifikimit të Buxhetit dhe Financës ka kërkuar planifikimin e fondeve buxhetore për projektet.

Me shkresën nr. 7284/3, datë 26.08.2021 “Mbi programin afatmesëm PBA 2022-2024” Drejtor i Drejtorisë së mirëmbajtjes ka përcjell vlerën e nevojshme për përfundimin e By Pass-ëve, konkretisht për By-pass Fier 224,067 Euro ose 27,112,000 lekë dhe për By-pass Vlorë 13,112,696.37 Euro ose 1,586,636,260.77 lekë.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nuk është realizuar objektivi i përgjithshëm i marrëveshjeve të financimit, konkretisht punimet civile për By Passin e Fierit duhet të kishin përfunduar brenda datës 03.06.2020, por afati është shtyrë disa herë, punimet për aksin kryesor kanë përfunduar më 30.08.2020, për rrugët sekondare më 20.01.2021 dhe rruga lidhëse me Parkun Arkeologjik të Apolonisë, deri në fund të periudhës së audituar nuk ka përfunduar ende. Për By Pass-in e Vlorës, punimet duhet të kishin përfunduar në 30.03.2022, afati përfundimtar nuk është miratuar ende pasi është në vlerësim nga ana e AK dhe supervisorit. Vonesat në realizimin e punimeve sjellin si pasojë shtyrjen në kohë të arritjes së objektivave dhe përfitimeve nga zbatimi i këtij projekti. Nevoja për shtyrjen e afateve ka ardhur si rezultat i problematikave që lidhen kryesisht me shpronësimet për pronat ku kalon gjurma e projektit, problemeve ligjore me kontraktorin “S.....”, si dhe mungesa e financimit për By Passin e Fierit nga BEI si pasojë e vonesave të shkaktuara nga Qeveria Shqiptare për shtyrjen e marrëveshjes së financimit, veprime të cilat japin ndikim negativ për të gjithë projektin. Si pasojë e problematikave të hasura dhe vonesave në zbatimin e projektit nga ana e kontraktorit të punimeve mund të ngrihet pretendimi për llogaritje (claim) në të ardhmen pasi vonesat janë si pasojë e kontraktuesit.

1. Titulli i gjetjes: Objektivat e përcaktuara në marrëveshjen nuk janë konkrete dhe të matshëm.

Situata: Referuar marrëveshjes së financimit qëllimi i projektit të by passit të Fierit është të përmirësohet udhëtimi kohor dhe i sigurt, në veçanti përmes trafikut, si dhe për të lehtësuar kongestionin dhe problemet mjedisore në qytetin e Fierit, ndërsa By-Passi i Vlorës do të ndihmojë në përmirësimin e integritetit rajonal, në facilitetet e tregtisë, mbështetjen e zhvillimit të turizmit në pjesën jugore të Shqipërisë, përmirësimin e kushteve të transportit rrugor në zonën e Vlorës, reduktimi i ngjeshjes/ngarkesës/mbipopullimit në trafikut në qytetin e Vlorës si dhe në rrjetin rrugor të bregdetit jugor të Shqipërisë. Objektivat e përcaktuara në marrëveshjen e ratifikuar për projektet e sipërpërmendura nuk janë objektiva konkrete dhe të matshme Kjo pasi nuk ka të dhëna të përcaktuara të kohës së shkurtuar me përfundimin e aksit të ri rrugor, nuk ka të dhëna krahasimore të kostos së operimit të automjeteve dhe të dhënave të sigurisë, lehtësimi i probleme mjedisore etj. duke e bërë të vështirë matjen e objektivave të përcaktuara në rast se punimet do të kishin përfunduar.

Kriteri: Ligji Nr. 8/2012, datë 09.02.2012 marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH); ligji nr. 80/2012 “Për ratifikimin e

kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)”; ligji nr. 109/2014 datë 31.07.2014 “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By-Passin e Vlorës.

Ndikimi/Efekti: Mos vlerësimi saktë të përfitimeve që arrihen nga zbatimi i objektivave.

Shkaku: Mungesa e indikatorëve.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: ARRSH në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira në hartimin dhe miratimin e marrëveshjeve të financimit të marrë masa që për projektet që hartohen në të ardhmen të përcaktohen objektiva të qarta dhe të matshme, me synim monitorimin e saktë të përfitimeve që arrihen nga zbatimi i tyre.

2. Titulli i gjetjes: Nuk është realizuar objektivi i përgjithshëm i marrëveshjeve të financimit.

Situata: Nuk është realizuar objektivi i përgjithshëm i marrëveshjeve të financimit i cili është ndërtimi i një by pass 22 km në qytetin e Fierit dhe 29 km në qytetin e Vlorës, konkretisht referuar kontratës punimet civile për By Passin e Fierit duhet të kishin përfunduar brenda datës 03.06.2018, por afati është shtyrë disa herë deri në datë 30.08.2020. Për By Passin e Vlorës, punimet referuar kontratës duhet të kishin përfunduar në 30.06.2018, por afati është shtyrë deri në 28.02.2021, duke sjellë si pasojë shtyrjen në kohë të arritjes së objektivave dhe përfitimeve nga zbatimi i këtij projekti. Nevoja për shtyrjen e afateve ka ardhur si rezultat i problematikave që lidhen kryesisht me shpronësimet për pronat ku kalon gjurma e projektit, si dhe mos bashkëpunimi i Bashkisë Vlorë në lidhje me pajisjen me dokumentacionin e pronësishë për banorët që preken nga ndërtimi i By-Pass-it të Vlorës, problemeve ligjore me kontraktorin “S.....”, si dhe mungesa e financimit për By Passin e Fierit nga BEI si pasojë e vonesave të shkaktuara nga Qeveria Shqiptare për shtyrjen e marrëveshjes së financimit, veprime të cilat japin ndikim negativ për të gjithë projektin. Si pasojë e problematikave të hasura dhe vonesave në zbatimin e projektit nga ana e kontraktorit të punimeve mund të ngrihet pretendimi për llogaritje (claim) në të ardhmen pasi disa prej vonesave janë si pasojë e kontraktuesit.

Kriteri: Ligji Nr.8/2012, datë 09.02.2012 marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH); ligji nr. 80/2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)”; ligji nr. 109/2014 datë 31.07.2014 “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By-Pass-in e Vlorës; Kontrata e zbatimit të punimeve nr. 9946 datë 08.11.2018, appendix to tender. Kontrata e zbatimit të punimeve nr. 9719 datë 05.11.2018, appendix to tender.

Ndikimi/Efekti: Vonësava të shkaktuara të cilat japin ndikim negativ për të gjithë projektin. Si pasojë e problematikave të hasura dhe vonesave në zbatimin e projektit mund të ngrihet pretendimi për llogaritje (claim) në të ardhmen nga ana e kontraktorit të punimeve pasi disa prej vonesave janë si pasojë e kontraktuesit.

Shkaku: Mos ndjekja në kohë e problematikave.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: ARRSH të marrë masa që për projektet në proces si dhe për projekte që do të financohen në të ardhmen, të zbatohen me korrektësi detyrimet kontraktore, duke zgjidhur praktikisht çështjet që kanë të bëjnë me shpronësimin për interes publik, problematika të cilat kanë lidhje me administrimin e pushtetit vendor, ndikimin në mjedis, si dhe problematika të cilat kanë lidhje me shtyrjen në kohë të afatit të disbursimeve etj., me synim minimizimin e riskut të vonesave, të cilat shoqërohen me mos arritjen e objektivave dhe kosto shtesë për Projektin.

(Për sa më sipër është mbajtur Aktkomstatimi nr. 2, datë 22.04.2022)

2.3 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimin e fondeve publike.

Projektet “Ndërtimi i By-pass-it Vlorës” Lot-1 dhe “Ndërtimi i By-pass-it Fierit” Lot-2 janë përfshirë në një procedurë prokurimi e cila është zhvilluar në 2 faza, ajo e para-kualifikimit dhe tenderi për vlerësimin e ofertave teknike dhe financiare.

Në zbatim të programit të auditimit është shqyrtuar dokumentacioni si më poshtë:

1. Raporte vlerësimi faza para-kualifikuese;
2. Raporte vlerësimi faza tenderit;
3. Korrespondenca me bankën (BERZH dhe BEI) nëpërmjet e-mail^{ve};
4. Urdhra të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH;
5. Dokumente Standarde të para-kualifikimit të bankës - Gusht 2017;
6. Dokumente Standarde të Tenderit të miratuara nga Banka;
7. Rregullat FIDIC (Federata Ndërkombëtare E Inxhinierëve Konsultues);

Me Njoftimin e nr. 3650, datë 08.05.2017 të ARRSH ka bërë të ditur Kontraktorit S..... C.....i Spa dhe Supervizorit S..... T..... SWS përfundimin e kontratës së ndërtimit të ByPass Fier.

Me Njoftimin nr. 05.05.2017 ARRSH ka bërë të ditur se ka përfunduar kontrata e punimeve për ByPass e Vlorës, Kontraktorit S..... C..... S.P.A., Supervizorit E..... O..... S.P.A., Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrinë e Financave, BERZH, BEI dhe Delegacionin e Bashkimit European në Shqipëri.

Vendimit të Gjykatës së Veronës datë 04.10.2017 për S..... S.P.A.

Me shkresën nr. 8963, datë 07.11.2017 ARRSH i kërkon mbikqyrësit të punimeve JV S..... T..... SWS, pika 2.1 “Kosto inxhinierike për përgatitjen e Dokumenteve të tenderit” vlerësimin dhe përlllogaritjen e vlerës së mbetur të punimeve dhe me shkresën nr. 8969, datë 07.11.2017 ARRSH i kërkon mbikqyrësit të punimeve E..... O.... AE, pika 2.1 “Kosto inxhinierike për përgatitjen e Dokumenteve të tenderit”

Pas rishikimeve nga ana e supervisorëve të gjendjes aktuale dhe të punimeve të nevojshme për përfundimin e dy By-passeve ato janë miratar në Këshill Teknik, konkretisht:

Me Vendimin nr. 8, datë 12.04.2018 Këshilli Teknik ka miratuar projektin e rishikuar të punimeve të mbetura mbas ndërprerjes së kontratës për By-Pass i Fierit.

Me Vendimin nr. 9, datë 12.04.2018 Këshilli Teknik ka miratuar projektin e rishikuar të punimeve të mbetura mbas ndërprerjes së kontratës për By-Pass i Vlorës.

Planifikimim i Prokurimit

Prokurimi i projektit “Ndërtimi i By-pass Fieri & Vlora” është publikuar në datën 15 Shtator 2017 dhe është përfunduar me lidhjen e 2 kontratave, përkatësisht datë 08.11.2018 për Lot-1 dhe 05.11.2018 për Lot-2.

Nga publikimi i ftesës për para-kualifikim kanë shprehur interesin e tyre për pjesëmarrje në projekt 84 kompani. Hapja e dokumenteve të para-kualifikimit është kryer në datën 27.10.2017 ora 12:00 në ambjentet e ARRSH në Tiranë. Nga proces verbali i mbajtur për këtë qëllim janë prezantuar 39 aplikantë për Lot 1 dhe 33 aplikantë për Lot 2. Aplikantëve u lejohet të kërkojnë të marrin pjesë në Lot 1 ose Lot 2 ose në të dyja sëbashku.

Programi dhe realizimi i prokurimit është treguar në tabelën si më poshtë:

Titulli projektit: Ndërtimi i By-pass Vlorë & Ndërtimi i By-pass Fierit	Klienti: Autoriteti Rrugor Shqiptar	Hua e bankës EBRD dhe BEI: Nr42319
Përmbajtja	Programi	Realizimi
-Ftesa për para-kualifikim.	15 Shtator 2017	15 Shtator 2017
-Afati i dorëzimit të aplikimit për para-kualifikim.	25 Tetor 2017, ora 12:00	25 Tetor 2017 ora 12:00

-Hapja e aplikimit për fazën e para-kualifikimit.	27 Tetor 2017, ora 12:00	27 Tetor 2017, ora 12:00
- Rezultati i fazës së para-kualifikimit dhe dakordësia e Bankës (No-Objection).	22 Nëntor 2017	22 Qershor 2018 Kanë kaluar fazën e para-kualifikimit 23 aplikantë.
-Ftesa për tender	30 Nëntor 2017	22 Qershor 2018
-Afati i dorëzimit të dokumenteve të tenderit.	15 Janar 2018	6 Gusht 2018
-Lidhja e kontratës	15 Shkurt 2018	05 Nëntor 2018 Fituesi Lot 2, C..... G..... C..... Company 37,944,211.56 Euro 08 Nëntor 2018 Fituesi Lot 1 "G..... ShPK. & I..... di C..... Eng. E.M..... S.p.a." 35,874,357.4 Euro

Me urdhrin nr. 8484 prot. datë 24.10.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Faza e para-kualifikimit

Procesi i vlerësimit për para-kualifikimin është prezantuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të ARRSH fillimisht me Raportin e Vlerësimit datë 21.11.2017, dhe më tej ky raport është rishikuar disa herë në datat 24.01.2018, 26.02.2018, 20.06.2018, duke përfshirë edhe rishqyrtimin nga ana e bankës.

Dokumentet Standarte të Para-kualifikimit, kanë parashikuar që, në mënyrë që të jenë kualifikues për të dy lotet së bashku, aplikantëve u kërkohet të plotësojnë kriterin mbledhës (cumulative). Aplikanti që nuk është në gjëndje të plotësojë kriterin mbledhës të para-kualifikimit për të dy lotet së bashku, por që mund të demonstrojë se ai plotëson kriterin e para-kualifikimit për secilin lot të veçantë, mund të jetë kualifikuar për pjesmarrjen në tender ose për Lot - 1 ose për Lot - 2, me kusht që të mos jetë e mundur të lidhë më shumë se një kontratë.

Gjatë auditimit është përdorur teknika e kombinuar e observimit dhe inspektimit të praktikave dhe dosjeve së prokurimit.

Në Raportin Final të Vlerësimit, 20 Qershor 2018 të ARRSH, janë propozuar tek Banka për të kaluar fazën e Para-kualifikimit 23 aplikantë për Lot 1 dhe Lot 2 dhe/ ose të dyja së bashku, siç tregohet në tabelën më poshtë:

Nr.	Aplikantët	Lot-1 & Lot-2	Lot-1 ose Lot-2	Lot-1	Lot-2
1.	P.....	Po			
2.	A.....	Po			
3.	C..... G.....	Po			
4.	S.....	Po			
5.	Ch..... R..... & B.....	Po			
6.	Ch..... S.....	Po			
7.	G..... L..... F.....	Po			
8.	CMC	Po			
9.	IL & FS	Po			
10.	S..... I..... per C.....e d'Acqua	Po			
11.	JV/O..... & G.....		Po		
12.	A.....			Po	
13.	G..... & M.....			Po	
14.	S..... Al-K.....			Po	
15.	T..... S.....			Po	
16.	INC			Po	
17.	A..... B.....			Po	
18.	L.....				Po
19.	M.....				Po
20.	A.....				Po
21.	INC & A.....				Po
22.	JV S..... & T.....				Po
23.	M.....				Po

Në datën 22 Qershor 2018 është dhënë pëlqimi (No-Objection) i bankës për fazën e para-kualifikimit dhe kalimi në fazën e tenderimit për vlerësimin teknik dhe financiar.

Nga auditimi ka rezultuar se:

Në deklarin sipas formatit të parashikuar në seksionin e III të dokumenteve standarde të para-kualifikimit nga aplikanti C....G....C.... Company janë prezantuar të dhëna për 3 kontrata të ngjashme me ato të projektit si më poshtë:

Kontrata 1: RA/212 ndërtimi i rrugëve dhe intersektimi në mesin e rrugëve Jahra, Kuwait me gjatësi 7,9 km. Kontrata është lidhur në datë 02.04.2012 dhe ka përfunduar në datën 01.08.2016 në vlerën EUR 127 million.

Kontrata 2: RA/124 Sabiya motorway faza 1, Kuwait është lidhur në datë 26.05.2006 dhe ka përfunduar në datën 22.12.2014 në vlerën EUR 68 million.

Kontrata 3: RA/184 184 “Kalimet në Autostradën Kryesore të Rrugëve në Unazën 6- Zona e Re Rezidenciale në Jahra” (7.5.4,1,3) me gjatësi 33 km, është lidhur në datën 29.08.2010 në vlerën EUR 109,0 million dhe ka përfunduar në datën 01.08.2016.

Gjithashtu, aplikanti C....G....C.... Company kishte prezantuar dokumentacionin mbështetës si më poshtë:

- Për kontratën RA/212, në dokumentet e prezantuara datë 04.12.2016 dhe 11.04.2017 është treguar se janë lëshuar certifikatat-pjesore fillestare në datën 01.08.2016 dhe 30.01.2017 por, nuk është sqaruar shkalla e realizimit të kontratës.

-Për kontratën RA/124, në proces-verbalin e datës 22.12.2014 të Komitetit të Inspektimit deklarohet se kontraktori me nënshkrimin e Final Take-Over Certificate në datën 11.09.2014. ka mbaruar punimet.

-Për kontratën RA/184, në shkresën e Ministrisë së Punëve Publike Kuwait, datë 24.11.2014, është treguar vetëm mbi proces-verbalet për dorëzimin e përkohshëm të punëve (temporary take-over) në datë 25.09.2014 dhe datë 20.10.2014, por nuk janë sqaruar as datat e nisjes së punimeve, punët e kryera dhe vlera e kontratës së realizuar.

Gjithashtu, referuar Raporteve të Vlerësimit të Aplikimit të Para-kualifikimit, të hartuara nga Komisioni i Vlerësimit të ARRSH përkatësisht në datën 21.11.2017 dhe 26.02.2018 është propozuar tek banka refuzimi i aplikantit C....G....C.... Company me arsyetimin se në zbatim të paragrafit 22.1.2 pika 2 (a) të dokumenteve standarde të para-kualifikimit aplikanti ka dështuar të paraqesë të paktën dy kontrata të ngjashme me kontratat e projektit.

Në këtë mënyrë, dokumentet mbështetëse për kontratat RA/212 dhe RA/184 nuk provojnë përfundimin me sukses të punimeve.

Qëndrimin fillestar të komisionit deri në raportin e datës 26.02.2018, për eksperiencën specifike të aplikantit “Combined Group” ju sqarojmë se:

Kjo kompani ka aplikuar për të dy Lotet, dhe për të përmbushur kushtin e kualifikimit “Specifik Eksperiencë” ka paraqitur 3 kontrata të ngjashme. KVO ka gjykuar se ky aplikant nuk përmbush kushtin dy kontrata të ngjashme për secilin lot si edhe disa pasaktësi në dokumentacion (si Final Taking Over Certificate) dhe për këtë arsye ka vlerësuar se nuk duhet të para-kualifikohet.

Nëpërmjet e-mali datën 20.12.2017 kërkohet nga Banka rritja e numrit të kompanive të para-kualifikuara nga KVO, duke konsideruar edhe Certifikatat Pjesore të përfundimit të punimeve.

Në datën 18 Mars 2018 me kërkesën e bankës dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. A Q (komunikimi me e-mail datë 16.03.2018) është angazhuar një konsulent i pavarur ndërkombëtar për të ndihmuar Komisionin e Vlerësimit të ARRSH në përgatitjen e raportit të vlerësimit për fazën e para-kualifikimit.

Në Raportin e Vlerësimit datë 20 Qershor 2018 Komisioni është shprehur për pranimin e aplikantit C....G....C.... Company, duke u mbështetur vetëm në deklaratimet e aplikantit sipas formatit të parashikuar në seksionin e III të dokumenteve standarde. Nga auditimi nuk ka rezultuar që komisioni i vlerësimit të ketë kërkuar saktësimin e dokumenteve shtesë mbështetës për të provuar kryerjen me sukses të punimeve, për të paktën dy kontratave të ngjashme.

Në dtën 6 Gusht 2018 C....G....C.... Company është ftuar të marrë pjesë në tenderin për projektin “Ndërtimi i By-pass Vlora & Fieri” dhe është renditur i dyti me vlerën e kontratës 35,939,485.30 EUR. Nga ana tjetër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka refuzuar vazhdimin e garës për aplikantin Altcom, i renditur në vendin e parë me 31,602,184.53 EUR, për arsye se nuk është plotësuar kushti i parashikuar në paragrafin 19.1 “Instruksionet për ofertuesin”, seksioni II të dokumenteve standarde të Bankës, lidhur me plotësimin e kushtit minimal të klasifikimit BBB të bankës së zgjedhur. Në këto kushte, C....G....C.... Company është shpallur fituese për projektin “Ndërtimi i By-pass^{it} Fierit” Lot-2. Në këto rrethana, pjesëmarrja e C....G....C.... Company në tenderin e datës 06 Gusht 2018 dhe është përfshirë në tender pa provuar eksperiencën specifike të saj.

Procedura e Tenderimit të Ofertave Teknike dhe Financiare

Projekti “Ndërtimi i By-pass Vlora & Fieri” është realizuar në një procedurë prokurimi me dy kontrata të ndryshme, por me të njëjtin numër identifikimi si më poshtë:

Ndërtimi i By-pass Vlora **Lot 1** me numër identifikimi 8794-GPN-42319.

Ndërtimi i By-pass Fieri **Lot 2** me numër identifikimi 8794-GPN-42319.

Kontratat janë bazuar në çmime fikse nëpërmjet ri-matjes në njësitë bazë, sipas Kushteve të Kontratave për Ndërtim, FIDIC (Federata Ndërkombëtare e Konsulentëve Ndërkombëtarë).

Numëri i aplikantëve që kanë blerë dokumentet e tenderit janë 16 nga të cilët 4 aplikantë për Lot1, 5 aplikantë për Lot2 dhe 7 aplikantë për Lot 1 & Lot 2.

Kosto e vlerësuar sipas planit të prokurimit është si më poshtë:

1. **Lot 1** Ndërtimi i By-pass Vlora **51.3** milion Euro.

2 **Lot 2.** Ndërtimi i By-pass Fieri **40.4** milion Euro.

Periodha e vlefshmërisë së tenderit është caktuar 120 ditë.

Procesi i hapjes së tenderit është kryer në datën 6 Gusht 2018 në orën 10:00 në prani të përfaqësuesve të aplikantëve dhe komisionit të vlerësimit sipas Urdhrit nr. 8484 prot. datë 24.10.2017

Në tender kanë marrë pjesë 12 aplikantë, nga të cilët 6 aplikantë për Lot 1, 3 aplikantë për Lot 2 dhe 3 aplikantë për Lot 1 & Lot 2.

Propozimet financiare të aplikantëve janë treguar si më poshtë:

Nr.	Aplikantët	Lot-1 Vlera e tenderit Pa TVSH Euro	Lot-2 Vlera e tenderit Pa TVSH Euro	Discount
1	C..... R..... & B.....	51,979,143.00	50,047,642.00	
2	INC	37,258,836.58		
3	Ing.M.....&G.....	34,829,523.36		
4	S.....	48,557,997.09	46,090,072.02	
5	S..... A. K.....	46,248,650.71		
6	A.....		31,602,184.53	
7	T..... S.....	46,206,284.60		9.35%
8	C..... G.....	36,738,927.32	35,939,485.38	
9	O..... & G.....		41,700,000.00	
10	INC & A.....		44,903,736.86	
11	A..... B.....	42,239,319.00		
12	A.....	47,392,458.07		

Sigurimi i tenderit është vendosur 800,000 EUR për projektin ndërtimi i By-pass Fieridhe 100,000 EUR për projektin ndërtimi i By-pass Vlorës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka propozuar për refuzim nga vazhdimi i garës aplikantët A.. dhe O... & G....., për arsye se nuk kanë plotësuar kushtin e parashikuar në paragrafin 19.1 “Instruksionet për ofertuesin”, seksioni II të dokumenteve standarde të Bankës, lidhur me sigurimin e tenderit, ku aplikantët nuk kanë plotësuar kushtin që banka e zgjedhur prej tyre të plotësojë kushtin e minimal të klasifikimit BBB. Në datën 25 Tetor 2018 është dhënë pëlqimi (No-Objection) i Bankës.

Sa sipër, mbi bazën e rezultateve përfundimtare janë lidhur kontratat si më poshtë:

Për Lot-1 “Ndërtimi i By-pass Vlorës” G..... & I.... C.... Ing. E. M..... me çmimin e tenderit 35,874,357.00 EUR (pa TVSH).

Për Lot-2 “Ndërtimi i By-pass Fierit” C....G....C.... Company me çmimin e tenderit 37,944,221.56 EUR.

2.4 Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

Projekti “Ndërtimi i by-pass-eve Fier-Vlorë”, financohet nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Europiane e Investimeve (BEI), Qeveria Italiane nëpërmjet Cooperazione Italia, Grantit nga llogaria EU/IPA (kanalizuar nga BERZH) me një financim në shumën totale 127,165,000 Euro si dhe Kontribut nga Qeveria Shqiptare në shumën totale prej 18,000,000 Euro të cilat do të përdoren për likuidimin e TVSH-së për shpenzimet e kontratave respektive sipas komponentëve që financohet nga marrëveshjet e huas të lidhura me Bankën Europiane të Investimeve (BEI), gjithashtu nga ky fond do të mbulohen shpronësimet, taksat doganore etj.. Në total kostoja e parashikuar për realizimin e Projektit shkon në shumën 145,165,000 Euro e cila shkon 63,965,000 Euro për ndërtimin e by-pass-it të Vlorës dhe 81,200,000 Euro për ndërtimin e by-pass-it të Fierit, konkretisht si më poshtë:

Euro

Financimi për Projektin “By-pass-in e Vlorës”			
Nr.	Ligji	Burimi i financimit	Shuma
1	Nr. 8/2012, datë 09.02.2012	Hua nga BERZH	53,000,000
2	Nr. 109/2014, datë 31.07.2014	Hua nga BEI	18,000,000
3	Nr. 52/2015, datë 14.05.2015	Grand nga fondet IPA për punimet e by-pass-it të Vlorës	17,000,000
4	Nr. 52/2015, datë 14.05.2015	Grand nga fondet IPA për supervizionin e mbikëqyrjen e punimeve të by-pass-it Vlorë	2,365,000
5	Buxheti i Shtetit	Kontributi i Qeverisë Shqiptare	8,600,000
Totali			63,965,000
Financimi për Projektin “By-pass-in e Fierit”			
Nr.	Ligji	Burimi i financimit	Shuma
1	Nr. 8/2012, datë 09.02.2012	Hua nga BERZH	35,000,000
2	Nr. 80/2012, datë 01.10.2012	Kredi nga banka BEI	35,000,000
3	Nr. 9342, datë 10.02.2005	Grand nga Cooperacioni Italian	1,800,000
4	Buxheti i Shtetit	Kontributi i Qeverisë Shqiptare	9,400,000
Totali			81,200,000
Totali i financimit sipas marrëveshjeve për Projektin “Ndërtimi i by-pass-eve Fier-Vlorë”			145,165,000

Burimi i të dhënave: Marrëveshjet e Financimit të Projektit.

a) Për Projektin “Ndërtimi i by-pass-it të Vlorës”, financimi është si më poshtë:

1. Me Ligjin nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, është ratifikuar në Parlament marrëveshja financiare për Projektin “Ndërtimi i by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”. Nëpërmjet kësaj huaje Qeveria Shqiptare përfaqësuar nga Ministria e Financave synon të zbatojë projektin për ndërtimin e dy by-pass-eve konkretisht:

- a) ndërtimin e një by-pass-i 22 km në qytetin e Fierit (komponenti 1);
 b) ndërtimin e një by-pass-i 29 km në qytetin e Vlorës (komponenti 2);

Banka bie dakord t'i japi hua Huamarrësit, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara ose që përmenden në këtë Marrëveshje shumë prej 53,000,000 Euro. Huaja përbëhet nga dy transhet e mëposhtme:

1. Transhi A në shumë prej 35,000,000 Euro;
2. Transhi B në shumë prej 18,000,000 Euro;

Në lidhje me transhet e përmendura më sipër për komponentin 2 (by-pass-in e Vlorës) akordohet shuma 18,000,000 Euro të cilat në marrëveshjen e huas parashikohen të lëvrohen si transhi B.

Referuar nenit 2, pika 3, gërma "F", parashikohet se: Data e fundit e disponueshmërisë për huan e transhit A është 30 Prill 2015 dhe për huan e transhit B është data e përvjetorit të tretë të datës së fillimit të transhit B, ose një datë e mëvonshme që Banka sipas diskrecionit të saj, mund të vendosë dhe njofton Huamarrësin.

Referuar angazhimeve të marrëveshjes së huas për komponentin 2 (Ndërtimi i by-pass-it të Vlorës) punimet pritej të përfundonin më datën 30.06.2015. Sipas letrës së Ministrit të Financave me nr. 9280/1 prot., datë 23.06.2015, i kërkohet përfaqësuesit të BERZH-it shtyrja e afatit të kredisë deri në vitin 2017.

Amendimi nr. 1, është paraqitur në ARRSH me letrën e Ministrit të Financave nr. 11150 prot., datë 12.06.2019, në të cilën miratohet afati i fundit për kryerjen e disbursimeve për transhin B të marrëveshjes së huas deri më datën 31.03.2022.

Shuma minimale e tërheqjes është 300,000 Euro, shuma minimale e parapagimit është 3,000,000 Euro, shuma minimale e anulimit është 1,000,000 Euro datat e pagimit të interesit janë 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti.

Huamarrësi duhet të shlyej huan e transhet A dhe B, secilin në 24 kështe gjashtëmujore në datat 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti, me datën e parë të shlyerjes së huas për transhin A dhe B që bie në datën e ardhshme të pagimit të interesit pas vitit të tretë të Marrëveshjeje. Huamarrësi nuk mund të tërheq të gjithë transhin A dhe/ose, shumë e transhit B përpara datës së shlyerjes së parë të huas të përcaktuar në seksionin 2.02, të Marrëveshjes.

Banka shtyn datën e fundit të disponueshmërisë në lidhje me transhin A dhe/ose transhin B në një datë që bie pas datës së shlyerjes së parë të huas, atëherë shuma e secilës tërheqje të bërë në ose pas datës së shlyerjes së parë të huas do të alokohet për shlyerje në shuma të barabarta në disa data të shlyerjes së huas që bien pas datës së kësaj tërheqjeje.

Norma e tarifës së detyrimit financiar është 0.5% në vit. Tarifa e detyrimit financiar për huan e transhit B është e pagueshme nga data e fillimit të transhit B. Huaja e BERZH i nënshtrohet një norme të ndryshueshme interesi. Shuma e disponueshme mund të tërhiqet herë pas here për dy komponentët dhe komisionin fillestar.

Euro

Kategoria	Shuma e huas	Shpenzimeve që financohen në %
Punimet për pjesën B të komponentit 1 (By-pass-i i Fierit)	34,650,000	20.75% pa taksa
Punimet për pjesën B të komponentit 2 (By-pass-i i Vlorës)	17,820,000	10.67% pa taksa
Komisioni fillestar	530,000	100 %
Totali	53,000,000	

Burimi i të dhënave: Marrëveshja e Huas.

Ministri i Financave është caktuar si përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit për qëllimin e marrjes së çdo mase të kërkuar ose të lejuar për t'u marrë sipas dispozitave të seksionit 2.03, të Marrëveshjes dhe sipas dispozitave të seksioneve 3.01 dhe 3.02, të termave dhe kushteve standarde të huas.

Huamarrësi, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar fonde të mjaftueshme për përfundimin e projektit dhe i vë të gjitha këto fonde në dispozicion të projektit si kontribut të parimbursueshme për financimin e kostove të projektit.

Në zbatim të nenit 4, seksioni 4.01, gërma “b”, pika 1, parashikohet se, Huamarrësi i’ a nënshton të dhënat dhe llogaritë e përmendura në seksionin 4.01 (a) për çdo vit fiskal, auditimit nga auditë të pavarur të pranueshëm për Bankën, në përputhje me parimet dhe standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht. 2. I jep Bankës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti fiskal, raportin e këtij auditi nga këta auditë dhe fushën e veprimit dhe në hollësira që Banka mund të kërkojë.

Në zbatim të nenit 6, seksioni 6.04, parashikohen kushtet të cilat duhen të përmbushen për disbursimin e transhit B, i cili ka të bëjë me kushtet për disponueshmërinë e transhit B konkretisht: Transhi B do të vihet në dispozicion me diskrecionin e plotë të Bankës në bazë të respektimit të kushteve të mëposhtme:

a) Huamarrësi nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i ka dorëzuar Bankës dokumentacionin e projektit për komponentin 2, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

b) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i ka dorëzuar Bankës një dokument që përcakton strategjinë e taksave rrugore, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

c) Huamarrësi i ka paraqitur Bankës një plan financimi dhe prova të disponueshmërisë së këtij financimi për komponentin 2, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

d) Huamarrësi përmbush të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

e) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se projekti është strukturuar për të respektuar kërkesat e përcaktuara të performancës dhe se studimet mjedisore dhe sociale për kontrollin e biznesit, njoftimi i informacioneve dhe angazhimi i aktorit për komponentin 2, janë realizuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara të performancës.

f) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i ka dorëzuar Bankës një plan mjedisor dhe social veprimi për komponentin 2, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

g) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se Huamarrësi ka realizuar komponentin 1 në pajtim me kërkesat e përcaktuara të performancës, planin mjedisor dhe social të veprimit për komponentin 1 dhe planin e veprimit të rivendosjes për komponentin 1.

h) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i ka paraqitur Bankës një plan veprimi të rivendosjes për komponentin 2, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

i) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se të gjitha të drejtat e truallit të nevojshme për zbatimin e komponentit 2 janë fituar nga Huamarrësi dhe janë vënë në dispozicion të kontraktorit të punimeve civile (ose se Huamarrësi ka të drejtë të fitojë këto të drejta trualli në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm shqiptar dhe se shumica të mjaftueshme janë rezervuar nga Huamarrësi për fitimin e këtyre të drejtave të truallit në kohën e duhur) dhe konfirmim se plani i veprimit të rivendosjes është duke u zbatuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara të performancës.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se, nga ARRSH nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion ku të vërtetohet se angazhimet e parashikuara në nenin 6, seksioni 6.04, të jenë realizuar në zbatim të përmbushjes së kushteve për disponueshmërinë e transhit B.

Lëvrimi i fondeve për komponentin 2 (Ndërtimi i by-pass-it të Vlorës), kryhet nga donatori në llogari të OE sipas situacioneve përkatëse.

2. Midis Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit European më datë 30.11.2011, është nënshkruar marrëveshja financiare, ku palët kanë rënë dakord që KE akordon një kontribut financiar në shumën 82,000,000 Euro, të cilat do të alokohen sipas programit nacional për gjashtë sektorë, ndër të cilët është edhe sektori i transportin për shumën 19,360,000 Euro ose 24% e kontributit total. Shuma e akorduar për zhvillimin e transportit është destinuar për implementimin e projektit për “Ndërtimin e by-pass-it të Vlorës”. Masa e investimit nga fondet IPA për by-pass-in e Vlorës është në masën 38% të kostos totale të Projektit. Shuma e fondeve IPA për projektin është destinuar për financimin e dy aktiviteteve të projektit, konkretisht: shuma 17,000,000 Euro për punimet e ndërtimit dhe pjesa e mbetur 2,365,000 Euro për supervizionin dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit të by-pass-it të Vlorës.

Afati i disbursimit ka qenë nga data 10.03.2015, deri më datë 09.11.2018. Me amendimin nr. 6, është kryer ndryshimi i afatit të disbursimit konkretisht me një afat nga data 14.09.2021, deri më datë 15.10.2023.

Në kushtet kur janë pezulluar punimet nga OE “S..... C..... S.p.A” dhe rilidhjes së kontratës së re të ndërtimit të punimeve me BOE “G.....” SHPK & “I..... di C..... Ing. E. M.....” u bë e detyrueshme e shtyrja e afatit të përfundimit të kontratës për supervizionin dhe mbikëqyrjen e punimeve me Shoqërisë “E..... O.....” S.a për të cilën ka një shtesë financimi nga KE në shumën 793,200 Euro si dhe Kontribut nga Qeveria Shqiptare në shumën 700,000 Euro për përfundimin e kësaj kontrate ku financimi për këtë shërbim shkon në shumën 3,858,500 Euro. Ky financim kalon nga KE direkt në llogari të supervizorit sipas situacioneve përkatëse.

3. Me Ligjin nr. 52/2015, datë 14.05.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes së grandit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për investim nga llogaria EU/IPA e by-pass-it Vlorë për by-pass-in e Vlorës”, është ratifikuar marrëveshja për akordimin e shumës 17,000,000 Euro për aktivitetin e komponentin 2 ndërtimin e by-pass-it të Vlorës. Shuma është rënë dakord se do të përdoret për punimet e ndërtimit të by-pass-it të Vlorës, si dhe financimi dhe disbursimi i shumës do të bëhet nëpërmjet BERZH. Në marrëveshjen financiare është përcaktuar se afati i fundit i disbursimit të shumës së grandit do të jetë data 30.11.2017, ose ndonjë datë e mëvonshme për të cilën palët do të bien dakord. Shuma e disbursimit nga grandit do të kryhet në sasi jo më pak se 250,000 Euro. Tabela e mëposhtme tregon zërat e shpenzimeve të financuara nga grandit, për punimet e ndërtimit:

Euro		
Zërat e financuar nga grandit	Vlera e akorduar nga grandit	Vlera e akorduar nga grandit në (%)
Punime ndërtimi për by-pass-in e Vlorës	16,787,500	98.75%
Tarifa administrative	212,500	1.25%
Totali	17,000,000	100%

Burimi i të dhënave: Marrëveshja e Huas.

Tarifa e administrimit është për mbulimin e kostos së menaxhimit dhe të administrimit të Programit IPA dhe kontributin e kërkuar nga BERZH sipas Marrëveshjes IPA për by-pas-in e Vlorës. Referuar nenit 2, seksioni 7.02, gërma “a”, përcaktohet se: E drejta e Marrësit për të kërkuar një Disbursim nën Grantin e by-pass-it të Vlorës IPA, në përputhje me këtë Marrëveshje, do të bëhet efektive në datën e hyrjes në fuqi dhe do të përfundojë në datën e fillimit: i) të Afatit të fundit të disponibilitetit për kështin e dytë të huas, siç përshkruhet në Marrëveshjen e Huas) të specifikuar në seksionin 2.02 (f) (Kushte të Tjera Financiare të Huas) të Marrëveshjes së Huas; ose ii) 30 nëntor 2017; ose në një datë të mëvonshme që Banka, sipas diskrecionit të saj dhe në përputhje me marrëveshjen e Marrësit, mund të vendosë dhe të njoftojë Marrësin.

Amendimi nr. 1, është paraqitur në ARRSH me letërën e Ministrit të Financave nr.11150 prot. datë 12.06.2019, në të cilën miratohet afati i fundit për kryerjen e disbursimeve të marrëveshjes së huas

deri më datën 30.11.2021, katërmbëdhjetë muaj me vonesë. Ky financim kalon nga donatori direkt në llogari të supervisorit sipas situacioneve përkatëse.

4. Me Ligjin nr.109/2014 datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, është ratifikuar marrëveshja financiare për kredinë në shumën 18,000,000 Euro që Banka BEI ka rënë dakord t’i akordoj Qeverisë Shqiptare për ndërtimin e “By-pass të Vlorës”.

Huamarrësi ka deklaruar që Autoriteti Shqiptar i Rrugëve nëpërmjet Ekipit të Zbatimit të Projektit secili i lidhur me Ministrinë Shqiptare të Transportit dhe Infrastrukturës, po ndërmerr një projekt që përbëhet nga ndërtimi i një autostrade 29 km që anashkalon qytetin e Vlorës për të përmirësuar rrjedhën e trafikut përgjatë bregut jugor të Shqipërisë.

Banka BEI ka vlerësuar se kostoja totale e Projektit (pa TVSH) është 67,600,000 Euro, për t’u financuar, në një shumë të mjaftueshme për të mbuluar koston aktuale totale të Projektit, me një Kredi nga Banka (BEI), një Hua nga BERZH-i, grante të Instrumentit të Para-Aderimit (IPA) të Komisionit Evropian dhe fonde të veta. Kontributi i fondeve të veta (Qeveria Shqiptare) është parashikuar në datën e kontratës financiare të arrijë në shumën 8,600,000 Euro.

Me qëllim arrijtjen e këtij plani financiar, Huamarrësi i ka kërkuar Bankës BEI një kredi. Duke pasur në konsideratë vlerësimin e koston totale të Projektit, Banka ka aprovuar një kredi në shumën 24,000,000 Euro në total, por Huamarrësi dhe Banka kanë rënë dakord që kredia që do të lëvrohet për projektin e “By-pass-in e Vlorës” të jetë në shumën 18,000,000 Euro, me kushtin kryesor që kredia do të përdoret ekskluzivisht për të financuar komponentët e Projektit në lidhje me punimet civile.

Sipas kësaj marrëveshje huaje, “Ndërtimi i by-pass-it të Vlorës” pritej të përfundonte deri në tre mujorin e parë të 2017. Me amendamentin nr. 1, është paraqitur me anë VKM nr. 194, datë 04.03.2020, në të cilën miratohet afati i fundit për kryerjen e disburseve për marrëveshjen e huasë datën 31.03.2022, afërsisht 30 muaj me vonesë.

Huaja e Bankës BEI është dhënë me kushtin që të mos kalojë në asnjë rast 50% të koston totale të parashikuar të Projektit.

Procedura e disburseve është përcaktuar në nenin 1 të ligjit dhe përcakton se Banka do ta disbursojë Kredinë në deri 6 (gjashtë) transhe. Shuma e çdo transhi, nëse nuk është balanca e pa tërhequr e Kredisë, do të ketë një shumë minimale prej 3,000,000 Euro.

Huamarrësi mund, drejtpërdrejt, ose nëpërmjet Zbatuesit (i autorizuar rregullisht nga Huamarrësi), t’i paraqesë Bankës një kërkesë për disburseve e një transhi, ku një kërkesë e tillë disburseve duhet të merret të paktën 15 ditë para datës së fundit të disponueshmërisë.

Disburseve, do të bëhet në atë llogari të Huamarrësit që ky i fundit do t’i njoftojë me shkrim Bankës jo më vonë se 15 ditë para datës së disburseve të planifikuara në kërkesën e disburseve.

Brenda 10 ditësh pas disburseve të çdo transhi, Banka do t’i paraqesë Huamarrësit tabelën e amortizimit të sipas përcaktimeve të përmendur në nenin 4.01, sipas rastit, duke treguar datën e disburseve, monedhën, shumën e disburuar, termat e shlyerjes dhe normën e interesit për atë transh. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, është bërë kërkesa për disburseve e transhit të parë më datë 01.06.2015, në shumën 3,500,000 Euro, transhit të dytë më datë 08.05.2020, në shumën 3,500,000 Euro, dhe transhit të tretë më datë 04.06.2021, në shumën 3,000,000 Euro pra 10,000,000 Euro gjithsej.

Huamarrësi do të përdorë, dhe do të garantojë që Zbatuesi të përdorë, të gjitha shumat e marra hua prej tij sipas kësaj Huaje për zbatimin e Projektit, si dhe do të sigurojë që ai ka të disponueshme të gjitha fondet e tjera të duhura për financimin e Projektit.

Huamarrësi do të sigurojë që Zbatuesi ta përmbushë Projektin në pajtim me Përshkrimin Teknik që mund të ndryshohet herë pas here me aprovimin e Bankës, dhe ta përfundojë atë brenda datës përfundimtare të përcaktuar.

Nëse kostoja totale e Projektit e kalon shifrën e parashikuar, Huamarrësi do ta përftojë financimin për të financuar koston shtesë pa iu drejtuar Bankës, për të mundësuar që Projekti të përfundojë në pajtim me Përshkrimin Teknik. Planet për të financuar koston shtesë do t'i komunikohen Bankës. Zbatuesi/ARRSH duhet të mbajë libra dhe regjistra të rregullt llogarish, në të cilat bëhen hyrje të plota dhe të sakta për të gjitha transaksionet financiare dhe sendet pasurore dhe biznesi i Zbatuesit, duke përfshirë shpenzimet në lidhje me Projektin dhe regjistra të kontratave të financuara nga shumat e Huas, duke përfshirë një kopje të vetë kontratës dhe dokumentet e rëndësishme në lidhje me prokurimin për të paktën 6 vjet nga përmbushja thelbësore e kontratës.

Huamarrësi do të garantojë ose do të garantojë që Zbatuesi do t'i dorëzojë Bankës:

(i) informacionin në përmbajtje dhe formë, dhe kohën, e specifikuar në skedulën A.2 ose siç është rënë dakord ndryshe here pas here nga palët në kontratë; dhe

(ii) çdo informacion ose dokument tjetër në lidhje me financimin, prokurimin, zbatimin, operimin dhe çështjet mjedisore të dhe për Projektin që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshëm brenda një afati të arsyeshëm, në çdo rast me kusht që nëse ky informacion ose dokument nuk i paraqitet Bankës në kohë dhe Huamarrësi nuk e korrigjon këtë mosveprim brenda një afati kohe të arsyeshëm të caktuar nga Banka me shkrim, Banka mund të korrigjojë mangësinë, në masën e mundshme, nëpërmjet angazhimit të personelit të saj ose të një konsulenti ose një pale të tretë, me shpenzimet e Huamarrësit dhe Huamarrësi do t'u ofrojë këtyre personave dhe të gjithë asistencën e nevojshme për këtë qëllim.

Gjithashtu, duhet t'i paraqesë për aprovim Bankës pa vonesë çdo ndryshim të konsiderueshëm të Projektit, duke marrë parasysh gjithashtu deklaratimet e bëra Bankës në lidhje me Projektin para nënshkrimit të Kontratës, në lidhje me, ndër të tjera, çmimin, projektimin, planet, planifikimin kohor ose programin e shpenzimeve ose planin e financimit për Projektin.

1. Titulli i Gjetjes: Mos plotësim i dokumentacionit për bankën (BEI).

Situata: Për periudhën objekt auditimi nga ARRSH në rolin e Njesisë së Zbatimit të Projektit nuk ka dorëzuar tek Banka Europiane e Investimeve informacion në përmbajtje dhe formë dhe kohën e specifikuar në Skedulën/Formularin A.2, ose siç është rënë dakord në kontratën e financimit.

Kriteri: Ligji nr. 109/2014, datë 31.07.2014, "Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës", neni 8, seksioni 8.01.

Ndikimi/Efekti: Vonesë financimi nga banka (BEI).

Shkaku: Mos implementimi i dispozitave ligjore të parashikuara në marrëveshjen e financimit të Projektit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: ARRSH në rolin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit referuar kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen e financimit të projektit, me qëllim ecurinë e disbursimeve pa vonesa dhe përfundimin e Projektit në afatin e caktuar.

2. Titulli i Gjetjes: Mos dokumentimi i veprimeve financiare sipas legjislacionit.

Situata: Për periudhën objekt auditimi ARRSH nuk ka mbajtur të regjistruara në sistemin e kontabilitetit libra dhe regjistra të rregullt llogarish, ku të pasqyrohen saktë hyrje të plota dhe të sakta për të gjitha transaksionet financiare, duke përfshirë shpenzimet në lidhje me Projektin dhe regjistra të kontratave të financuara nga shumat e huas, por veprimet financiare janë hedhur në programin "Excel".

Kriteri: Ligji nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, neni 6, seksioni 6.07.

Ndikimi/Efekti: Vonesë financimi nga banka (BEI).

Shkaku: Mos implementimi i dispozitave ligjore të parashikuara në marrëveshjen e financimit të Projektit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Strukturat drejtuese të ARRSH dhe Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrin masa për implementimin e një programi financiar, me qëllim evidentimin dhe pasqyrimin e saktë të veprimeve financiare, ecurinë e kontratave dhe çdo transaksioni që kryhet për Projektin.

Disbursimet nga huaja kalojnë nga donatori tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, ku nga MFE për këtë hua është hapur llogaria speciale në bankën e nivelit të dytë me numër 689683, më datë 11.05.2015, konkretisht në Credins Bankë ku nga kjo llogari më pas kalojnë pagesat tek kontraktorët sipas situacione përkatëse.

Në total vlera e përlllogaritur për ndërtimin e “By-pass-it të Vlorës”, duke përfshirë edhe Kontributin Lokal nga Qeveria Shqiptare i cili përfshin mbulimin e TVSH-së, taksës doganore, shpronësime etj., është parashikuar në shumën 63,965,500 Euro, konkretisht të dhënat paraqiten si më poshtë:

Nr.	Burimi i financimit	Shuma e financimit
1	Hua nga BERZH	18,000,000
2	Hua nga BEI	18,000,000
3	Grand nga fondet IPA për punimet e by-pass Vlorë	17,000,000
4	Grand nga fondet IPA për supervizionin e mbikëqyrjen e punimeve të by-pass Vlorë	2,365,000
5	Kontributi i Qeverisë Shqiptare	8,600,000
Totali		63,965,000

Euro

Burimi i të dhënave: Marrëveshjet e Huas.

Për realizimin e Projektit “Ndërtimi i by-pass-it të Vlorës” është përcaktuar që të jetë i ndarë në dy komponentë:

- A “Për supervizioni dhe mbikëqyrjen e punimeve”.
- B “Për punimet e ndërtimit”.

Për realizimin e të dy komponentëve të sipërpërmendur janë nënshkruar kontratat si më poshtë:

Kontrata “Për supervizionin dhe mbikëqyrjen e punimeve”.

1. Kontrata nr. 2013/332-025, datë 22.11.2013, lidhur midis përfaqësuesve të Komisionit Europian dhe Shoqërisë “E..... O.....” S.a me objekt “Supervizioni i punimeve për ndërtimin e by-pass-it të Vlorës”, me vlerë fillestare 1,663,300Euro pa TVSH dhe me vlerë të amenduar 3,858,500 Euro pa TVSH me një rritje në vlerën 2,195,200 Euro nga kontrata fillestare. Gjithashtu kontrata ka pësuar amendime mbi mënyrën e financimit dhe afatit të përfundimit të saj konkretisht si më poshtë:

Euro

Kontrta	Vlera	Data e fillimit të shërbimit	Data e përfundimit të shërbimit	Kohëzgjatja	Vlera e rishikuar
Origjinale	1,663,300	10.03.2015	09.11.2018	44 muaj	
Adendum 1	-	03.04.2015	Këto addendum-e kanë qenë për zëvendësim stafi dhe nuk kanë efekt financiar dhe kohor.		
Adendum 2	-	14.09.2015			
Adendum 3	-	03.05.2016			
Adendum 4	-	24.11.2016			
Adendum 5	1,495,200	12.11.2018	30.11.2021	36 muaj + 21 ditë	3,158,500
Adendum 6	700,000	14.09.2021	15.10.2023	22.5 muaj	3,858,500

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Në nenin 19, pikat 19.1 dhe 19.2, është përcaktuar se implementimi i kontratës do të fillojë brenda 6 muajve nga firmosja e kontratës nga të dy palët dhe nga menaxheri i projektit, i cili është përfaqësues i Komisionit Evropian. Afati i implementimit të kontratës është 44 muaj nga data e fillimit. Kontrata e punimeve për ndërtimin e “By-pas-it Vlorë” është parashikuar që të përfundojë realizimin brenda datës 13.10.2017.

Nga auditimi u konstatua se, nga ecuria e punimeve të ndërtimit në “By-pass-in e Vlorës” dhe nga pretendimeve të OE “S.... C..... S.p.A”, për pagesën e situacioneve, si dhe nga stopimi i punimeve në këtë by-pass, afati i përcaktuar për realizimin në 13.10.2021, nuk është arritur. Rrjedhimisht me shtyrjen e këtij afati do të lind nevoja e rishikimit të afatit për kontratën e supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve e cila duke qenë se është kontratë që paguhet me kohë do të shoqërohet me kosto shtesë.

Me disa shkresa Komisionit Evropian i është drejtuar në vazhdimësi ARRSH ku i ka kërkuar informacion në lidhje me vonesat për fillimin e zbatimit të kontratës së supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve si dhe i ka kërkuar marrjen e masave për finalizimin e procedurës së prokurimit për punimet e ndërtimit të by-pass-it Vlorë. Me shtyrjen e afatit kohor të punimeve si pasojë e stopimit të tyre, vonesat për kohën e zhvillimit të procedurave të tenderit deri në 08.10.2018, me nënshkrimin e kontratës së re, pra 3 vjet vonesë, është nënshkruar midis përfaqësuesit të KE kontratë amendimi 5, datë 12.11.2018, nr. 2013/332-025/ 2018/401-331, ku është përcaktuar afati i saj prej tetor 2018 deri në 30.11.2021, dhe vlera 3,158,500 Euro.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion me amendimin 6, datë 14.09.2021, nr. 2013/332-025/ 2018/401-331, me amendimin nr. 6, është shtyrë afati i disbursimit deri më datën 15.10.2023, me 22.5 muaj si dhe është amenduar vlera e kontratës prej një shtese në shumën 700,000 Euro nga Qeveria Shqiptare, ku vlera e kontratës shkon 3,858,500 ose 1,493,500 Euro më tepër se parashikimi (2,365,000 Euro sipas marrëveshjes financiare të nënshkruar më datë 30.11.2011, midis Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit Evropian).

Në total për kontratën e supervizionit dhe mbikëqyrjen e punimeve për by-pass-in e Vlorës me vlerën 3,858,500 Euro është disbursuar shuma 3,126,585 Euro ose realizuar në masën 81% për 16 situacione punimesh duke përfshirë edhe paradhënien në masën 10% konkretisht: IPC nr. 1, në vlerën 332,545 Euro, IPC nr. 2, në vlerën 211,300 Euro, IPC nr. 3, në vlerën 318,935 Euro, IPC nr. 4, në vlerën 301,540 Euro, IPC nr. 5, në vlerën 288,670 Euro, IPC nr. 6, ku është kryer ripagimi i paradhënies dhe vlera për pagesë është 0, IPC nr. 7, në vlerën 23,135 Euro, IPC nr. 8, në vlerën 20,730 Euro, IPC nr. 9, në vlerën 21,550 Euro, IPC nr. 10, në vlerën 299,040 Euro, IPC nr. 11, në vlerën 178,205 Euro, IPC nr. 12, në vlerën 328,830 Euro, IPC nr. 13, në vlerën 273,115 Euro, IPC nr. 14, në vlerën 244,940 Euro, IPC nr. 15, në vlerën 61,230 Euro, IPC nr. 16, në vlerën 222,820 Euro. Gjithashtu nga Qeveria për 16 situacionet e punimeve të sipërpërmendura është likuiduar TVSH-ja në shumën totale 81,284,616.8 lekë ose 625,317 Euro. Gjithashtu për 10 situacione punimesh konkretisht: IPC nr. 1, IPC nr. 2, IPC nr. 3, IPC nr. 4, IPC nr. 7, IPC nr. 9, IPC nr. 10, IPC nr. 11, IPC nr. 15, dhe IPC nr. 16 janë konstatuar vonesa në likuidimin e TVSH-së, pra këto pagesa nuk janë kryer brenda afateve të parashikuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7. (sipas tabelës paraqitur në anekset e Projekt Raportit të Auditimit).

Këto pagesa janë kryer sipas situacioneve të paraqitura dhe certifikatave të miratuara nga personat përgjegjës. Gjithashtu konstatohet se, kontrata për supervizionin dhe mbikëqyrjen e punimeve të “By-pass-it të Vlorës” është rritur me 1,493,500 Euro nga parashikimi i financimit në marrëveshjen e Grantit (3,858,500 Euro - 2,365,000 Euro = 1,493,500 Euro) si pasojë e shtyrjes së afatit të punimeve, vlerë e cila përbën kosto shtesë për Projektin. Lëvrimi i fondeve për këtë kontratë kalon direkt nëpërmjet donatorit në llogari të Shoqërisë “E..... O.....” S.a.

Kontrata “Për punimet e ndërtimit”.

1. Kontrata e datës 19.03.2015, lidhur midis OE “S..... Co..... S.p.A” me objekt “Për ndërtimin e punimeve të by-pass-it të Vlorës”, me vlerë kontrate 35,289,872 Euro pa TVSH me datë të fillimit të punimeve 15.04.2015. Nga auditimi u konstatua se, shuma e likuiduar për këtë kontratë është 5,639,497 Euro ose në masën 15.9 % të vlerës së kontraktuar. Gjithsej janë kryer pagesa në vlerën 4,952,860 Euro për OE “S..... Co..... S.p.A”, pagesa në vlerën 131,614 Euro për nënkontraktorin e nominuar “K.....XH” SHPK, pagesa në vlerën 106,019 Euro për nënkontraktorin e nominuar “F..... shpk”, pagesa në vlerën 374,994 Euro për “E..... S..... I.....” për “Asistencën Teknike për Projektete bypass-in Fier-Vlorë” dhe pagesa në vlerën 74,000 Euro për “E..... O.....” për “Facilitete për supervizionin dhe mbikëqyrjen e punimeve të by-pass-it të Vlorës.

Progresi i punimeve për by-pass-in e Vlorës ka ecur me ritme të ulëta, madje për një periudhë disa mujore, punimet në kantier janë stopuar. Arsyeja e këtij pezullimi të punimeve ka ardhur si pasojë e kontraktorit, i cili ka qenë në proces gjyqësor me nën-kontraktorin e zgjedhur prej tij “Elite Mine” SHA. Për periudhën maj 2016-22.11.2018, puna në kantier ka qenë e pezulluar dhe kjo për pasojë të problematikës që kontraktori ka pas me nën-kontraktorin e punimeve, situatë e cila ka çuar në mbyllje të kantierit.

Nga sa më lartë konstatohet se, koha e humbur nga ritmi i ulët i punimeve dhe koha kur punimet e ndërtimit janë stopuar/pezulluar, e bëjnë të pamundur përfundimin e ndërtimit të by-pass-it brenda afatit të përcaktuar në kontratë (data 13.10.2017), fakt ky i pranuar edhe nga vetë ARRSH.

Këtë situatë e dëshmojnë edhe shifrat e realizimit, ku realizimi fizik është në masën 5.6%, realizimi financiar në masën 14% dhe realizimi kohor në masën 60%. Me ndërprerjen e punimeve nga OE “S..... Co..... S.p.A” nga ARRSH, janë kryer procedurat e tenderimit për vazhdimin e punimeve dhe shpallur fitues BOE “G.....” SHPK & “I.... di C..... Ing. E. M.....i”.

2. Kontrata e Re e datës 08.11.2018, me objekt “Për ndërtimin e by-pass-it të Vlorës”, është lidhur midis ARRSH-së dhe BOE “G.....” SHPK & “I.... C..... Ing. E. M.....” me vlerë fillestare 35,874,357 Euro pa TVSH dhe vlerë të amenduar 49,082,896.67Euro pa TVSH me një rritje në vlerën 13,208,539.67 Euro nga kontrata fillestare.

Data e fillimit të punimeve është caktuar më 22.11.2018, dhe afati i amenduar i përfundimit të punimeve është deri në muajin qershor të vitit 2022. Pra, konstatohet se nga viti 2016 - 22.11.2018, nuk janë kryer punime në by-pass-in e Vlorës si pasojë e pezullimit nga OE “S..... Co..... S.p.A”.

Nga auditimi konstatohet se, shuma e likuiduar për këtë kontratë sipas IPC nr. 1 - IPC nr. 13, është në vlerën 35,154,697.59 Euro ose në masën 71.6%% të vlerës së kontraktuar. Nga Qeveria Shqiptare për 13 situacionet e punimeve është likuiduar TVSH-ja në shumën totale 960,819,182 lekë ose 7,791,575.42 Euro.

Gjithashtu konstatohen vonesa në disbursimin e situacioneve të punimeve nga data e paraqitjes së certifikatave nga 1-6 muaj me vonesë pas paraqitjes dhe miratimit të certifikatave të kryerjes së punimeve/shërbimeve konkretisht në 5 raste konkretisht: IPC nr. 1, datë 25.02.2019, IPC nr. 3, datë 21.10.2019, IPC nr. 4, datë 11.12.2019, IPC nr. 8, datë 25.09.2020, dhe IPC nr. 12, datë 27.07.2021. Kjo situatë shkaktohet për arsye të bërjes aktiv të transhit nga MFE/Banka e Shqipërisë dhe kreditimit të transhit në bankën e nivelit të dytë Banka Credins (BEI në të cilën ka llogarinë e saj) si dhe për 6 situacione punimesh konkretisht: IPC nr. 1, IPC nr. 3, IPC nr. 7, IPC nr. 8, IPC nr. 9 dhe IPC nr. 12, janë konstatuar vonesa në likuidimin e TVSH-së, pra këto pagesa nuk janë kryer brenda afateve të parashikuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7. (sipas tabelës paraqitur në anekset e Projekt Raportit të Auditimit).

Në total disbursimet deri më datën 31.12.2021, për Projektin “Ndërtimi i by-pass-it të Vlorës”, në mënyrë analitike paraqitet si më poshtë:

Euro

Projekti “Ndërtimi i by-pass-it të Vlorës”									
Kontratat	Kontraktori	Vlera e kontratës pa TVSH	Disbursuar në total	Financimi nga donatorët sipas marrëveshjeve respektive					Realizimi
				BEI	BERZH	IPA	IPA për Supervizionim	Kontribut Lokal	
				18,000,000	18,000,000	17,000,000	3,158,500	700,000	
Disbursuar sipas donatorëve									
Punimet Civile e Vjetër	S.....	35,289,872.6	5,190,494.03	1,919,705.23	1,682,071.14	1,588,717.66	-	-	14.7%
Punimet Civile e Re	G.....	49,082,896.67	35,154,697.59	8,484,223.63	13,715,532.49	12,954,941.46	-	-	71.6%
Facilitetet	E..... O.....	74,000	74,000	74,000	-	-	-	-	100%
Asistencë Teknike e Vjetër	E...	375,202.33	375,202.33	375,202.33	-	-	-	-	100%
Asistencë Teknike e Re	E.....	473,000	319,705	319,705	-	-	-	-	67.5%
Supervizioni i Punimeve	E..... O.....	3,858,500	3,126,585	-	-	-	3,126,585	-	81%
Totali		89,153,471.6	44,240,683.95	11,172,836.19	15,397,603.63	14,543,659.12	3,126,585	0	
Totali sipas realizimit të financimit në %				62%	85.5%	85.5%	98.9%	0%	
Financimi sipas donatorëve				18,000,000	18,000,000	17,000,000	3,158,500	700,000	56,858,500
Disbursuar sipas donatorëve				11,172,836.19	15,397,603.63	14,543,659.12	3,126,585	0	44,240,683.94
Diferenca e mbetur për t'u disbursuar sipas donatorëve				6,827,163.81	2,602,396.37	2,456,340.88	31,915	700,000	11,918,516.06
Diferenca për t'u disbursuar në %				38%	15.5%	15.5%	1.1%	100%	
Mbi realizimin e financimit të Projektit									
Kontratat			Punimeve Civile + Facilitetet + Asistencë Teknike				Supervizioni i Punimeve		
Financimi nga donatorët në total			53,000,000				3,858,500		
Disbursuar në total			41,114,098.94				3,126,585		
Shuma e cila mbetet ende nga financimet e donatorëve për kontratat			11,885,901				731,915		
Mbetet për t'u disbursuar për realizimin e kontratave			14,081,494.08				731,915		
Fonde të cilat duhet ende për realizimin e kontratave			2,195,593.08				0		

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Duke u bazuar në të dhënat e sipërpërmendura konstatohet se, për realizimin e punimeve të ndërtimit të by-pass-it të Vlorës midis ARRSH-së dhe OE “S..... Co..... S.p.A” është lidhur kontrata më datë 19.03.2015, në vlerën 35,289,872 Euro pa TVSH, ku është disbursuar shuma totale 5,190,494.03 Euro ose realizuar në masën 14.7%. Pas pezullimit të punimeve nga OE “S..... Co..... S.p.A” është lidhur kontrata e Re e Punimeve Civile midis ARRSH-së dhe BOE “G.....” SHPK & “I..... C..... Ing. E. M.....” me vlerë fillestare kontrate 35,874,357 Euro pa TVSH dhe me vlerë të amenduar 49,082,896.67 Euro ku është disbursuar shuma totale 35,154,697.59 Euro ose realizuar në masën 71.6%.

Gjithashtu për Facilitetet është parashikuar vlera 74,000 Euro për të cilën është disbursuar OE “E..... O.....” në shumën 74,000 Euro ose realizuar në masën 100%. Për realizimin e Asistencës Teknike është lidhur kontrata më datë 25.02.2017, me “E.... S... I.....” në vlerën 375,202.33 Euro për të cilën është disbursuar shuma 375,202.33 Euro ose realizuar në masën 100%.

Për realizimin e Asistencës Teknike është lidhur kontrata e re me “E..... S..... I.....” më datë 21.02.2020, në vlerën 473,000 Euro për të cilën është disbursuar shuma 319,705 Euro ose realizuar në masën 67.5%. Për realizimin e supervizionit dhe mbikëqyrjen e punime është lidhur kontrata me Shoqërisë “E..... O.....” S.a me objekt “Supervizioni i punimeve për ndërtimin e by-pass-it të Vlorës”, me vlerë fillestare të kontratës 1,663,300 Euro pa TVSH dhe me vlerë të amenduar të kontratës 3,858,500 Euro pa TVSH, ku është disbursuar shuma 3,126,585 Euro ose realizuar në masën 81%.

Për realizimin e punimeve të ndërtimit, asistencës teknike dhe faciliteteve për by-pass-in e Vlorës vlera totale e financimit sipas marrëveshjeve të sipërpërmendura është 53,000,000 Euro konkretisht e ndarë sipas donatorëve BEI në vlerën 18,000,000 Euro + BERZH në vlerën 18,000,000 Euro + IPA në vlerën 17,000,000 Euro), nga të cilat deri më datën 31.12.2021, është disbursuar për këto kontrata shuma 41,114,098.94 Euro, gjithashtu mbeten ende fonde nga marrëveshjet për realizimin e këtyre kontratave shuma totale 11,885,901 Euro. Ndërkohë që për përfundimin e këtyre kontratave duhet financim në shumën totale prej 14,081,494.08 Euro, ndërsa fondet e mbetura nga marrëveshjet janë në shumën 11,885,901 Euro me një diferencë prej 2,195,593.08 Euro.

Nga sa trajtuar më sipër konstatohet se, deri më datë 31.12.2021, për realizimin dhe përfundimin e kontratën e re të ndërtimit të punimeve të lidhur me Kontraktorin BOE “G.....” SHPK & “I..... C..... Ing. E. M.....” dhe kontratën e re të asistencës teknike të lidhur me “E... S... I...”, nuk mjaftojnë fondet e parashikuara në marrëveshjet e financimit por do të duhen fonde shtesë në shumën 2,195,593.08 Euro gjë e cila do të mbulohet me financim nga Buxheti i Shtetit parashikuar kjo edhe në marrëveshjet e Projektit. Kjo situatë ka ardhur si pasojë e pezullimit të punimeve nga OE “S..... Co..... S.p.A”, dhe për përfundimin e punimeve është rilidhur kontrata e re me BOE “G.....” shpk & “I..... C..... Ing. E. M.....”.

Për realizimin e kontratës së supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve shuma totale e financimit sipas marrëveshjes së Grantit IPA respektive është 2,365,000 Euro por për këtë kontratë ka pasur shtesë financimi në shumën 793,500 Euro nga Komisioni Europian si dhe 700,000 Euro nga Qeveria Shqiptare ku financimi shkon në shumën totale 3,858,500 Euro ku deri më datën 31.12.2021, është disbursuar shuma totale 3,126,585 Euro ose 81%.

Për përfundimin dhe realizimin e kësaj kontrate deri më datën 31.12.2021, fondet janë të mjaftueshme por theksojmë se për këtë kontratë ka pasur kosto shtesë në shumën 1,493,500 Euro nga financimi fillestar i parashikuar në marrëveshje. Referuar situatës së krijuar konstatohet se, kontrata për punimet e ndërtimit realizuar në masën 71.6%, ndërsa kontrata e supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve është realizuar në masën 81%, pra këto 2 kontrata kanë ecur në përpjesëtim të zhdrejtë dhe deri në përfundimin e punimeve do të lind nevoja për shtesë kontratë supervizionin.

Gjithashtu u krye verifikimi i dorëzimit të pasqyrave financiare për vitet respektive të zbatimit të projektit nga ku rezultoi se ato janë paraqitur çdo vit brenda afateve të përcaktuara drejtuar Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Financave. Këto pasqyra janë të konfirmuara nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues.

Në lidhje me pagesën e TVSH rezultoi se, në total shuma e paguar për by-pass-in e Vlorës është 9,525,523.42 Euro ose 1,197,080,637.8 lekë. Vlera 1,108,631 Euro, përbëhet nga vlera 1,018,832 paguar për OE “S..... Co..... S.p.A” për kontratën e punimeve të ndërtimit, vlera 74,999 Euro paguar për OE “E... S... I...” për kontratën “Asistencë Teknike për projektet e by-pass-in e Fierit dhe Vlorës” dhe vlera 14,800 Euro për OE “E..... O..... A.E” për kontratën e “Pajisje për Supervizionin e Ndërtimit të Segmentit By Pass Vlorë”. Vlera 7,791,575.42 Euro është paguar për kontraktorin BOE “G.....” SHPK & “Impresa di Costruzioni Ing. E. Mantovani” për kontratën e punimeve të ndërtimit. Vlera 625,317 është paguar për kontraktorin “E..... O..... A.E” për kontratën e “Supervizionit të Ndërtimit të by-pass-in e Vlorës”.

Fondet e planifikuara nga Qeveria Shqiptare në lidhje me pagesën e TVSH-së, shpronësimeve etj., për këtë projekt janë 8,600,000 Euro (kontribut i cili i referohet marrëveshjes së lidhur midis Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI))për periudhën nga fillimi i projektit deri në kryerjen e pagesës së fundit 31.12.2021, është likuiduar likuidimi i TVSH-së në shumën totale 4,634,870.94 Euro (2,182,969.94 Euro TVSH +2,451,901 Euro për shpronësime) në masën 53.8%.

Në tabelën e më poshtme jepen pagesat e TVSH-së sipas kontratave.

Nr.	Emërtimi	TVSH/Euro	TVSH/kontraktori	TVSH/lekë
1	Punime ndërtimi S.....	1,018,832	143,238,912	143,238,912
2	Asistenca teknike Fier & Vlorë	74,999	9,780,752	9,780,752
3	Kontrata facilitete superviz Vlorë	14,800	1,957,175	1,957,175
4	Punime ndërtimi (kontrata re) G.....	7,791,575.42	960,819,182	960,819,182
5	Mbikëqyrja	625,317	81,284,616.8	81,284,616.8
Totali		9,525,523.42	1,197,080,637.8	1,197,080,637.8

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nga auditimi u konstatua se janë hasur problematika gjatë procesit të shpronësimeve, të cilat kanë sjellë vonesa në zbatimin e punimeve.

Vonesat e shkaktuara nga procesi i shpronësimeve ngarkojnë me përgjegjësi ARRSH në rolin e agjencisë së zbatimit të projektit, e cila sipas marrëveshjeve të huas duhet të sigurojë të gjitha të drejtat mbi tokën e truallin ku do të kalojë projekti, të drejta të cilat duhen të sigurohen para fillimit të punimeve.

Për periudhën objekt auditimi shpronësimet për by-pass-in e Vlorës janë si më poshtë:

Lekë

VKM mbi shpronësimet	Aktivitetet	Vlera
VKM nr. 655, datë 08.10.2014, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "by-pass Vlorë".	Vlera Totale e Shpronësimit	51,483,381
	Paguar	29,630,894
	Diferenca për t'u paguar	21,852,487
VKM nr. 1003, datë 09.12.2015, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "by-pass Vlorë(shtesa)".	Vlera Totale e Shpronësimit	9,832,636
	Paguar	9,832,636
	Diferenca për t'u paguar	0
VKM nr. 699, datë 05.10.2016, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "by-pass Vlorë(shtesa)".	Vlera Totale e Shpronësimit	234,237,718
	Paguar	231,595,510
	Diferenca për t'u paguar	2,642,208
VKM nr. 682, datë 28.09.2016, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "by-passvlorë (objekte)".	Vlera Totale e Shpronësimit	28,693,975
	Paguar	28,693,975
	Diferenca për t'u paguar	0
VKM nr. 38, datë 22.01.2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 699, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor by-pass Vlorë (shtesa)".	Vlera Totale e Shpronësimit	245,827,297
	Paguar	2,806,413
	Diferenca për t'u paguar	243,020,884
VKM nr. 676, datë 10.11.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 699, datë 05.10.2016, të Këshillit të Ministrave, për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor by-pass Vlorë (shtesa)", të ndryshuar.	Vlera Totale e Shpronësimit	8,544,392
	Paguar	1,476,340
	Diferenca për t'u paguar	7,068,052
Totali i vlerës për shpronësim sipas VKM-ve		578,619,399
Totali i shpronësimeve i likuiduar		304,035,768
Totali i diferencës për të likuiduar		274,583,631

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Duke u bazuar në përcaktimet e VKM të sipërpërmendura vlera totale e shpronësime për by-pass-in e Vlorës është 578,619,399 lekë nga të cilat është likuiduar shuma 304,035,768 lekë ose afërsisht 2,451,901 Euro, si dhe mbetet për t'u likuiduar detyrimi për shpronësime në shumën totale 274,583,631 lekë.

Në total kosto e realizuar për Projektin "By-pass-i i Vlorës" është si në tabelën e mëposhtme:

Euro

Pagesat e BEI	Pagesat e BERZH	IPA 2011 për Punimet Civile	IPA supervizion	Pagesat e TVSH	Pagesat e shpronësimeve	Totali
11,172,836.19	15,397,603.63	14,543,659.12	3,126,585	9,525,523.42	2,451,901	56,218,108.36

Burimi: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Kosto e Projektit sipas parashikimeve në marrëveshjet e financimit:

Euro

Objekti	Pagesat e BEI	Pagesat e BERZH	IPA 2011 për Punimet Civile	IPA supervizion	Kontribut Lokal TVSH parashikuar në marrëveshjen me BEI	Totali Realizimi në %
Financimi	18,000,000	18,000,000	17,000,000	2,365,000	8,600,000	63,965,000
Likuiduar	11,172,836.19	15,397,603.63	14,543,659.12	3,126,585	4,634,870.94 (2,182,969.94 + 2,451,901)	48,875,554.88
Realizimi në %	62%	85.5%	85.5%	132.2%	53.8%	76.4%

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Kosto e përlogaritur e Projektit “Ndërtimi i by-pass-it të Vlorës” është 63,965,000 Euro dhe për periudhën nga fillimi i projektit deri më datën 31.12.2021, është realizuar 48,875,554.48 Euro ose në masën 76.4%.

b) Për Projektin “Ndërtimi i by-pass-it të Fierit” financimi është si më poshtë:

1. Me Ligjin nr. 80/2012, datë 01.10.2012, “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për projektin endërtimit të by-pass-it të Fierit”, është ratifikuar në Parlament marrëveshja financiare për projektin “Ndërtimi by-pass të Fierit”.

Huamarrësi (Qeveria Shqiptare e përfaqësuar nga Ministria e Financave), ka ndërmarrë nëpërmjet ARRSH si agjenci zbatimi, realizimin e projektit për ndërtimin e 22 km të rrugës anësore të autostradës me dy kalime përreth qytetit Fier. Kostoja totale e projektit sipas vlerësimit të Bankës është 81,200,000 Euro dhe Huamarrësi ka deklaruar se synon të financojë projektin si më poshtë:

Euro

Nr.	Burimi i financimit	Shuma e financimit
1	Hua nga BERZH	35,000,000
2	Kredi nga banka BEI	35,000,000
3	Grand nga Cooperacioni Italian	1,800,000
4	Kontributi i Qeverisë Shqiptare	9,400,000
	Totali	81,200,000

Burimi i të dhënave: Marrëveshja e Huas.

Për të përmbushur planin financiar Huamarrësi ka kërkuar nga Banka BEI akordimin e një kredie në shumën 35,000,000 Euro, me kushtin kryesor që kreditimi nga Banka do të përdoret vetëm për financimin e komponentëve të projektit të lidhur me punimet civile të përshkruara në përshkrimin teknik. Gjithashtu, për realizimin e projektit “By-pass-it të Fierit”, ka bashkë financuar edhe banka BERZH, nëpërmjet një huaje në shumën 35,000,000 milionë lekë.

Huaja e BERZH është miratuar nga palët nëpërmjet ratifikimit të Ligjin nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, në shumën 53,000,000 Euro.

Referuar nenit 2, pika 3, gërma “F”, parashikohet se: Data e fundit e disponueshmërisë për huan e transhit A është 30 Prill 2015 dhe për huan e transhit B është data e përvjetorit të tretë të datës së fillimit të transhit B, ose një datë e mëvonshme që Banka sipas diskrecionit të saj, mund të vendosë dhe njofton Huamarrësin. Me Amendamenti nr.1, datë 14.02.2019, e cila është përcjell me shkresë nr. 149/5prot., datë 11.07.2019, miratohet afati i fundit për kryerjen e disbursimeve për transhin A të marrëveshjes së huasë datën 31 Janar 2021. Nga auditimi konstatohet se ka një periudhë prej 21 muajsh pa marr miratimin e shtyrjes së disbursimeve, ARRSH ka një korrespondencë të vazhdueshme me Ministrinë ku kërkon kryerjen e procedurave për zgjatjen e afatit të disbursimeve por referuar amendamentit Ministria e ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të disbursimeve në 26.12.2018 (19 muaj më vonë nga kërkesa e parë e ARRSH) veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin e Marrëveshjes. Sqarojmë se gjatë kësaj periudhe nuk ka patur asnjë kërkesë për disbursime dhe nuk është kryer asnjë disbursim nga ARRSH pasi kompania e ndërtimit ka ndërprerë punimet OE “S..... Co..... S.p.A” dhe ARRSH ishte duke zhvilluar procedurën e ritenderimit.

Banka BEI, duke marrë parasysh se financimi i projektit përfshihet në objektin e funksioneve të saj, ka vendosur të realizojë kërkesën e Huamarrësit duke i dhënë një kredi në shumën prej 35,000,000 Euro, sipas kontratës së financimit, me kusht që shuma e huas së Bankës në asnjë rast nuk do të kalojë 50% të kostos totale të projektit për ndërtimin e by-pass-it të Fierit.

Në marrëveshjen financiare, palët kanë rënë dakord që, Huamarrësi pranon kredinë në shumën 35,000,000 Euro për financimin e projektit të by-pass-it të Fierit. Banka do të disbursojë kredinë deri në 10 transhe. Vlera e secilit transh, nëse nuk është balanca e pa tërhequr e kredisë, do të jetë një vlerë minimale prej 3,000,000 Euro.

Për kërkesat për disbursim, Huamarrësi mund t'i paraqesë Bankës një kërkesë për disbursimin e një transhi që do të merret jo më vonë ose së paku 15 ditë para datës përfundimtare të vlefshmërisë. Kërkesa për disbursim do të ketë formën e përcaktuar në skedulën C dhe do të specifikojë:

Çdo kërkesë për disbursim do të shoqërohet me prova të autorizimit të personit apo personave të autorizuar për ta nënshkruar atë dhe modeli i nënshkrimit të këtij personi apo personave; për të shmangur dyshimet, për kërkesat për disbursim në vijim të të parës, të nënshkruar nga i njëjti nënshkruar apo disa nënshkruar si e para, kjo provë mund të përbëjë të njëjtën provë dokumentuese të autoritetit, të plotësuar për kërkesën për disbursimin e parë, me kusht që të mos u nënshtrohet kufizimeve në kohë apo kufizimeve të tjera. Çdo kërkesë për disbursim është e parevokueshme. Njoftimi i disbursimit do t'i dorëzojë Huamarrësit një njoftim disbursimi jo më pak sesa 10 ditë para datës së propozuar të planifikuar të një transhi, ku do të specifikojë, shumën e transhit; datën e planifikuar të disbursimit; normën bazë të interesit për transhin, (transh me normë fikse; ose transh me normë të ndryshueshme); datën e pagimit të interesit të parë dhe periodicitetin e pagimit të interesit për transhin; kushtet për shlyerjen e principalit për transhin; datat e para dhe të fundit për shlyerjen e principalit për transhin; datën e pagimit të aplikueshëm për transhin.

Paraqitja e kërkesës për disbursim për transhin e parë, do të konsiderohet efektive pas marrjes nga Banka në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, të dokumenteve apo dëshmime, të përcaktuara sipas nenit 1, pika 1.04 A.

Nga auditimi u konstatua se, janë bërë kërkesat për disbursim të 7 transheve konkretisht në datën 10.03.2014 në shumën 5,000,000 Euro, në datën 04.12.2014, në shumën 5,000,000 Euro, në datën 03.11.2015, në shumën 5,000,000 Euro, në datën 20.03.2020, në shumën 10,000,000 Euro dhe në datën 22.07.2020, në shumën 5,000,000 Euro, në datën 11.12.2020, në shumën 3,000,000 Euro dhe në datën 31.08.2021, në shumën 2,000,000 Euro.

Në nenin 4 “Marrëveshjet financiare”, përcaktohet se agjencia përgjegjëse për kryerjen e projektit, shfrytëzon procedura, të dhëna dhe llogari të mjaftueshme për të reflektuar në përputhje me standardet e kontabilitetit të pranuar ndërkombëtarisht, operacionet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me projektin dhe për të monitoruar dhe regjistruar progresin e projektit (duke përfshirë kostot e tij dhe përfitimet që rrjedhin nga projekti). Huamarrësi, ia nënshton të dhënat dhe llogaritë e përmendura në seksionin 4.01(a) për çdo vit fiskal, auditimit nga auditë të pavarur të pranueshëm për Bankën, në përputhje me parimet dhe standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht; jep Bankës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti fiskal, raportin e këtij auditit nga këta auditë dhe fushën e veprimit dhe në hollësi që Banka mund të kërkojë dhe i jep Bankës çdo informacion tjetër në lidhje me këto të dhëna dhe llogari, dhe auditin e tyre, që Banka mund të kërkojë herë pas here.

Po kështu në nenin 8.02 të kontratës financiare me bankën BEI, është përcaktuar se Huamarrësi do të garantojë që zbatuesi do të dorëzojë bankës sapo të jetë e disponueshme, por në çdo rast 180 ditë pas përfundimit të secilit prej viteve të tij financiar raportin vjetor të konsoliduar dhe pakonsoliduar të audituar të zbatuesit nga auditë të pavarur.

3. Titulli i Gjetjes: Mos kryerja e auditimit nga auditues të pavarur.

Situata: Referuar kushteve të marrëveshjeve të financimit të Projektit parashikohet se, Huamarrësi do të garantojë që zbatuesi do t'i dorëzojë bankës pas përfundimit të secilit prej viteve të tij financiar raportin vjetor të konsoliduar dhe pakonsoliduar të audituar të zbatuesit nga auditë të pavarur.

Kriteri: Ligjin nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, neni 4, seksioni 4.01, dhe Ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, nenin 8, seksioni 8.02.

Ndikimi/Efekti: Mosnjohje e situatës financiare.

Shkaku: Mos implementimi i dispozitave ligjore të parashikuara në marrëveshjen e financimit të Projektit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: ARRSH në rolin e Njesisë së Zbatimit të Projektit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për kryerjen e auditimit të veprimtarisë së Projektit nga auditues të pavarur, me qëllim respektimin e kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen financiare dhe njohjen me problematikat/rekomandimet e audituesve për përmirësimin e punës.

2. Me Ligjin nr. 8/2012, datë 9.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, është ratifikuar në Parlament marrëveshja financiare për projektin “Ndërtimi by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”.

Shuma e destinuar për ndërtimin e by-pass-it të Fierit nga huaja e BERZH është në shumën 35,000,000 Euro dhe do të lëvrohet në formën e transhit A. Kjo shumë është përcaktuar se do të përdoret vetëm për punimet e ndërtimit të by-pass-it të Fierit. Datë përfundimtare e vlefshmërisë” është 15 qershor 2017.

-Amendamenti nr. 1. Është paraqitur me VKM nr. 94, datë 05.02.2020, në të cilën miratohet afati i fundit për kryerjen e disbursimeve për Transhin A të marrëveshjes së huasë datën 31.01.2021, zgjatja e periudhës së disbursimit të projektit 30 muaj pas përfundimit të kësaj periudhe të përcaktuar në Ligjin e marrëveshjes në kundërshtim me Ligjin e Marrëveshjes.

Me shkresën nr. 7720 prot, datë 14.10.2020 “Ndërtimi i segmentit rrugor “By Pass i Fierit”, kërkesë për shtyrjen e afatit të marrëveshjes së kredisë së BEI - it”.

-Amendimi nr. 2, datë 31.07.2021 i miratuar me Vendimin e KM nr. 654, datë 03.11.2021 “Për miratimin e Marrëveshjes ndryshuese nr. 2 ...” me anën e të cilit është zgjatur afati i disbursimit deri në 31.12.2021, shtyrja e afatit të disbursimit është kryer 6 muaj pas përfundimit të afatit.

Në zbatim të neni 6, “Hyrja në fuqi”, janë të përcaktuara edhe kushtet të cilat duhet të përmbushen për disbursimin e transhit A, konkretisht në seksionin 6.01. “Kushtet për disponueshmërinë e transhit A”. Sa më poshtë, përcaktohen për qëllimet e seksionit 9.02 “c” të termave dhe kushteve standarde si kushte shtesë për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje:

a) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, të miratimit nga parlamenti të kësaj Marrëveshjeje.

b) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, të zbatimit të duhur të planit mjedisor dhe social të veprimit për komponentin 1;

a. Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se të gjitha të drejtat e truallit, të nevojshme për zbatimin e komponentit 1, janë marrë nga

Huamarrësi dhe janë vënë në dispozicion të kontraktorit të punimeve civile (ose se Huamarrësi ka të drejtë të fitojë këto të drejta trualli në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm shqiptar dhe se shumat e mjaftueshme janë rezervuar nga Huamarrësi për fitimin e këtyre të drejtave të truallit në kohën e duhur) dhe konfirmim se plani i veprimit të rivendosjes për komponentin 1 është duke u zbatuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara të performancës.

b. Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se një EZP është funksional, me burimet e mjaftueshme dhe personel të kualifikuar siç duhet, në bazë të termave të referencës të pranueshme për Bankën.

c. Dhe Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se marrëveshjet e grantit të Kooperacionit Italian për pjesën C të komponentit 1 janë ekzekutuar dhe dorëzuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë, dhe se e drejta e Huamarrësit për të tërhequr sipas kësaj marrëveshjeje, është bërë e vlefshme.

Seksioni 6.02. Opinioni ligjor

Për qëllimet e seksionit 9.03 “a” të termave dhe kushteve standarde, opinioni ose opinionet e përfaqësuesit ligjor do të jepen në emër të Huamarrësit nga Ministri i Drejtësisë dhe do të jenë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

Seksioni 6.03. Përfundimi për moshyrjen në fuqi

Data që bie 120 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje është përcaktuar për qëllimet e seksionit 9.04 të termave dhe kushteve standarde.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se, nga ARRSH nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion ku të vërtetohet se angazhimet e parashikuara në nenin 6, seksioni 6.01, të jenë realizuar në zbatim të përmbushjes së kushteve për disponueshmërinë e transhit A.

Disbursimet nga huaja kalojnë nga donatori tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, ku nga MFE për këtë hua është hapur llogaria speciale në bankën e nivelit të dytë me numër nr. 534342, më datë 21.02.2014, konkretisht në Credins Bankë ku nga kjo llogari më pas kalojnë pagesat tek kontraktorët sipas situacione përkatëse. Për sa i përket TVSH-së likuidimi kryhet nga Qeveria Shqiptare.

3. Me Ligjin nr. 9342, datë 10.02.2005, “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet KM dhe Mediocreditocentrale (MCC spa), për financimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnje-Fier dhe mbikëqyrjen e punimeve për dy segmente rrugore, Lushnje-Fier dhe Fier-Vlorë”, është ratifikuar marrëveshja financiare midis bankës MCC spa dhe Ministrisë së Financave. Shuma në total e kredisë financiare të dhënë nga Qeveria Italiane është në vlerën 24,350,000 Euro dhe ka si qëllim realizimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnje-Fier dhe supervizionin për dy segmentet e vazhdueshme Lushnje-Fier dhe Fier- Vlorë.

Nga auditimi u konstatua se shumat e akorduar për konsulencën, supervizioni dhe mbikëqyrja për Bypass e Fierit është në shumën 1 (një) milionë Euro dhe jo në shumën 1,800,000 Euro, gjithashtu kjo shumë nuk është në formë grandit si është përcaktuar në marrëveshjen e BEI, por është pjesë e kredisë financiare të dhënë nga Qeveria Italiane nëpërmjet bankës Mediocreditocentrale (MCC spa). Ky financim kalon nga Donatori direkt në llogari të supervizorit sipas situacioneve përkatëse, ndërsa TVSH-ja likuidohet nga Qeveria Shqiptare. Ky financim do të shërbej për supervizionin e dhe mbikëqyrjen e punimeve të by-pass-it të Fierit ku shumat e aplikuar është 858,210 ka ky financimin ndërsa ka edhe mbështetje nga Buxheti i Shtetit deri më datën 31.12.2021, në shumën 1,621,959.4 Euro për realizimin e kontratës së supervizionit më datë 21.07.2010, me BOE “S..... srl & SWS C..... E.... srl & T..... spa”, me vlerë 715,800 Euro pa TVSH dhe me vlerë të amenduar kontrate 2,894,827 Euro pa TVSH.

4. Financimi i buxhetit të shtetit.

Fondet e veta në shumën e përlogaritur 9,400,000 Euro, janë bashkëfinancim i Qeverisë Shqiptare dhe janë përcaktuar për mbulimin e shpenzimeve të TVSH, taksës doganore, shpronësimeve etj.

Në total kosto e përlogaritur e projektit për ndërtimin e by-pass Fier, e ndarë sipas secilit financues është si në tabelën e mëposhtme:

Euro

Nr.	Burimi i financimit	Shuma e financimit
1	Hua nga BERZH	35,000,000
2	Hua nga BEI	35,000,000
3	Kredi financiare nga Cooperazione Italiane	1,000,000
4	Kontributi i Qeverisë Shqiptare	9,400,000
Totali		80,400,000

Burimi i të dhënave: Marrëveshja e Huas.

Për realizimin e projektit By-pass Fier është përcaktuar që të jetë i ndarë në dy komponentë:

- A “Për supervizioni dhe mbikëqyrjen e punimeve”.
- B “Për punimet e ndërtimit”.

Kontrata “Për supervizionin dhe mbikëqyrjen e punimeve”.

1.Për realizimin e këtij komponenti më datë 21.07.2010, është firmosur kontrata ndërmjet ARRSH dhe BOE “S..... srl & SWS Consultin Engineering srl & Tecnic spa”, me vlerë 715,800 Euro pa TVSH dhe me vlerë të amenduar kontrate 2,894,827 Euro pa TVSH. Shoqëria “S..... SRL”, është regjistruar në Republikën e Shqipërisë me NIPT L61627456M. Ky komponent financohet nga Cooperazione Italiane. Afati i kontratës së konsulencës dhe mbikëqyrjes është përcaktuar 27 muaj nga fillimi i punimeve të ndërtimit. Për arsye se, punimet e ndërtimit nuk kanë përfunduar në afat dhe se kontrata e konsulentit ecën paralelisht me atë të punimeve, konstatojmë se kjo kontratë është në proces. Shtyrja e afatit të kontratës së konsulentit është shoqëruar me shtesë së vlerës së saj (me 7 shtesa kontrate) duke bërë që vlera e rishikuar të jetë 2,881,011 Euro pa TVSH ose 2,165,211 Euro më shumë se vlera fillestare.

Shtesa e kontratës së konsulencës dhe mbikëqyrjes ka sjell një kosto shtesë për buxhetin e projektit në shumën 2,022,801 Euro. Shuma 858,210 Euro është mbuluar me financim nga Coperazione italiane dhe shuma 2,022,801 Euro nga Qeveria Shqiptare.

Euro

Financuesi	Objekti	Vlera	Data
Cooperacioni Italian	Vlera Originale e Kontrates	715,800	2013-2015
	Shtesa (Perizia 1)	142,410	
Totali i Cooperacionit Italian		858,210	
Qeveria Shqiptare	Addendum.1	527,707	31.08.2015-31.12.2016
	Addendum.2	206,000	09.05.2017-30.07.2018
	Addendum.3	591,810	30.07.2018-31.12.2019
	Addendum.4	424,460	01.01.2020-31.12.2020
	Addendum.5	236,150	01.01.2021-31.07.2021
	Addendum.6	125,700	01.08.2021-31.12.2021
	Addendum.7	67,200	01.01.2022-30.04.2022
Totali i rishikuar i Projektit		2,881,011	

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nga auditimi konstatohet se, për 35 situacione punimesh është likuiduar shuma 2,480,279 Euro (858,210 Euro Qeveria Italiane + 1,621,959.4 Euro nga Qeveria Shqiptare) në masën 85.6% dhe likuiduar TVSH nga Qeveria Shqiptare në shumën 364,084.1 Euro ose në shumën 43,620,741 lekë. Gjithashtu për 12 situacione punimesh konkretisht: IPC nr. 14, IPC nr. 17, IPC nr. 19, IPC nr. 21, IPC nr. 22, IPC nr. 25, IPC nr. 26, IPC nr. 31, IPC nr. 32, IPC nr. 33, IPC nr. 34, dhe IPC nr. 35, janë konstatuar vonesa në likuidimin e TVSH-së, pra këto pagesa nuk janë kryer brenda afateve të parashikuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7.

Kontrata “Për punimet e ndërtimit”.

1.Për realizimin e punimeve civile për ndërtimin e “By-pass-it të Fierit” midis ARRSH-së dhe OE “S..... Co..... S.p.A” është lidhur kontrata e datës 18.03.2013, me vlerë fillestare të kontratës 41,253,460 Euro pa TVSH dhe me vlerë të amenduar në shumën 47,174,723 Euro pa TVSH. Punimet kanë qenë parashikuar të fillonin më datë 27.05.2013, dhe të përfundonin më datë 04.04.2016. Për këtë kontratë janë disbursuar 15 situacione punimesh në shumën totale 21,192,112 Euro ose në masën 44.9%.

2.Me ndërprerjen e punimeve më datë 15.05.2017, nga OE “S..... Co..... SpA” , nga ARRSH, janë kryer procedurat e tenderimit për vazhdimin e punimeve dhe shpallur fitues OE “C....G....C....ing Company”, me të cilën është nënshkruar kontrata më 05.11.2018, me vlerë fillestare 37,944,221.56 Euro pa TVSH, dhe vlerë të amenduar 48,971,853.7 Euro pa TVSH Euro me një rritje të kontratës nga vlera fillestare në vlerën 11,027,632.14 Euro pa TVSH.

Nga auditimi konstatohet se, shumata e likuiduar për këtë kontratë sipas IPC nr. 1 - IPC nr. 27, është në vlerën 47,310,228.63 Euro ose në masën 96.6% të vlerës së kontraktuar. Nga Qeveria Shqiptare për 27 situacionet e punimeve është likuiduar TVSH-ja në shumën totale 1,173,231,333 lekë ose 9,500,792.11 Euro. Gjithashtu konstatohen vonesa në disbursimin e situacioneve të punimeve nga data e paraqitjes së certifikatave nga 1-6 muaj me vonesë pas paraqitjes dhe miratimit të certifikatave të kryerjes së punimeve/shërbimeve konkretisht në 9 raste konkretisht: IPC nr. 1, datë 18.12.2018, IPC nr. 7, datë 31.07.2019, IPC nr. 8, datë 31.08.2019, IPC nr. 9, datë 30.09.2019, IPC nr. 10, datë 31.10.2019, IPC nr. 11, datë 30.11.2019, IPC nr. 12, datë 31.12.2019, IPC nr. 22, datë 31.12.2020, IPC nr. 24, datë 31.05.2021, dhe IPC nr. 26, datë 13.07.2021. Kjo situatë shkaktohet për arsye të bërjes aktiv të transhit nga MFE/Banka e Shqipërisë dhe kreditimit të transhit në bankën e nivelit të dytë Banka Credins (BEI në të cilën ka llogarinë e saj) si dhe për 16 situacione punimesh konkretisht: IPC nr. 1, IPC nr. 2, IPC nr. 4, IPC nr. 5, IPC nr. 6, IPC nr. 7, IPC nr. 8, IPC nr. 9, IPC nr. 10, IPC nr. 11, IPC nr. 13, IPC nr. 14, IPC nr. 16, IPC nr. 19, IPC nr. 21, dhe IPC nr. 24, janë konstatuar vonesa në likuidimin e TVSH-së, pra këto pagesa nuk janë kryer brenda afateve të parashikuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7.

Në total disbursimet për projektin e ndërtimit të By-pass Fier, sipas komponentëve, vlerës së financimit të donatorëve dhe vlerave të kontratave të lidhura, paraqiten si në tabelën e më poshtme:

Euro

Projekti “Ndërtimi i by-pass-it të Fier”								
Kontratat	Kontraktori	Vlera e kontratës pa TVSH	Disbursuar në total	Financimi nga donatorët sipas marrëveshjeve respektive				
				BEI	BERZH	Cooperacioni Italian	Kontribut Lokal nga Qeveria Shqiptare	Realizimi në % sipas kontratave
				35,000,000	35,000,000	858,210	1,621,959.4	
Disbursuar sipas donatorëve								
Punimet Civile	S.....	47,174,723	21,192,111.97	10,596,055	10,583,274	-	-	44.9%
Punimet Civile e Re	C....G....C....	48,971,853.97	47,310,228.63	23,655,114	23,655,114	-	-	96.6%
Supervizioni i Punimeve	S.....srl & SWS C..... E.....srl&T.....	2,894,827	2,480,169.4	-	-	858,210	1,621,959.4	85.6%
Facilitete të Supervizorit	S.....srl & SWS C..... E.....srl&T.....	72,880	72,880	72,880	-	-	-	100%
Totali		99,114,283.97	70,982,510	34,324,049	34,238,388	858,210	1,621,959	
Totali sipas realizimit të financimit në %				98%	97.8%	100%	100%	
Financimi sipas donatorëve				35,000,000	35,000,000	858,210	1,621,959	72,480,169
Disbursuar sipas donatorëve				34,324,049	34,238,388	858,210	1,621,959	70,982,510
Diferenca e mbetur për t’u disbursuar sipas donatorëve				675,951	761,612	0	0	1,497,659

Diferenca për t'u disbursuar në %	1.9%	2.1%	0%	0%	2%
Mbi realizimin e financimit të Projektit					
Kontratrat	Punimet Civile + Facilitete			Supervizioni i Punimeve	
Financimi nga donatorët në total	70,000,000			2,480,169.4	
Disbursuar në total	68,562,437			2,894,827	
Shuma e cila mbetet ende nga financimet e donatorëve për kontratat	1,437,563			0	
Mbetet për t'u disbursuar për realizimin e kontratave	1,661,625.34			414,657.6	
Fonde të cilat duhet ende për realizimin e kontratave	224,062.34			414,657.6	

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Duke u bazuar në të dhënat e sipërpërmendura konstatohet se, për realizimin e punimeve të ndërtimit të by-pass-it të Fierit midis ARRSH-së dhe OE “S..... Co..... S.p.A” është lidhur kontrata më datë 18.03.2013, në vlerën 41,253,460 Euro pa TVSH dhe me vlerë të amenduar në shumën 47,174,723 Euro pa TVSH, ku është disbursuar shuma totale 21,192,112 Euro ose në masën 44.9%. Pas pezullimit të punimeve nga OE “S..... Co..... S.p.A” është lidhur kontrata e Re e Punimeve Civile më datë 05.11.2018, midis ARRSH-së dhe OE “C....G....C....ing Company” me vlerë fillestare 37,944,221.56 Euro pa TVSH, dhe vlerë të amenduar 48,971,853.7 Euro ku është disbursuar shuma totale 47,310,228.63 Euro ose në masën 96.6%. Gjithashtu për Facilitetet është parashikuar vlera 72,880 Euro për të cilën është disbursuar OE “S..... srl & SWS Consulting Engineering srl & Tecnic” në shumën 72,880 Euro ose realizuar në masën 100%. Për realizimin e punimeve të ndërtimit, dhe faciliteteve për by-pass-in e Fierit vlera totale e financimit sipas marrëveshjeve të sipërpërmendura është 70,000,000 Euro konkretisht e ndarë sipas donatorëve BEI në vlerën 35,000,000 Euro + BERZH në vlerën 35,000,000 Euro, nga të cilat deri më datën 31.12.2021, është disbursuar për këto kontrata shuma 68,562,437 Euro, gjithashtu mbeten ende fonde nga marrëveshjet për realizimin e këtyre kontratave shuma totale 1,437,563 Euro. Ndërkohë që për përfundimin e këtyre kontratave duhet financim në shumën totale prej 1,661,625.34 Euro, ndërsa fondet e mbetura nga marrëveshjet janë në shumën 1,437,563 Euro me një diferencë prej 224,062.34 Euro.

Nga sa trajtuar më sipër konstatohet se, deri më datë 31.12.2021, për realizimin dhe përfundimin e kontratën e re të ndërtimit të punimeve të lidhur me OE “C....G....C....ing Company” dhe kontratën e re të asistencës teknike të lidhur me “E..... S... I...”, nuk mjaftojnë fondet e parashikuara në marrëveshjet e financimit por do të duhen fonde shtesë në shumën 224,062.34 Euro gjë e cila do të mbulohet me financim nga Buxheti i Shtetit parashikuar kjo edhe në marrëveshjet e Projektit. Kjo situatë ka ardhur si pasojë e pezullimit të punimeve nga OE “S..... Co..... S.p.A”, dhe për përfundimin e punimeve është rilidhur kontrata e re me OE “C....G....C....ing Company”. Për realizimin e kontratës së supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve shuma totale e financimit sipas marrëveshjes së Cooperacioni Italian respektive është 858,210 Euro por për këtë kontratë ka pasur shtesë financimi në shumën 1,621,959.4 Euro nga Qeveria Shqiptare ku financimi shkon në shumën totale 2,894,827 Euro ku deri më datën 31.12.2021, është disbursuar shuma totale 2,480,169.4 Euro ose 85.6%.

Për realizimin e supervizionit të dhe mbikëqyrjes së punimeve është lidhur kontrata me amendime në shumën 2,894,827 Euro pa TVSH nga të cilat janë disbursuar nga Cooperacioni Italian respektive është 858,210 Euro + financimi në shumën 1,621,959.4 Euro nga Qeveria Shqiptare ku për të përfunduar realizimi i kontratës duhen ende fonde shtesë në shumën 414,657.6 Euro.

Në marrëveshjen BEI është përcaktuar se kontributi i palës shqiptare për projektin e By-pass Fierit do të jetë në shumën 9,400,000 Euro dhe do të mbulojë TVSH, kosto lokale, shpronësime etj. Nga auditimi u konstatua se për këtë projekt shuma e TVSH të paguar është 1,867,615,835 lekë.

Në tabelën e më poshtë jepen pagesat e TVSH sipas kontratave.

Nr.	Emërtimi	TVSH/Euro	TVSH/kontraktori	TVSH/lekë	Totali kosto lokale
1	Punime ndërtimi (S.....)	4,624,680	646,513,331	646,513,331	
3	Pajisje per supervizioni	14,576	1,924,547	1,924,547	
4	Punime ndërtimi (kontrata re)	9,500,792.11	1,173,231,333	1,173,231,333	
5	Mbikëqyrja	364,048	45,946,624	45,946,624	214,232,661
Totali		14,504,096.11	1,867,615,835	1,867,615,835	214,232,661

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nga auditimi u konstatua se janë hasur problematika gjatë procesit të shpronësimeve, të cilat kanë sjellë vonesa në zbatimin e punimeve, si dhe nga ana e kontraktorit të punimeve janë ngritur disa pretendime për shtyrje të afatit, pasi vonesat janë si pasojë e veprimtarisë së kontraktuesit (ARRSH).

Vonesat e shkaktuara nga procesi i shpronësimeve ngarkojnë me përgjegjësi ARRSH si agjenci e zbatimit të projektit, e cila sipas marrëveshjeve të huasë duhet të sigurojë të gjitha të drejtat mbi tokën e truallin ku do kaloj projekti, të drejta të cilat duhen të sigurohen para fillimit të punimeve. Për periudhën objekt auditimi shpronësimet për By-pas-in e Fierit janë si më poshtë:

Lekë

VKM mbi shpronësimet	Aktivitetet	Vlera
VKM nr. 1056, datë 14.12.2013, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor by-pass Fier".	Vlera Totale e Shpronësimit	343,583,717
	Paguar	235,986,807
	Diferenca për t'u paguar	107,596,910
VKM nr. 587, datë 10.09.2014, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor by-pass Fier - Levan".	Vlera Totale e Shpronësimit	90,346,779
	Paguar	46,475,177
	Diferenca për t'u paguar	43,871,602
VKM nr. 326, datë 27.04.2016, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor by-pass Fier(objekte)".	Vlera Totale e Shpronësimit	22,953,116
	Paguar	22,953,116
	Diferenca për t'u paguar	0
VKM nr. 196, datë 04.03.2020, "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor by-pass Fier".	Vlera Totale e Shpronësimit	15,132,500
	Paguar	10,217,873
	Diferenca për t'u paguar	4,914,627
VKM nr. 724, datë 16.09.2020, Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor by-pass Fier", të ndryshuar.	Vlera Totale e Shpronësimit	374,296,493
	Paguar	15,724,904
	Diferenca për t'u paguar	358,571,588
Totali i vlerës për shpronësim sipas VKM-ve		846,312,605
Totali i shpronësimeve i likuiduar		331,357,877
Totali i diferencës për të likuiduar		514,954,727

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Duke u bazuar në përcaktimet e VKM të sipërpërmendura vlera totale e shpronësime për By-pass-in e Fierit është 846,312,605 lekë nga të cilat është likuiduar shuma 331,357,877 lekë ose afërsisht 2,674,397 Euro si dhe mbetet për t'u likuiduar detyrimi për shpronësime në shumën totale 514,954,727 lekë.

Në total kosto e realizuar për projektin e By-pass Fier është si në tabelën më poshtë:

Euro

Pagesat e BEI	Pagesat e BERZH	Pagesat e Cooperacione Italiane	Pagesat e TVSH	Pagesat Kosto Lokale	Pagesat e shpronësimeve	Totali
34,324,049	34,238,388	858,210	14,504,096.11	1,621,992	2,674,397	88,221,132.11

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Objekti	Pagesat e BEI	Pagesat e BERZH	Kredi financiare nga Cooperacione Italiane	Kontribut Lokal TVSH parashikuar në marrëveshjen me BEI	Totali Realizimi në %
Financimi	35,000,000	35,000,000	1,000,000	9,400,000	80,400,000
Likuiduar	34,324,049	34,238,388	858,210	11,361,746.8 (7,065,357.8 + 1,621,992 + 2,674,397)	80,783,393.8

Realizimi në %	98%	97.8%	85.8%	120%	100.4%
----------------	-----	-------	-------	------	---------------

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Kosto e përlogaritur e Projektit “Ndërtimi i by-pass-it të Fierit” është 80,400,000 Euro dhe për periudhën nga fillimi i projektit deri më datën 31.12.2021, është realizuar 80,783,393.8 Euro ose në masën 100.4%. Theksojmë se kjo situatë ka ndodhur për shkak të rritjes së vlerës së kontratës së supervizionit të punimeve gjë e cila është mbuluar me financim nga Qeveria Shqiptare.

Në total për Projektin është disbursuar në total për Projektin “Ndërtimin e by-pass-eve Fier-Vlorë” në total si më Poshtë:

Financimi për Projektin “By-pass-in e Fier-Vlorë”				
Nr.	Ligji Burimi i financimit	Shuma	Disbursuar	Realizuar në %
1	Hua nga BERZH	53,000,000	49,635,991.63	93.6%
2	Hua nga BEI	35,000,000	35,000,000	100%
3	Hua nga BEI	18,000,000	13,500,000	75%
5	Grand nga fondet IPA për punimet e by-pass-it të Vlorës	17,000,000	14,543,659.12	85.5%
5	Grand nga fondet IPA për supervizionin e mbikëqyrjen e punimeve të by-pass-it Vlorë	2,365,000	2,365,000	100%
6	Grand nga Cooperacioni Italian (me ndryshime)	858,210	858,210	100%
Totali		126,223,210	102,402,860.75	81.1%

Euro

Burimi i të dhënave: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

4. Titulli i Gjetjes: Mos aplikim i angazhimeve të parashikuara në marrëveshjen e financimit.

Situata: Referuar nenit 6, seksionet 6.01, dhe 6.04, të Ligjit nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, janë përcaktuar angazhimet të cilat duhet të implementohet nga ARRSH për disponueshmërinë e transhve A dhe B të kësaj marrëveshje. Lidhur me këtë situatë nga ARRSH nuk disponohet asnjë dokumentacion ku të vërtetojë se janë realizuar kushtet e parashikuara në marrëveshje për disponueshmërinë e transhit A dhe B edhe pse disbursimet për këto dy transhe kanë vazhduar nga donatori.

Kriteri: Ligji nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, neni 6, seksionet 6.01, dhe 6.04.

Ndikimi/Efekti: Vonesë në kryerjen e disbursimeve.

Shkaku: Neglizhencë nga strukturat e ARRSH-së.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: Nga ARRSH të merren masa në të ardhmen në projektet me financime të huaja, për zbatimin e të gjitha angazhimeve dhe kushteve për disponueshmërinë e fondeve me qëllim shmangien e vonesave për kryerjen e disbursimeve.

5. Titulli i Gjetjes: Vonesa në lëvrimin e fondeve.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje mbi realizimin e disburimeve konstatohet se, në 15 raste janë hasur vonesa në lëvrimin e fondeve nga Banka e Shqipërisë në bankat e nivelit të dytë konkretisht në llogaritë speciale të hapura për Projektin “Ndërtimi i by-pass-eve Fier-Vlorë”. Kjo situatë ka ndodhur për arsye të bërjes aktiv të transhit nga MFE/Banka e Shqipërisë dhe kreditimit të transhit në bankat e nivelit të dytë.

Kriteri: Ligji nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, neni 8, seksioni 8.01.

Ndikimi/Efekti: Mos realizimi i disbursimeve brenda afateve.

Shkaku: Lëvrimi i fondeve nga Banka e Shqipërisë në bankat e nivelit të dytë.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: Nga ARRSH në rolin e Njesisë së Zbatimit të Projektit të marrë masat e duhura që, deri në përfundim të projektit por edhe për projekte të tjera që do të zbatohen prej saj, në rast se do të ketë vonesa në lëvrimin e fondeve nga Banka e Shqipërisë në llogaritë speciale në bankat e nivelit të dytë të bëjë me dije Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për zgjidhjen e kësaj problematike me qëllim shmangien e vonesave në procesin e disbursimeve.

6. Titulli i Gjetjes: Nevoja për fonde shtesë për përfundimin e Projektit.

Situata: Nga auditimi i nivelit të disbursimeve deri më datë 31.12.2021, të Projektit “Ndërtimi i By-pass-eve Fier-Vlorë” konstatohet se, për përfundimin e tij do të duhen fonde shtesë në shumën totale 2,834,313.02 Euro konkretisht:

a) Për përfundimin e kontratës së ndërtimit të punimeve të by-pass-it të Vlorës do të nevojiten fonde shtesë në shumën 2,195,593.08 Euro. Konkretisht për realizimin e kësaj kontrate financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 53,000,000 Euro nga të cilat është disbursuar shuma 41,114,098.94 Euro ose në masën 77.5%. Nga ky fond mbetet për t’u disbursuar shuma 11,885,901 Euro ndërkohë që për përfundimin e kësaj kontrate duhen fonde në shumën 14,081,494.08 Euro. Për financimin e kontratës së supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 700,000 Euro gjithashtu me amendimet e kontratës ka pasur edhe mbështetje buxhetore në shumën 3,158,500 Euro ku totali i financimit shkon në shumën 3,858,500 Euro nga të cilat është disbursuar shuma 3,126,585 Euro ose më masën 81%. Nga ky fond mbetet për t’u disbursuar shuma 731,915 Euro.

b) Për përfundimin e kontratës së ndërtimit të punimeve të by-pass-it të Fierit do të nevojiten fonde shtesë në shumën 224,062.34 Euro. Konkretisht për realizimin e kësaj kontrate financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 70,000,000 Euro nga të cilat është disbursuar shuma 68,562,437 Euro ose në masën 97.9%. Nga ky fond mbetet për t’u disbursuar shuma 1,437,563 Euro ndërkohë që për përfundimin e kësaj kontrate duhen fonde në shumën 1,661,625.34 Euro. Për financimin e kontratës së supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 858,210 Euro gjithashtu me amendimet e kontratës ka pasur edhe mbështetje buxhetore në shumën 1,621,959. Euro ku totali i financimit shkon në shumën 2,480,169.4 Euro nga të cilat është disbursuar shuma 2,480,169.4 Euro ose më masën 10%. Nga ky fond mbetet për t’u disbursuar shuma 414,657.6 Euro. Në lidhje me këtë situatë është parashikuar në marrëveshjet e financimit në rast se do të duhen vonde shtesë për përfundimin e Projektit do të mbulohen me financim nga Qeveria Shqiptare. Gjithashtu kjo situata ka ardhur si pasojë edhe e ndërrej së punimeve nga OE “S..... Co..... S.p.A”.

Kriteri: Ligji nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, neni 8, seksioni 8.01.

Ndikimi/Efekti: Kosto shtesë për Buxhetin e Shtetit.

Shkaku: Si pasojë e ndërrej së punimeve për kontratën e parë të ndërtimit të punimeve duke rritur edhe njëkohësisht konston për kontratat e supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga ARRSH të merren masat për përfundimin e punimeve në afatet e përcaktuara, me qëllim eliminimin e rritjes së vlerës së kontratave të konsulentit, të cilat janë rritur me 3,516,301 Euro, si edhe në të ardhmen për projektet me financime të huaja të zbatojnë me

korrektësi afatet kohore për realizimin e projekteve sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet financiare.

7. Titulli i Gjetjes: Rritje e koston së kontratave të mbikëqyrjes së punimeve si rezultat i vonesave në realizimin punimeve civile.

Situata: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, si pasojë e pezullimit të punimeve nga OE “S..... Co..... S.p.A” dhe lidhja e kontratave të reja për ndërtimin e punimeve, ka çuar mos përfundimin brenda afateve të parashikuara në marrëveshjet e financimit duke shtyrë njëkohësisht në kohë edhe afatet e përfundimit të kontratave të mbikëqyrjes së punimeve duke krijuar një kosto shtesë për Projektin në shumën totale 3,516,301 Euro konkretisht:

a) Për realizimin e komponentit “Punime dhe mbikëqyrje e punimeve të by-pass-it të Vlorës” midis KE dhe Shoqërisë “E..... O.....” S.a është lidhur kontrata nr. 2013/332-025, datë 22.11.2013, me vlerë fillestare 1,663,300 Euro pa TVSH dhe me vlerë të amenduar 3,858,500 Euro pa TVSH. Me amendimin nr. 6, datë 14.09.2021, nr. 2013/332-025/ 2018/401-331, është shtyrë afati i disbursimit deri më datën 15.10.2023, me 22.5 muaj si dhe është amenduar vlera e kontratës prej një shtese në shumën 700,000 Euro nga Qeveria Shqiptare, ku vlera e kontratës shkon 3,858,500 ose 1,493,500 Euro nga parashikimi i financimit në marrëveshjen e Grantit (3,858,500 Euro - 2,365,000 Euro = 1,493,500 Euro) si pasojë e shtyrjes së afatit të punimeve, vlerë e cila përbën kosto shtesë për Projektin.

b) Për realizimin e komponentit “Punime dhe mbikëqyrje e punimeve të by-pass-it të Fierit” midis ARRSH dhe BOE “S..... srl & SWS C..... E..... srl & T..... spa” është lidhur kontrata më datë 21.07.2010, me vlerë fillestare 715,800 Euro pa TVSH dhe me vlerë të amenduar 2,894,827 Euro pa TVSH. Shtyrja e afatit të kontratës së konsulentit është shoqëruar me shtesë së vlerës së saj (me 7 shtesa kontrate) duke bërë që vlera e rishikuar të jetë 2,881,011 Euro pa TVSH ose 2,165,211 Euro më shumë se vlera fillestare. Shtesa e kontratës së konsulencës dhe mbikëqyrjes ka sjell një kosto shtesë për buxhetin e Projektit në shumën 2,022,801 Euro. Shuma 858,210 Euro është mbuluar me financim nga Coperacione italiane dhe shuma 2,022,801 Euro nga Qeveria Shqiptare.

Kriteri: Marrëveshja financiare e datës 30.11.2011, midis Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit Europian dhe Ligji nr. 9342, datë 10.02.2005, “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet KM dhe Mediocreditocentrale (MCC spa), për financimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnje-Fier dhe mbikëqyrjen e punimeve për dy segmente rrugore, Lushnje-Fier dhe Fier-Vlorë”.

Ndikimi/Efekti: Rritje e koston së projektit në shumën totale 3,516,301 Euro.

Shkaku: Mospërfundim i punimeve brenda afatit të parashikuar.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga ARRSH të merren masat për përfundimin e punimeve në afatet e përcaktuara, me qëllim eliminimin e rritjes së vlerës së kontratave të konsulentit, të cilat janë rritur me 3,516,301 Euro, si edhe në të ardhmen për projektet me financime të huaja të zbatojnë me korrektësi afatet kohore për realizimin e projekteve sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet financiare.

8. Titulli i Gjetjes: Vonesa në rimbursimin e TVSH-së.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i pagesave të TVSH-së të kryera nga Qeveria Shqiptare në 44 raste janë konstatuar vonesa në likuidimin e TVSH-së konkretisht, në 10 raste për kontratën e supervizionit të punimeve dhe 6 raste për kontratën e ndërtimit të punimeve të “By-pass-it të Vlorës” si dhe në 12 raste për kontratën e supervizionit të punimeve dhe 16 raste për kontratën e ndërtimit të punimeve të “By-pass-it të Fierit”, pra këto pagesa nuk janë kryer brenda afateve të

përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7.

Kriteri: Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, neni 7.

Ndikimi/Efekti: Risk për krijimin e detyrime kontraktuale.

Shkaku: Vonesa në aprovimin dhe kalimin e fondeve buxhetore.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: ARRSH/Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrin masa për likuidimin në kohë të detyrime ndaj kontraktorëve për pagesat e TVSH-së me qëllim eliminimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe respektimin e kushteve kontraktuale.

9. Titulli i Gjetjes: Vonesa në procesin e shpronësimeve.

Situata: Nga auditimi u konstatua se janë hasur problematika gjatë procesit të shpronësimeve, të cilat kanë sjellë vonesa në zbatimin e punimeve. Vonesat e shkaktuara nga procesi i shpronësimeve ngarkojnë me përgjegjësi ARRSH në rolin e agjencisë së zbatimit të projektit, e cila sipas marrëveshjeve të huas duhet të sigurojë të gjitha të drejtat mbi tokën dhe truallin ku do të kaloj projekti, të drejta të cilat duhen të sigurohen para fillimit të punimeve. Referuar pagesave të kryera për këtë qëllim, vlera e mbetur (detyrim) pa u paguar për shpronësime është 789,538,358 lekë.

Kriteri: Ligji nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, neni 6, seksioni 6.01, gërma “c”.

Ndikimi/Efekti: Vonesa në implementimin e Projektit.

Shkaku: Neglizhencë nga strukturat e ARRSH-së dhe mungesë fundesh.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: ARRSH/Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës së bashku me Drejtorinë e Shpronësimeve të marrin masa dhe ndjekin në kohë problematikat e shkaktuara nga procesi i shpronësimeve si edhe të analizojnë detyrimin e pa paguar në shumën 789,538,358 lekë me qëllim eliminimin e detyrimeve të prapambetura dhe vazhdimin e përfundimit në afat të Projektit.

10. Titulli i Gjetjes: Raportimi i realizimit të disbursimeve jashtë afateve të përcaktuara në marrëveshje.

Situata: Raportimet për realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve janë dorëzuar në MFE ku në përgjithësi janë kryer sipas kuadrit rregullator ligjor por konstatohet se, në 8 raste për vitin 2016, në 4 raste për vitin 2017, në 8 raste për vitin 2018, në 5 raste për vitin 2019, në 3 raste për vitin 2020 dhe në 8 raste për vitin 2021, nga ARRSH nuk janë respektuar afatet për raportimin mbi realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve në MFE në zbatim të përcaktimeve të pikës 5.5, të Udhëzimit nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”. Gjithashtu konstatohet se, në 2 raste për vitin 2016, në 1 rast për vitin 2017, në 1 rast për vitin 2018, në 4 raste për vitin 2019, në 2 raste për vitin 2020 dhe në 2 raste për vitin 2021, nga ARRSH nuk është raportuar mbi realizimin e disbursimeve në MFE. Nga ARRSH ka keq interpretim të dispozitave ligjore të Udhëzimit nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”, konkretisht për muajt që nuk ka pasur disbursime nuk është raportuar në MFE por është quajtur e ezauruar me raportimin vjetor të disbursimeve në të cilën pasqyrohet dhe përfshihet situata e disbursimeve për secilin muaj të vitit ushtrimor.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 17.02.2003, “Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”, pika 5.5.

Ndikimi/Efekti: Mos paraqitje e të dhënave mbi realizimin e disbursimeve financiare dhe shpenzimeve në kohë reale.

Shkaku: Kjo situatë vjen si pasojë e mos respektimit të afateve për raportimin e realizimit të disbursimeve nga Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: ARRSH/Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrë masa që të raportojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë realizimin e disbursimeve financiare dhe shpenzimeve të Projektit brenda afateve të parashikuara në kuadrin rregullator ligjor përkatës.

2.5 Mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe realizimin e punimeve civile.

Procedurat e ndjekura mbi ndërprerjen e kontratave fillestare.

Për ndërtimin e By-Pass-eve të Fierit dhe të Vlorës midis ARrSh-së dhe kompanisë italiane “S..... Co..... SPA” janë lidhur përkatësisht kontratat me objekt “Ndërtim i By-Pas-it Fier” datë 18.03.2013 dhe “Ndërtim i By-Pass-it Vlorë” datë 09.03.2013. Gjatë procesit të zbatimit të punimeve për të dy By-Pass-et nga ana e supervisorëve dhe punëdhënësit është konstatuar se ato kanë qenë me ritme shumë të ulta nga ana e Kontraktorit në bazë të grafikut të punimeve. Duke parë këtë progres dhe komunikimeve të vazhdueshme, ARrSh, për të dy By-Pass-et, konkretisht:

By-Pass Fier

Për kontratën me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Fier”, me shkresën nr.2120.prot datë 20.03.2017 i kërkon Supervisorit të punimeve që bazuar në klauzolën 15-GCC (FIDIC) të lëshojë “Notice to Correct” Kontraktorit “S.....”, duke i dhënë 15-ditë kohë për mobilizim për të rikuperuar vonesat e krijuar.Referuar shkresës së sipërcituar të punëdhënësit, Supervisorit ka lëshuar “Njoftim për korrigjim” “Notice to Correct” - Kontraktorit nëpërmjet shkresës nr.AL/FI-LE/041/17 prot, datë 21/03/2017, duke lënë mundësinë e një inspektimi të përbashkët, ndërmjet të gjithë palëve pjesëmarrëse në projekt më datë 05/04/2017.

Në përgjigje të Njoftimit të Supervisorit, S..... përgjigjet nëpërmjet letrës Nr.prot. 2013/R208/PMG/097, date 27/03/2017 duke argumentuar arsyet e mospërformacës së saj lidhur me disa çështje : shpronësimet, projekti i tenderuar, mos menaxhimi i mire i kontratës nga Supervisorit, pagesat e punën e kryer, etj.Lidhur me gjendjen aktuale në kantier Supervisorit nëpërmjet shkresës nr.AL/FI-LE/050/17, datë 06/04/2017, ka paraqitur në mënyrë të detajuar situatën faktike të punimeve dhe të makinerive ku asgjë nuk ka ndryshuar (everything untouched). ARRSH-ja duke konsideruar që kontraktori nuk beri asnjë përpjekje për të kapërcyer situatën e krijuar (megjithëse ju lanë 15 ditë kohë), me shkresën nr. 3045 prot, datë 20.04.2017 ka lëshuar “Njoftim për ndërprerje” “Notice to Termination” - Klauzola 15.2 –Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (GCC FIDIC)–“Ndërprerje nga punëdhënësi” “Termination by The Employer”. Ndërprerja e kontratës nga punëdhënësi hyn në fuqi efektivisht mbas 14 ditëve, të cilat janë parashikuar që kontraktori të shpërngulet nga kantieri duke kryer të gjitha obligimet kontraktuale të parashikuara në këtë klauzole. Sipas punëdhënësit më datë 25.04.2017 Supervisorit ka lëshuar “Njoftim për ndërprerje” “Notice to Termination”. Duke mos parë asnjë reagim nga Kontraktori për përmirësim të situatës, konform klauzolës 15.2 të FIDIC, Punëdhënësi ARRSH me shkresën Nr. 3603 datë 05/05/2017 i transmeton Kontraktorit S..... “Confirmation of Termination” (Konfirmim i Prishjes së Kontratës).

Pas prishjes së kontratës ARrSh me shkresën Nr.3651.prot, date 08.05.2017 ka kërkuar kthimin e shumës 1.649.416,38 Euro pjesë e paradhënies, e cila nuk është ripaguar deri në atë moment e ndërprerjes së kontratës. Garancia e paradhënies ka datë skadimi 30.09.2016 ku nga ana e Punëdhënësit i është kërkuar Kontraktorit në vazhdimësi shtyrja e vlefshmërisë së Garancisë së Paradhënies duke filluar që nga Shtatori 2016, dhe asnjëherë nuk u realizua e cila është në kundërshtim me kontratën por kjo vlerë e mbetur mund të përfitohet në pagesën pasardhëse. Që nga momenti i përfundimit të afatit të garancisë nga ana e ARRSH nuk është kryer asnjë pagesë e ndërmjetme.

Bazuar në letrën e punëdhënësit për kthimin e garancisë së paradhënies, Kontraktori me letrën Nr.2038/R/208/PMG/0987, date 18/05/2017 ka refuzuar kthimin e saj pasi shprehet se kërkesa e ARRSH për Pagesën e Paradhënies nga ana e Kontraktorit është e parregullt dhe e pamaturuar, pasi që të paguhet nga Kontraktori duhet që të vlerësohet dhe aprovohet nga Supervizori, prandaj ajo quhet e pajustificueshme. Në këto kushte, Punëdhënësi i drejtohet drejtpërdrejt Bankës UniCredit Treviso, Itali, me letrën Nr.5623.prot, datë 10/07/2017 për të mundësuar kthimin e pjesës së mbetur të Garancisë së Paradhënies.

Me date 21/07/2017 Banka UniCredit,Treviso i përgjigjet zyrtarisht Punëdhënësit se kjo Garanci ka skaduar qe me dt.30/09/2016, kështu që banka është e çliruar nga të gjitha përgjegjësitë.

Për të gjitha këto korrespondenca janë venë në dijeni të gjithë strukturat e përfshira në këtë projekt, Bankat Financuese BEI & BERZH, MTI, MF,

Referuar pretendimeve të punëdhënësit sipas Klauzolës 2.5 për Pagesat mbas Termination Klauzola 15.4) GCC – FIDICARRSH paraqet të gjitha Claims e saj lidhur me dëmet dhe pasojat e shkaktuara nga ky fenomen: Përlllogaritja e tyre është bërë për afërsisht, por vlerat e sakta do të evidentohen mbas suportimit me evidenca për secilin rast.

Mbas këtij momenti, Supervizori ka bërë vlerësimin e punimeve të mbetura dhe ia ka dorëzuar Punëdhënësit ku gjithashtu ka rishikuar dhe projektin përfundimtar i cili do të tenderohej për përzgjedhjen e Kontraktorit të Ri.

Bazuar në vendimmarrjen e Supervizorit (referuar klauzolës 3.5-FIDIC), jo përfundimtare nëpërmjet shkresës nr. AL/FI-LE/050/18.prot, datë 26/11/2018, vlera e pretendimeve të konsoliduar dhe të pa konsoliduara të llogaritura janë 20,656,476.98 Euro ku në këtë vlerë përfshihen detyrimet nga punëdhënësit dhe palëve të treta (shërbimet e konsulencës, pagesa e DAB, zyrës së taksave dhe nën-kontraktorët që kanë kryer punimet, etj).

Lidhur me sekuestrimin e Garancisë së Kontratës, sqarojmë se; Punëdhënësi nuk mund ta kryej arbitrarisht këtë veprim konform FIDIC, por duhet të paraqesë ankesë (Claim) kundrejt Kontraktorit për të gjitha humbjet që ka pësuar Shteti Shqiptar nga mosrealizimi i këtij Projekti.

Pasi Supervizori të bej vlerësimin e Claimëve duhet të procedojë me Determination (Klauz. 3.5) dhe kjo vlerë do të mbahet nga Garancia e Kontratës.

Ekspertet ndërkombëtar rekomandojnë se sekuestrimi i menjëhershëm i Garancive të Kontratës nga ana e Punëdhënësit i krijon shanse S..... ti fitoje ato në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar.

ARRSH ka kërkuar edhe opinionin e Avokaturës së Shtetit për qëndrimin që duhet të mbajmë në mbrojtje të interesave të Shtetit Shqiptar.

Me letrën Nr.8236.prot, date 17/10/2019 Punëdhënësi i ka kërkuar bankës UNICREDIT kthimin e Garancisë së Kontratës (menjëherë mbas falimentimit të S.....) me vlere 8,7 Milion Euro e cila shërben për mbulimin e detyrimeve kontraktuale. Lidhur me këtë çështje ARRSH i ka kërkuar disa herë bankës kthimin e Garancisë, por ky proces është ndaluar nga gjykata. Ndërkohë procesi gjyqësor vazhdon. Letra e fundit i është dërguar Bankës në fund të Dhjetorit/2018 (para se të skadonte afati i Garancisë).

By-Pass Vlorë.

Për kontratën me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Vlorë”, me shkresën nr.2119.prot datë 20.03.2017 i kërkon Supervizorit të punimeve që bazuar në klauzolën 15-GCC (FIDIC) të lëshojë "Notice to Correct" Kontraktorit "S.....", duke i dhënë 15-ditë kohë për mobilizim për të rikuperuar vonesat e krijuar. Referuar shkresës së sipërcituar të punëdhënësit, supervizori ka lëshuar “Njoftim për korigjim” "Notice to Correct" nëpërmjet shkresës nr.1193 prot, datë 20/03/2017, duke lënë mundësinë e një inspektimi të përbashkët, ndërmjet të gjithë palëve pjesëmarrëse në projekt më datë 05/04/2017.

Në përgjigje të Njoftimit të Supervizorit , S..... përgjigjet nëpërmjet letrës Ref.No. 0774/R218/GZ/0774, date 28/03/2017 duke argumentuar arsyet e mos performacës së saj lidhur me disa çështje : shpronësimet, projekti i tenderuar, mos menaxhimi i mire i kontrates nga Supervizori, etj.Lidhur me gjendjen aktuale në kantier supervizori nëpërmjet shkresës datë 06/04/2017 ka paraqitur në mënyrë të detajuar situatën faktike të punimeve dhe të makinerive ku asgjë nuk ka ndryshuar (everything untouched).

ARRSH-ja duke konsideruar që kontraktori nuk beri asnjë përpjekje për të kapërcyer situatën e krijuar (megjithëse ju lanë 15 ditë kohë), me shkresën nr. 3042 prot, datë 20.04.2017 ka lëshuar “Njoftim për ndërprerje” "Notice to Termination" - Klauzola 15.2 – Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (GCC FIDIC) – “Ndërprerje nga punëdhënësi” “Termination by The Employer”. Ndërprerja e kontratës nga punëdhënësi hyn në fuqi efektivisht mbas 14 ditëve, të cilat janë parashikuar që kontraktori të shpërngulet nga kantieri duke kryer të gjitha obligimet kontraktuale të parashikuara në këtë klauzole. Sipas punëdhënësit më datë 25.04.2017 supervizori ka lëshuar “Njoftim për ndërprerje” "Notice to Termination". Duke mos parë asnjë reagim nga Kontraktori për përmirësim të situatës, konform klauzolës 15.2 të FIDIC, Punëdhënësi ARRSH me shkresën Nr. 3602 datë 05/05/2017 i transmeton Kontraktorit S..... “Confirmation of Termination” (Konfirmim i Prishjes së Kontratës).

Pas prishjes së kontratës ARrSh me shkresën Nr.3652.prot, date 08.05.2017 ka kërkuar kthimin e shumës 3.538.987,26 Euro, e cila nuk është ri paguar deri në atë moment e ndërprerjes së kontratës. S..... me shkresën Nr. 0801 datë 18/05/2017 njofton se nuk e konsideron veten në kushtet që duhet të kthejë Paradhënien e marrë. Referuar këtij refuzimi te S....., ARRSH me shkresën Nr. 4503 datë 31/05/2017 i drejtohet Bankës "CREDIT AGRICOLE - CARIPARMA" (Banka që ka lëshuar Garancinë Bankare të Paradhënies), të kalojë menjëherë në favor të ARRSH-së Garancinë e Paradhënies, me vlerë 3.538.987,26 Euro.

Banka "CREDIT AGRICOLE - CARIPARMA" me shkresë datë 08/06/2017, njofton se nuk mund të kalojë Garancinë e Paradhënies në favor të ARRSH, pasi kërkon nga ARRSH një Deklaratë Zyrtare (Statement) që Kontraktori ka dështuar të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale, dhe se e ka përdorur Paradhënien e marrë tej objektit të Kontratës.

ARRSH me shkresën Nr. 5625 datë 10/07/2017 i paraqet Bankës "CREDIT AGRICOLE - CARIPARMA" kërkesën e ripërsëritur për Garancinë e Paradhënies, duke i dërguar edhe Deklaratën e kërkuar nga Banka.Garancia e parradhenis ka datë skadimi 14.10.2017.

Banka “Credit Agricole Cariparma” me shkresën e datës 25/07/2017 (ardhur në ARRSH më datë 27/07/2017) njofton ARRSH se “...Banka nuk mund të realizojë pagesën në fjalë, pasi një Vendim i Gjykatës së Pordenones Itali, i datës 24/07/2017, e ndalon të bëjë pagesën në fjalë....”?!?!?Për këtë Vendim të Gjykatës së Pordenones në Itali, ARRSH informohet edhe me shkresën Nr. 1381/17 datë 25/07/2017 të Grupit “A4 H....” (në cilësinë e Kompanisë mëmë të “S.....”), si dhe nga Studio Ligjore “BonelliErede” me shkresën datë 31/07/2017.Gjyqi është hapur nga A4

H...../S..... kundër ARRSH për Garancinë e Paradhënies, pa njoftuar ARRSH apo ndonjë strukturë tjetër të Shtetit Shqiptar.

Për të gjitha këto korrespondenca janë venë në dijeni të gjithë strukturat e përfshira në këtë projekt, Bankat Financuese BEI & BERZH, MTI, MF.

Referuar pretendimeve të punëdhënësit sipas Klauzolës 2.5 për Pagesat mbas Termination Klauzola 15.4) GCC – FIDIC ARRSH paraqet të gjitha Claims e saj lidhur me dëmet dhe pasojat e shkaktuara nga ky fenomen: Përlllogaritja e tyre është bërë për afërsisht, por vlerat e sakta do të evidentohen mbas suportimit me evidenca për secilin rast.

Mbas këtij momenti, Supervizori ka bërë vlerësimin e punimeve të mbetura dhe ia ka dorëzuar Punëdhënësit ku gjithashtu ka rishikuar dhe projektin përfundimtar i cili do të tenderohej për përzgjedhjen e Kontraktorit të Ri.

Bazuar në vendimmarrjen e supervizorit (referuar klauzolës 3.5-FIDIC), jo përfundimtare nëpërmjet shkresës datë 07/11/2018, vlera e pretendimeve të konsoliduar dhe të pa konsoliduara të llogaritura janë 18,565,476.5 Euro ku në këtë vlerë përfshihen detyrimet nga punëdhënësit dhe palëve të treta (Shërbimet e konsulencës, zyra e taksave dhe nën kontraktorët që kanë kryer punimet, etj).

Lidhur me sekuestrimin e Garancisë së Kontratës, sqarojmë se; Punëdhënësi nuk mund ta kryej arbitrarisht këtë veprim konform FIDIC, por duhet të paraqesë Claim kundrejt Kontraktorit për të gjitha humbjet që ka pësuar Shteti Shqiptar nga mosrealizimi i këtij Projekti.

Pasi Supervizori të bëjë vlerësimin e Ankesave (Claimëve) duhet të procedojë me Determination (Klauz. 3.5) dhe kjo vlerë do të mbahet nga Garancia e Kontratës.

Ashtu si në rastin e kontratës për ndërtimin e By-Pass-it Fier, ekspertet ndërkombëtar rekomandojnë se sekuestrimi i menjëhershëm i Garancive të Kontratës nga ana e Punëdhënësit i krijon shanse S..... ti fitojë ato në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar.

Me letren Nr.8237.prot, date 17/10/2019 Punëdhënësi i ka kërkuar bankës “Credit Agricole Cariparma” kthimin e Garancisë së Kontratës (menjëherë mbas falimentimit të S.....) me vlerë 7,057,975 Euro e cila shërben për mbulimin e detyrimeve kontraktuale, ku kjo është kërkuar disa here, por ky proces është ndaluar nga gjykata. Ndërkohë procesi gjyqësor vazhdon. Letra e fundit i është dërguar Bankës në fund të Dhjetorit/2018 (para se të skadonte afati i Garancisë).

Në vazhdim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ARRSH i dërgon për opinion/komente kontraktorit dhe vlerësimin e punimeve të kryera, nëpërmjet shkresës nr. AL/FI-LE/092/17, date 20/09/2017, në mënyrë që të arrijë në determination bazuar me klauzolen 3.5.

ARRSH-ja i ka paraqitur DAB Closing Submission nr. 6610 prot, datë 22.08.2017 dhe më pas fillon procedurën për tërheqjen e garancive të kontratës (bazuar në klauzolën 4.2-GCC FIDIC).

Nëpërmjet shkresës nr. 8963 prot, datë 07.11.2017, ARRSH-ja njofton supervizorin dhe kontraktorin lidhur me vlerësimin e pretendimeve të ARRSH-së (Klauzola 2.5), mbas ndërprerjes së kontratës nga ana e tij (Klauzola 15.4) deri në këtë periudhë. Nga ana e DAB nuk është kryer asnjë vlerësim pasi kontraktori nuk ka kryer pjesën e pagesës së tij për veprime të mëtejshme.

Nëpërmjet shkresës nr. 8962 prot, datë 07.11.2017, ARRSH-ja njofton përfaqësuesin e DAB (J.Papëorth), si edhe supervizorin dhe kontraktorin lidhur me pagesën e tij përfundimtare deri në fund të dhjetorit/2017.

ARRSh, për ankesën (claim) ndaj kontraktorit referuar klauzolës 15.3, duhet të kryente një punë voluminoze e cila kërkonte kohë për vlerësimin total të pretendimeve të tij. Gjatë kohës këtyre vlerësimeve nga Supervizori, ARRSH njoftohet për Vendimine Gjykatës së Veronës, date 04/10/2017 ku në të shpallet Falimentii kompanisë “S.....” dhe caktimin e personave përgjegjës.

Të ndodhur para një situate ku nuk mund të tërhiqen garancitë e kontratave pasi ato janë bllokuar me vendime gjyqësore në vendin e lëshimit të tyre (Itali), pa dijeninë e ARRSH dhe Shtetit Shqiptar punëdhënësi me shkresat Nr. 4088 datë 18/08/2017 dhe Nr.4088/2, datë 22.08.2017 “Ndërtimi i Seksioneve Rrugorë By Pass-et e Vlorës dhe Fierit” kërkon opinion mbi strategjinë që duhet të ndjekin për të marrë garancitë e kontratave dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga ndërprerja e tyre.

Me shkresën nr. 8079, datë 11.10.2017 ARRSH ka kërkuar vendimmarrje nga Avokatura e Shtetit mbi strategjinë që duhet ndjekur.

Me shkresën nr. 2365/7, datë 13.10.2017 “Mbi garancitë e kontratave të By Pass-it të Vlorës dhe By Pass-it të Fierit” Avokatura e Shtetit ka kthyer përgjigje mbi vijueshmërinë e procesit.

Nëpërmjet shkresës nr. 10338 prot, datë 20.12.2017, ARRSH-ja i drejtohet Avokaturës së Shtetit duke i dërguar kopjen në italisht/anglisht të Peticionit të përkohshëm të Gjykatës së Veronës, bazuar në Kodin e Procedurës Civile Italiane.

Me shkresën nr. 10275/1, datë 21.12.2017 në vijim të korrespondencës ARRSH-ja, kërkon “...përcaktimin e hapave që duhen ndjekur për përfaqësimin e saj në gjykatën e Veronës-Itali me datë 8 Janar 2018, kontratën për By Pass-in Fier”.

-Në përgjigje, me shkresën nr. 2365/14, datë 22.12.2017, Avokatura e Shtetit sugjeron se “në kushtet kur përfaqësimi dhe mbrojtja e çështjes do të bëhet para një gjykate italiane referuar nenit 18/1 të Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, Avokatura e Shtetit autorizohet të kontraktojë avokatë/zyrë avokatie vendase ose të huaj....Në kushtet kur VKM-ja 392/2009 nuk parashikon raste kur mund të kontraktojmë në mënyrë urgjente avokatë..... **sugjerojmë** që institucioni juaj të marrë masa vetë për përfaqësimin në procesin gjyqësor...duke autorizuar një avokat Italian për mbrojtjen e interesave të ARRSH-së..... duke i dhënë një prokurë të posaçme një avokati/studio italiane me të cilin Institucioni ynë ka eksperiencë”.

Me shkresën nr. 10576, datë 23.12.2017 “Mbi kërkesën urgjente për përfaqësimin ligjor në Gjykatën e Veronës, segmenti rrugor “By-Pass Fier” ARRSH ka kërkuar përcaktimin e zyrës së avokaturës që do e përfaqësojë në gjyq në Itali nga ana e Avokaturës së Shtetit.

Nëpërmjet shkresës nr. 482/2 prot, datë 19.01.2018, të MIE-s drejtuar ARRSH, kërkohet dërgimi i ftesës për pretendime në cilësinë e kreditorit të S..... në proces falimentimi.

Nëpërmjet shkresës nr. 552/1 prot, datë 23.01.2018, Drejtoria Juridike/ ARRSH informon lidhur me vazhdimin e procedurave me Avokatin e Shtetit.

Nëpërmjet shkresës nr. 744 prot, datë 24.01.2018, ARRSH-ja i drejtohet dy përfaqësuesve të S..... në proces falimentimi, ku i paraqet vlerat e pretendimeve të saj për të dy kontratat.

Nëpërmjet shkresës nr. 600/1 prot, datë 24.01.2018, Drejtoria Juridike/ ARRSH dërgon ftesën për depozitim pretendimi në cilësinë e kreditorit nëpërmjet shkresës së MIE nr. 484/2 prot. datë 19.01.2018.

Nëpërmjet shkresës nr. 2190 prot, datë 20.03.2018, ARRSH-ja i drejtohet dy përfaqësuesve të S..... në proces falimentimi, ku i paraqet vlerat e pretendimeve të saj për të dy kontratat të konsoliduara dhe jokonsoliduara deri në këtë periudhë.

Nëpërmjet shkresës nr. 3256/1 prot, datë 20.04.2018, ARRSH-ja i drejtohet UNI-Credit Bankë, si edhe njofton Bankën e Shqipërisë, Kontraktorin, Supervizorin, MIE dhe MFE, Bankat, Bankën e Italisë, lidhur me kërkesën për tërheqjen e garancisë së kontratës.

Nëpërmjet shkresës nr. 3315 prot, datë 20.04.2018, ARRSH-ja i drejtohet dy përfaqësuesve të S..... në proces falimentimi, supervizoreve ku i paraqet vlerat e pretendimeve të saj për të dy kontratat lidhur me TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 3479 prot, datë 26.04.2018, ARRSH-ja i drejtohet përsëri UNI-Credit Bankë, si dhe njofton Bankën e Shqipërisë, Kontraktorin, Supervizorin, MIE dhe MFE, Bankat, Bankën e Italisë, lidhur me kërkesën për tërheqjen e garancisë së kontratës.

Nëpërmjet shkresës nr. 5722 prot, datë 28.06.2018, ARRSH-ja i drejtohet përsëri UNI-Credit Bankë, si edhe njofton Bankën e Shqipërisë, Kontraktorin, Supervizorin, MIE dhe MFE, Bankat, Bankën e Italisë, lidhur me kërkesën për tërheqjen e garancisë së kontratës.

Nëpërmjet shkresës nr. 8528 prot, datë 03.10.2018, ARRSH-ja i drejtohet dy përfaqësuesve të S..... në proces falimentimi, supervizorit ku i paraqet vlerat e pretendimeve të saj për të dy kontratat te konsoliduara dhe jokonsoliduara deri në këtë periudhë.

Nëpërmjet shkresës nr. 11036 prot, datë 06.12.2018, ARRSH-ja i drejtohet përsëri UNI-Credit Bankë, si edhe njofton Bankën e Shqipërisë, Kontraktorin, Supervizorin, MIE dhe MFE, Bankat, Bankën e Italisë, lidhur me kërkesën për tërheqjen e garancisë së kontratës.

Nëpërmjet shkresës nr. 11662 prot, datë 21.12.2018, ARRSH-ja i drejtohet dy përfaqësuesve të S..... në proces falimentimi, ku i paraqet vlerat e pretendimeve të saj për të dy kontratat të konsoliduara dhe jo konsoliduara deri në këtë periudhë të cilat janë në shumën 20,656,476.98 Euro për kontratën e By-Pass-it të Fier dhe 18,565,476.5 Euro për kontratën e By-Pass-it Vlorë.

Procedurat e ndjekura për përfitimin e detyrimeve të kontraktorit dhe garancisë para dhe pas shpalljes së falimentit nga gjykata.

Të gjithë nën-kontraktorët, furnitorët e shërbimeve që kanë ofruar gjatë zbatimit të punimeve kontraktorit “S.....” kanë transmetuar shqetësimin e tyre pranë Qeverisë Shqiptare (Kryeministrit, MTI, ARRSH, etj) si dhe pranë bankave BEI & BERZH & Delegacionit European për mos likuidim të tyre nga ana e tij. Për këtë arsye ARRSH me shkresën Nr.319.prot, datë 17.01.2017 ka kërkuar mendim këshillimor pranë Avokaturës së Shtetit.

-Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 276/1, datë 20.1.2017, kërkon vënien në dispozicion të dokumentacionit për këtë çështje i cili vu në dispozicion me shkresën nr. 611 prot, datë 26.1.2017.

-Avokatura e Shtetit me shkresën me nr. 276/3 prot, datë 10.02.2017 i drejtohet Dashamir Xhika me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, ku ndër të tjera është shprehur “ Me shkresën tuaj nr. 319 prot, datë 17.01.2017 keni kërkuar mendim këshillimor mbi aplikimin e kompanisë “S..... Co..... Spa”, për marrjen pagesave të situacioneve nga jashtë vendit. “..Referuar përmbajtjes së shkresës tuaj, Avokatura e Shtetit nuk vëren të ketë ndonjë mospërputhje ose paqartësi ndërmjet dispozitave të kontratës të lidhur ndërmjet palëve. Për këtë arsye do të sugjeronim që çdo aspekt teknik për implementimin e kontratës të bazohet në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se është edhe legjislacioni i aplikueshëm e kontratës”.

ARRSH-ja me shkresën nr. 1394 prot, datë 21.2.2017, kërkon saktësim të opinionit (sugjerimit) të dhënë nga Avokatura e Shtetit duke u shprehur “Nëse mund të lejohemi të bëjmë pagesat e kontraktorit jashtë shtetit apo jo?” dhe me shkresën nr. 276/5, datë 15.3.2017, Avokatura e Shtetit sqaron se “Do të sugjeronim që kërkesat e Kontraktorit të zbatohen bazuar në parashikimet e kontratës....Theksojmë se faktet e paraqitura nga Ju, nuk kërkojnë interpretim juridik nga Avokatura e Shtetit por vlerësimin e ARRSH, si institucion përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të detyrimeve kontraktore...”.

-Nëpërmjet shkresës nr. 6839 prot, datë 30/08/2017, ARRSH-ja njofton Supervizorin, Bankat, dhe DAB për Vendimin e Gjykatës së Veronës datë 18.08.2017, i cili i jep 60 ditë kohë S..... që të likujdojë nën kontraktorët e saj në mënyrë që të mos falimentojë. Për menaxhimin e këtij procesi janë caktuar dy komisionarë.

-Avokatura e Shtetit me shkresën me nr. 2365/7 prot, datë 13.10.2017 i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm, me lëndë “Mbi garancitë e kontratave By-pass-it të Vlorës dhe By-Pass-it të Fierit

ku ndër të tjera shprehet se “ neni 4.2 “Sigurimi i kontratës” i kushteve të përgjithshme të kontratës ka përcaktuar *“Punëdhënësi nuk do të ngrejë pretendime mbi sigurimin e kontratës, përveçse për shumat që i takojnë atij sipas kontratës. Punëdhënësi do të zhdëmtoj kontraktorin për çdo humbje apo çdo dëmtim shkaktuar këtij të fundit, të cilat rezultojnë nga një pretendim që nuk kishte të drejt sipas kontratës”*. Klauzola më lart për sigurimin e kontratës nuk parashikon ndonjë procedurë konkrete për vjeljen e garancisë së kontratës, gjë që nuk gjendet e parashikuar as në klauzolat vijuese të kontratës.

Por referuar klauzolës 15.3 *“Të marr, tërheq nga kontraktori çdo humbje dhe dëme të pësuar nga punëdhënësi, si dhe çdo kosto ekstra për përfundimin e punimeve, pasi të jetë përcaktuar shuma që i takojnë kontraktorit sipas klauzolës 15.3 (Valuation at date of termination), nga inxhinieri. Pasi ti ketë marrë, përfituar këto shuma mbi humbjet, dëmet dhe kostot ekstra, punëdhënësi do ti paguajë diferencën kontraktorit”*.

Kontrata FIDIC nuk parashikon konkretisht që situata në likuidim e një shoqërie, të përbëj shkak të menjëhershëm për tërheqjen e garancive, por klauzola 15.4 e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, ka përcaktuar në rastin e përfundimit të kontratës punëdhënësi mund të marr tërheq nga kontraktori çdo humbje dhe dëme të pësuar nga kontraktori, si dhe kosto ekstra për përfundimin e punimeve, pasi të jenë përcaktuar shumat që i takojnë kontraktorit, sipas klauzolës 15.3 (Valuation at date of termination), nga inxhinieri, pasi ti ketë marrë, përfituar këto shuma mbi humbjet, dëmet dhe kostot ekstra, punëdhënësi do ti paguajë diferencën kontraktorit. I vetmi mjet ku mund të mbështetet punëdhënësi për vjeljen e shumave sipas pikës 15.3, pika 3, është garancia.

-ARRSH-ja i kërkon UniCREDIT- Treviso nëpërmjet shkresës nr. 8236 prot, datë 17.10.2017, tërheqjen e garancisë së kontratës.

-Shkresa ARRSH-së me nr. 4088/2 prot, datë 22.08.2017 drejtuar Avokaturës së Shtetit, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Kabinetit të Kryeministrit dhe për dijeni Ministrisë së Financave, me referencë shkresa e ARRSH nr. 4088, datë 18.05.2017 dhe shkresa nr. 6308, datë 04.08.2017. Ku është shprehur se : “Në vijim të procesit për të gjithë procedurat që vijnë pos ndërprerjes së kontratave me kompaninë kontraktore “S..... Co..... Spa”, ARRSH me shkresën nr. 4088 prot, datë 18.05.2017 i është drejtuar Avokaturës së Shtetit, MTI, Ministrisë së Financave dhe Kryeministrisë, ka paraqitur pozicionin e vet në lidhje me garancitë e kontratave për By-Pass-et Vlorë & Fier, si më poshtë:

Sekuestrimi i garancive të kontratave (Performance Security), në mënyrë specifike, lidhur me sekuestrimin e garancive të kontratave (Performance Security), eksperti ndërkombëtar (Asistenca e Huaj e ARRSH) C J, rekomandon që konformë FIDIC, ARRSH nuk mund të sekuestrojë direkt garancitë e kontratave, por duhet të ngrejë CLAIM ndaj kontraktorit, për të gjitha humbjet dhe shpenzimet që ka pësuar Shteti Shqiptar, nga mos realizimi i këtyre kontratave, dhe vlera CLAIM-ve, pasi të kaloj nga vlerësimi i supervizorit (Engineer,s Determination), do të mbahet garancitë e kontratave. Ky argumentim, rekomandohet edhe nga kompanitë e supervizorëve respektiv të këtyre kontratave, të cilët kanë ekspertë kontratash në stafet e tyre. Këta ekspert ndërkombëtar rekomandojnë se sekuestrimi i menjëhershëm i garancive të kontratave nga ana e punëdhënësit, krijon shanse shumë të mëdha “S..... Co..... Spa”, ti rifitoj këto garanci në Gjykatë e Arbitrazhit Ndërkombëtar, vetëm për mos ndjekjen e procedurës së duhur për tërheqjen e garancive. Duke qenë se ARRSH-ja, nuk ka eksperiencë të ngjashme më parë për situata të tilla, kërkojmë opinionin e Avokaturës së Shtetit për këtë çështje, apo të studiove ose ekspertëve ndërkombëtar që Institucioni i juaj mund të bashkëpunoj apo angazhojë. Vendimmarrjet në këto momente janë shumë të rëndësishme në mbrojtjen e interesave të Shtetit Shqiptar, të cilat

konsistojnë në miliona Euro, ndaj insistojmë në përfshirjen aktive të të gjithë strukturave të shtetit të profilizuara në këtë çështje, me qëllim ngritjen e një strategjie të saktë, që duhet të ndjekim për këtë çështje specifike. Gjithashtu, sikurse ju kemi vënë në dijeni ARRSH-ja i ka paraqitur kontraktorit dhe supervisorëve respektiv Claim-et (Penalitetet) e ngritura nga ARRSH konformë klauzolave 2.5 (Employer,s Claims) dhe 15.4 (Payment after Termination) të FIDIC, për dëmet, humbjet shpenzimet e punëdhënësit ardhur nga mos-realizimi i kontratave nga “S..... Co..... Spa”.

Në përgjigje, Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 2365/1, datë 23.8.2017, duke ju referuar e-mail të ARRSH-së është vënë në dijeni të faktit, se *”Kontraktori “S.....” ka refuzuar të kthejë paradhënien në vlerën 10% të kontratës, si dhe nga Banka “Credit Agricole Cariparma”, nuk mund të realizohet pagesa pasi Vendimi i Gjykatës së Pordenones-Itali, datë 24.7.2017 ndalon kryerjen e pagesës.... seanca e radhës është vendosur të mbahet datë 7.9.2017.....çmojmë se në rastin konkret, **plotësohen kriteret për fillimin e procedurës së kontraktimit të avokatëve në profesion të lirë... Procedura standarde e kontraktimitështë relativisht e gjatë, ...seanca e radhës e caktuar nga Gjykata e Pordenones është datë 7.9.2017dhe procedura e kontraktimit kërkon minimalisht 35-40 ditë.... Për shkak të urgjencës.....**sugjerojmë** që Institucioni Juaj të përfaqësohet ... duke i dhënë prokurë të posaçme një avokati/studio italiane me të cilën Institucioni ynë ka eksperiencë në një çështje tjetër.... deri në zhvillimin e një procedure kontraktimi të përshpejtuar.... Më pas do të sugjeronim që KM si organ ngarkuar me ligj për të përcaktuar rregullat e procedurat për kontraktim përjashtimisht për këtë rast të përcaktojë një procedura të përshpejtuar.... ”.***

Shkresa ARRSH me nr. 8079 prot, datë 11.10.2017 drejtuar Avokaturës së Shtetit për dijeni: Ministrisë së Infrastrukturës e Energjisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Kabinetit të Kryeministrit Ku është shprehur se : I referohemi e-mail-it tonë datë 06.10.2017, në të cilin ju kemi vënë në dijeni mbi vendimin e Gjykatës së Veronës që shpall falimentimin e Kompanisë “S..... Co..... Spa”. Referuar konsultimeve me Asistencën e Huaj teknike të ARRSH-së, si dhe me supervisorët e kontratave mbi këtë situatë të re të krijuar, mendojmë nga ky moment na lind e drejta të bëjmë kërkesë për tërheqjen e garancive të kontratave respektive, pa pritur vendimmarrjen e supervisorëve për vlerën e penalteteve të punëdhënësit, për gjithë dëmet, humbjet apo shpenzimet e punëdhënësit ardhur nga mos realizimi i kontratave nga Kompania “S..... Co..... Spa”. Në vijim të shkresës sonë nr. 4088/2, datë 22.08.2017, jemi në pritje të vendimmarrjes suaj për strategjinë që duhet ndjekur për sekuestrimin e garancive të kontratave, duke konsideruar edhe kushtet aktuale të shpalljes së falimentit të Kompanisë “S..... Co..... Spa”.

-ARRSH-ja i kërkon UniCREDIT kthimin e garancisë së kontratës nëpërmjet shkresave nr. 9193 prot, datë 15/11/2017, nr. 9501 prot, datë 24.11.2017 dhe nr. 9766 prot, datë 05.12.2017, duke i lënë 5-ditë kohë nga momenti i dërgimit të letrës, si edhe duke i ciftuar të gjitha arsyet kontraktuale nga të cilat buron kjo kërkesë.

Në vijim me shkresën nr. 2365/9, datë 15.11.2017 Avokatura e Shtetit drejtohet ARRSH-së dhe për dijeni MIE dhe Ministria e Drejtësisë se *“...na informoni se kërkesës suaj të datës 17 Tetor 2017drejtuar Bankës Credit Agricole Itali....Banka i përgjigjet .. se”refuzon pagesën në fjalë pasi një vendim i Gjykatës së Pordenones-Itali, i datës 24.7.2017 ndalon kryerjen e kësaj pagese...”*.....Për shkak të urgjencës që karakterizojnë këtë çështje duke marrë në konsideratë se është pezulluar kryerja e pagesës së garancisë së kontratës së By Pass-it të Vlorës nga Banka... kundrejt ARRSH **sugjerojmë** që Institucioni Juaj të përfaqësohet në seancën e datës 7.12.2017 në Gjykatën e Pordenones, Itali , duke i dhënë një prokurë të posaçme avokatit/studios italiane me të

cilën Institucioni juaj ka eksperincë në çështjen paralel ... deri në zhvillimin e një procedure kontraktimi të përshpejtuarMë pas do të sugjeronim që KM si organi i ngarkuar me ligj për të përcaktuar rregullat e procedurat për kontraktim, ...të përcaktojë një procedurë të përshpejtuar dhe drejtpërdrejtë kontraktimi”.

Në përgjigje, MIE me shkresën nr. 406/3, datë 22.11.2017shprehet se ”...Lidhur me këtë sugjerim tuajin në kuptim të VKM nr. 392/2009 është e nevojshmetë jepni një informacion më të detajuar për kërkesën tuaj për miratimin e një akti të Këshillit të Ministrave, që sipas jush do të përcaktojë një procedurë të përshpejtuar dhe të drejtpërdrejtë kontraktimi.....”.

Më datë 05.12.2017 dërgohet nga Znj.M I (Juriste) peticioni dhe Vendimi i Gjykatës së Veronës datë 22.11.2017 ku A4 H... (Kompania mëmë) padit UniCREDIT dhe ARRSH lidhur me çështjen e Garancive Bankare. Sipas këtij Vendimi, i kërkohet Bankës të mos paguajë garancitë në emër të ARRSH-së, si edhe të mos i kërkoj ato nga A4 H..... Data e gjyqit është caktuar më 08.01.2018. UniCREDIT nëpërmjet letrës së saj të datës 15.12.2017 sqaron se nuk mund të veprojë pasi ndalohet nga Vendimi i Gjykatës së Veronës datë 22.11.2017.

Shkresa ARRSH me nr. 10270/1 prot, datë 21.12.2017 drejtuar Avokaturës së Shtetit, ku është shprehur se “ Referuar letrës përcjellëse të Avokates Italiani M I datë 05.12.2017, si dhe kërkesës së UniCREDIT datë 15.12.2017, në të cilën përcjell vendimin e kësaj banke, për të mos plotësuar kërkesën tonë për pagimin e garancisë së kontratës, për shkak të vendimit të Gjykatës së Veronës e cila ka pranuar kërkesën e A4 H....., si garantor i kësaj garancie. Kjo gjykatë ka vendosur që më datë 08.01.2018 do të mbahet seanca ku palët shprehin faktet e tyre në lidhje me këtë çështje. Për sa më sipër kërkojmë nga ana e juaj koordinimin dhe përcaktimin e hapave që duhen ndjekur për përfaqësimin e ARRSH në këtë çështje.

Avokatura e Shtetit me shkresën me nr. 2365/14 prot, datë 22.12.2017 i drejtohet A Q me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, ku ndër të tjera “..... sa më lartë sqarojmë se, në kushtet kur, përfaqësimi dhe mbrojtja e çështjes do të bëhet përpara një Gjykate Italiane, çmujmë se në lidhje me këtë, kërkohet njohje dhe ekspertizë e posaçme mbi legjislacionin e zbatueshëm Italian, i aplikueshëm për këtë proces gjyqësor. Në raste të tilla, në çështje të rëndësishme ose që për nga natyra kërkojnë njohuri të specializuara, referuar legjislacionit të zbatueshëm nga Avokatura e Shtetit, kjo e fundit në bazë pikës 1, të nenit 18 të Ligjit 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, autorizohet të kontraktojë avokatë apo zyra avokatie vendase dhe të huaja për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit Shqiptar. Kontraktimi bëhet kundrejt një procedurë konkurrimi referuar VKM nr. 392, datë 08.04.2009 “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me Institucionet Shtetërore”..... Procedura është relativisht e gjatë, për rastin konkretë, duke pasur në konsideratë se Avokatura e Shtetit e vendos zyrtarisht në dijëni të datës së gjyqit të caktuar nga Gjykata e Veronës, vetëm më datë 21.12.2017 dhe seanca do të mbahet më datë 08.01.2018, ndërkohë që procedura e kontraktimit kërkon minimalisht 35 ditë kohë, sugjerojmë që institucioni i juaj të masa vetë për përfaqësimin në procesin gjyqësor në fjalë, duke autorizuar një avokat Italian për mbrojtjen e interesave të ARRSH para Gjykatës së Veronës”.

Shkresa ARRSH me shkresën nr. 10576 prot, datë 23.12.2017 drejtuar Avokaturës së Shtetit, për dijëni Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ndër të tjera është shprehur se “.....Në këto kushte, meqenëse Institucioni i Juaj njuh dhe zbaton procedurat standarde të kontaktimit të avokatëve të huaj, si dhe procedurat e kontraktimit mund të lejojnë mundësinë e kontraktimit edhe avokatit që përfaqëson çështjen e By-Pass-sit të Vlorës, ARRSH shprehet e gatshme që të jap autorizim për përfaqësimin pas caktimit të emrit të caktuar nga ana e Juaj”. Ndërkohë, ARRSH ka bërë me dije në cilësinë e organit të interesuar, do marr masa për të përballuar kostot që do të gjenerojë ky proces, pas dërgimit të dokumentacionit përkatës nga Avokatura e Shtetit.

Avokatura e Shtetit me shkresën me nr. 2365/16 prot, datë 26.12.2017 i drejtohet A Q me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, ku ndër të tjera “.....Nisur nga natyra e veçantë dhe e ndërlikuar juridike e çështjes në fjalë, duke qenë se kërkohet njohje dhe ekspertizë e posaçme mbi legjislacionin e zbatueshëm Italian për përfaqësimin ligjor para gjykatës italiane, si dhe mbi legjislacionin ndërkombëtar për ekzekutimin e garancive bankare, çmujmë se përfaqësimi i interesave të ARRSH-së në këtë çështje, duhet të bëhet nga një avokat Italian i specializuar dhe i njohur me procedurat gjyqësore të Shtetit Italian. Avokatura e Shtetit nuk është në gjendje të ofrojë asistencë juridike në këtë rast, për shkak se nuk ka staf të specializuar për çështje të tilla, ashtu sikur nuk ka një avokat italian në dispozicion për ta angazhuar për rastin konkret. Institucioni ynë ka marrëdhënie me një avokat italian, i cili është kontraktuar nga Avokatura e Shtetit, për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar, në një çështje që po zhvillohet para gjykatave italiane. Avokatin në fjalë ARRSH e ka autorizuar për përfaqësimin ligjor dhe mbrojtjen e interesave të saj në çështjen e By-Pass-it të Vlorës, e në rast se e çmoni të arsyeshme për urgjencën e rastit mund të autorizoni dhe angazhoni në këtë çështje. Theksojmë se, mungesa e kohës në dispozicion përbën pengesë për ndjekjen e procedurave nga Avokatura e Shtetit sipas afateve të përcaktuara nga VKM-ja 392/2009, në mënyrë që të realizohet në kohë kontraktimi i një avokati për të përfaqësuar ARRSH para Gjykatës së Veronës në seancën e datës 08.01.2018.

Në kushtet kur VKM-ja 392/2009, nuk parashikon raste kur mund të kontaktojmë në mënyrë urgjente avokatë, duke marrë në konsideratë interesin e veçantë dhe urgjencën e kohës, institucioni juaj, mund të konsiderojë mënyra të tjera për angazhimin e një avokati për përfaqësimin e ARRSH-se për çështjen gjyqësore në fjalë, siç janë prokurimi i shërbimeve të konsulencës sipas ligjit të prokurimit publik, në kushtet e emergjencës apo inicimin e një VKM-je për kontraktimin e një avokati.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e programimit, standardizimit dhe harmonizimit të kuadrit rregullator) me shkresën nr. 4003/1 prot, datë 18.01.2018 i drejtohet Autoritetit Rrugor Shqiptar, mbi përfaqësimin e ARRSH pranë Gjykatës së Veronës për garancinë e kontratës, lidhur me ndërtimin e seksioneve rrugor By-Pass-set e Vlorës dhe Fierit, ku ndër të tjerat citohet “ Me anë të shkresës suaj me nr. 10577, datë 23.12.2017, protokolluar me tonën nr. 4003, datë 26.12.2017, keni dërguar informacion për komunikimin e mbajtur me avokaturën e shtetit, lidhur me përfaqësimin tuaj pranë Gjykatës së Veronës, si dhe përsa i përket të drejtës që lind institucionit tuaj për tërheqjen e garancisë së kontratës, e cila mbështet në mos realizimin nga kontraktori “S..... Co..... Spa”, lidhur me komunikimin sqarojmë e “ARRSH, është një person juridik publik, i ngritur me Ligjin nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për menaxhimin e rrjetit rrugor shtetëror, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Për drejtimin e kësaj veprimtarie është miratuar edhe struktura përkatëse ku mundësohet kryerja e veprimeve operacionale dhe shërbimeve mbështetëse për menaxhimin e çështjeve që lidhen me kontratat e ndërtimit të rrugëve. Jemi të mendimit që ARRSH, duke qenë i specializuar që ka tashmë një praktikë të gjerë në ndjekjen dhe monitorimin e kontratave të ndërtimit të rrugëve, ka dhe të gjitha kapacitetet për të vlerësuar mbi kërkesat e ngritura nga Avokatura e Shtetit. Nga ana tjetër, kujtojmë që në përputhje me Ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, Avokatura e Shtetit është institucion i qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike për institucionet shtetërore dhe entet publike. Asistenca juridike përfshinë shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit. Po ashtu në bazë të nenit 2 dhe 5 të Ligjit 10018/2008, për përfaqësimin e enteve publike në gjykatat e huaja, asistenca juridike e Avokaturës së Shtetit është e detyrueshme. Pra sa më sipër, lutemi vijimin e komunikimeve me Avokaturën e Shtetit dhe kryerjen e të gjithave veprimeve për përfaqësimin e kësaj çështjeje dhe mbrojtjen e interesave të shtetit.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e programimit, standardizimit dhe harmonizimit të kuadrit rregullator) me shkresën nr. 484/2 prot, datë 19.01.2018 i drejtohet Autoritetit Rrugor Shqiptar, me objekt “Dërgohet ftesa për depozitim pretendimi në cilësinë e kreditorit të shoqërisë “S..... Co..... Spa”, në proces falimentimi. Ku në këtë shkresë është shprehur: Pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ka ardhur shkresa nr. 484 prot, i MIE, datë 10.01.2018 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me anë të së cilës dërgohet ftesa e administratorëve të procesit të falimentimit të shoqërisë “S..... Co..... Spa”, rezidente në Itali, për depozitimin e pretendimeve në cilësinë e kreditorit të shoqërisë, duke qenë se kjo shoqëri rezultoi të ketë degën e saj në Shqipëri, përkatësisht shoqërinë “S..... Co..... Tirana”. Seanca gjyqësore do të zhvillohet më datën 30 janar 2018, ora 13.15. Sa më sipër, po ju përcjellim bashkëlidhur praktikën e mësipërme, me qëllim identifikimin nga ana e juaj të pretendimeve të ARRSH, që mund të ketë ndaj shoqërisë “S..... Co..... Spa”, në cilësinë e kreditorit të kësaj shoqërie, si dhe paraqitjen e aplikimeve përkatëse sipas formës, procedurës dhe afateve të parashikuara në ftesën e administratorëve të procesit të falimentit.

ARRSH-ja i ka dërguar dy përfaqësuesve të gjykatës italiane në Itali (të cilët merren me procedurën në fjalë) vlerësimin e krediteve të tij përkundrejt S..... për të dy kontratat, bazuar në përlllogaritjen e pretendimeve të punëdhënësit (Klauzola 2.5- KPK FIDIC) deri në Shtator 2017, të cilat pjesërisht janë miratuar nga supervizori dhe pjesërisht presin vendimmarrjen e DAB (shkresa nr. 744 prot, datë 24/01/2018)

ARRSH-ja i ka kërkuar UniCREDIT kthimin e garancisë së kontratës nëpërmjet shkresave nr. 3256 prot, date 20/04/2018.

Drejtor i Përgjithshëm i ARRSH A Q me prokurë të posaçme nr. 11455 rep, nr. 4019 kol, datë 19.12.2017 ka caktuar përfaqësues avokatin Italian M P për të përfaqësuar ARRSH-në në procedurën në lidhje me falimentimin nr. 154/2017 të “S..... Co..... Spa”, në likuidim, për të qenë i pranishëm në seancën e verifikimit të statusit pasivë në Gjykatën e Veronës më datë 30.01.2018 dhe në çdo seancë tjetër në të gjitha nivelet e gjykimit. Kontrata me këtë avokatë është lidhur më 28.12.2018. Çmimi i kësaj kontrate është përcaktuar me VKM nr. 491, datë 31.07.2018 në vlerën 180,000 Euro. Likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 1485, datë 31.12.2018 në vlerën 18,811,350 lekë.

Vlera e pretenduar nga ARRSH si detyrim i kompanisë S..... për ndërprerjen e detyrimeve kontraktuale është 36,423,032.77 Euro (16,890,470,75 për By-pass-in e Fierit dhe 19,532,562.02 Euro Bypass-in e Vlorës)

Vendimet e gjykatave mbas falimentit të Kompanisë “S.....”

1. Vendimi i Gjykatës së Veronës, date 04/10/2017 ku bëhet njoftimi i Falimentit të S..... dhe caktimin e: a) likuidatorit A M A b) Gjyqtari i çështjes F B dhe c) curatoret ; F V dhe E A.
2. Power of Attorney i është dhënë TEA Srl nga Trustees me date 19/01/2018.
3. Vendimi i Gjykatës së Veronës, date 30/11/2017 (seksioni trete). Pala–Paditëse (A4 H.....) kundër UniCredit, ARRSH, Fallimento S..... CO, lidhur me Performance Guarantee (8,7 Mln Euro). Urdhëron UniCredit të mos paguaj ARRSH për shumën e Garancisë Bankare dhe asnjë shumë tjetër përgatitur nga ARRSH. Data tjetër e Gjyqit është 08/01/2018.
4. Vendimi i Gjykatës së Veronës, date 17/04/2018 (seksioni i trete) për çështjen e A4- H..... kundrejt UniCredit. Vendosi : deklaron të papranueshme kërkesat e ankuesit. Tërheqjen e dekretit të lëshuar (inaudita altera parte) pa dëgjuar palën tjetër, më datë 11/22/2017 dhe kompenson ndërmjet palëve kostot e auditimit.
5. Vendimi i Gjykatës së Trevisos date 16/03/2018, sipas të cilit Fallimento S..... Co..... - Pala Paditese kundrejt ARRSH dhe A4 H..... & UniCredit për sekuestro konsevative deri në

shumen 18,000,000 Euro. Gjykatësja vendos se nuk ekzistojnë arsyet për lëshuar një vendim (pa degjuar palen tjetër). Seanca u shty me date 10/05/2018.

6. Vendimi i Gjykatës se Parmës, date 27/04/2018, sipas te cilit Fallimento S..... Co..... drejtohet kundër ARRSH, A4 H..... dhe Credit Agricoltura Cariparma. vendosi pasi u pa se nuk mund të lëshohej dekreti pa dëgjuar palën tjetër, të hidhej poshtë vendimi i autorizimit të njoftimit të rekursit dhe të këtij dekreti për avokatin që përfaqëson ARRSH në tjetër proces, pasi është e papranueshme. Palët duhet të paraqiten para gjykatës me date 24/05/2018

7. Me vendimin e datës 13 Korrik 2018 gjykata vendosi prishjen e vendimit të datës (27.04.2018), gjyqtari e revokoi atë të mëparshmen vendimin e Gjykatës Dr V..... - (e favorshme për ARA por në thelb për argumente juridiko-procedurale të formuluar nga ky firmë ligjore) - dhe mirëpret, në thelb, Pretendimi i sjellë nga SPA A4 H.....

Konkluzioni

-Sugjerimi Avokaturës së Shtetit për kontratën e By-Pass-it Fier, për të siguruar vetë përfaqësuesin (avokatin) për më tepër duke e orientuar për një avokat italian, nuk është në përputhje me nenin 15/8, 18/1 të Ligjit 10018/2008 dhe nenin 11, 12 të VKM nr. 392/2009, me të njëjtin interpretim si në rastin më sipër (kontrata për By Pass-Vlorë).

-ARRSH ndryshe nga sa ka vepruar për rastin e By-Pass-it të Vlorës me dhënien e prokurës avokatit Italian menjëherë pas sugjerimit të Avokaturës së Shtetit, në këtë rast mban qëndrim tjetër ndaj sugjerimit të saj, duke i vënë në dukje tagrin që ka ajo mbi ekskluzivitetin e përzgjedhjes së avokatit në profesion të lirë.

-Nga ana tjetër Avokatura e Shtetit në sugjerimet e saj mbi përzgjedhjen e avokatit mban qëndrime të ndryshme për 2 kontratat. Në përfaqësimin e çështjes për kontratën e By-Pass-it të Vlorës, ja ka deleguar këtë të drejtë vetë ARRSH-së, duke vepruar në kundërshtim me nenin 15/8 dhe 18 të Ligjit nr.10018, datë 13.11.2008, për më tepër duke i sugjeruar konkretisht avokatin italian Marco Porretti pa negociuar më parë me të për dakordësinë e përfaqësimit dhe vlerën, ndërsa në rastin e çështjes për kontratën e By-Pass-it të Fierit, përveç sugjerimit për ta zgjedhur vetë avokatin/studion avokatore, sugjeron dhe zgjidhje të tjera ligjore sic është LPP.Sugjerimi vjen pasi i është vënë në dukje nga ARRSH-ja, se e drejta ekskluzive e përzgjedhjes së avokatit i takon asaj.

Për pasojë, në dy rastet e kontratave, ARRSH ka dhënë të drejtën e përfaqësimit me prokurë avokatit Italian sipas sugjerimit të ASH, e cila ka anashkaluar procedurat e kontraktimit të avokatëve në profesion të lirë pa negociuar kushtet e përfaqësimit dhe vlerën.

Për pasojë, përzgjedhja e avokatit Italian nuk është miratuar nga Ministri i Drejtësisë, apo nuk i është nënshtruar një procedure të përshpejtuar kontraktimi të miratuar nga Këshilli i Ministrave si rast përjashtimor, meqenëse çështja ka karakter urgjent, duke sjellë efekte negative për buxhetin e shtetit ku deri datë 18.09.2020 datë që përfundoj auditimi, detyrimet financiare të ARRSH-së për shpenzimet e përfaqësimit janë në vlerën 18,811,350 lekë.

Për sa sipër, Avokatura e Shtetit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 15/8 dhe 18/1 të Ligjit 10018/2008 si dhe nenin 11, 12 të VKM nr.392/2009, duke mbajtur qëndrime të ndryshme në sugjerimet e dhëna prej saj, pasi ka deleguar një të drejtë që është tagër ekskluziv i saj. Për pasojë, delegimi i përzgjedhjes së avokatit pa kaluar në procedurën e konkurrimit apo pa ju nënshtruar kontraktimi miratimit nga Këshilli i Ministrave, si rast përjashtimor dhe negociimit pastaj të kushteve të përfaqësimit dhe vlerës meqenëse çështja ka karakter urgjent, sjell efekte negative në buxhetin e shtetit (shpenzime për shërbimin e përfaqësimit para gjykatave të huaja) dhe ngarkon me përgjegjësi Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit.

Si dhe

Veprimet e kryera nga kompania "S....." për llogari të saj, në vendin e origjinës Itali, duke shpallur falimentin pa njoftuar AK kanë sjell bllokimin e garancive me vendim gjykate. Deri në fund të periudhës së audituar 31.12.2021 ARRSH nuk ka akoma një vendim të formës së prerë nga gjykatat italiane.

-Asnjë nga institucionet e sipër cituar nuk ka nisur asnjë procedurë ligjore në zbatim të nenit 20.6 "Arbitrazhi", nen i përcaktuar në kontratat respektive. Në mënyrë eksplicite në këtë nen është përcaktuar se "Çdo mosmarrëveshje midis palëve që buron nga ose në lidhje me kontratën dhe që nuk është zgjidhur në mënyrë miqësore sipas nen klauzolës 20.5, si më sipër dhe në lidhje me të cilën vendimi i BZM-së (nëse ka pasur të tillë) nuk ka qenë i formës së prerë dhe detyrues, mund të zgjidhet nga arbitrazhi".

Kontrata e zbatimit By-Pass-i Fier.

Për zbatimin e punimeve civile është lidhur si fillim kontrata me kompaninë "S..... C....." s.p.a e cila ka falimentuar dhe autoriteti kontraktor ka ndërprerë kontratën më 15.05.2017. Për përfundimin e këtij projekti, zbatimin e punimeve, midis ARRSH dhe kompanisë "C....G....C...."-K..... me nën-kontraktorë kompaninë "A.....B....." shpk është lidhur kontrata nr. 9719 datë 05.11.2018, me vlerë 37,944,221.56 Euro pa TVSH me afat përfundimi të punimeve 455 ditë. Nga urdhër ndryshimet e bëra vlera e kësaj kontrate është rritur me 11,034,718.08 Euro pa TVSH, vlera totale e rishikuar 48,978,939.74 Euro pa TVSH. Për projektin By-Pass i Fierit janë kryer 27 pagesa të ndërmjetme (IPC 'Interim Payment Certificate') me vlerë totale 47,503,960.52 Euro (kjo vlerë përfshin edhe garancinë e mbajtur të punimeve prej 10%).

Tabela Nr.1

Kapitulli	Përshkrimi	Preventivi fillestar (Euro)	Preventivi i rishikuar (Euro)	Realizuar deri në IPC 27 (Euro)	Realizimi %
A	Zërat e përgjithshëm	283,800.00	532,076.83	522,076.83	98
B	Ndërtimi i rrugës kryesore	36,024,955.65	45,738,538.65	44,879,940.32	98.12
C	Rruga lidhëse me Parkun e Apolonisë	1,635,465.92	2,708,324.26	1,937,302.93	71.53
D	V.O 2 (Vlerësim inxhinierik)		164,640.44	164,640.44	100
Totali		37,944,221.57	48,978,939.74	47,503,960.52	97

Kontrata e supervizionit

Supervizionimi dhe konsuleca e këtij projekti kryhet nga kompania BOE "S....." s.r.l & "SWS C.... E....." s.r.l & "T....." s.p.a sipas kontratës fillestare të lidhur më 21.07.2010 me vlerë 858,210 Euro ku nga këto 715,800 Euro vlera origjinale e kontratës dhe 142,410 Euro shtesë e financuar nga kredia e marrë në bankën Mediocredito centrale (MCC s.p.a) Itali. Ndërprerja e kontratës me kontraktorin "S..... Co....." s.p.a për shkak falimentimi, pezullimi i punimeve për shkak të ndryshime të projektit (rishikimi i gjurmës pranë parkut arkeologjik të Apolonisë) si dhe vonesat në procedurën e shpronësimeve kanë sjell nevojën për rishikim të kontratës së supervizionimit. Kësaj kontrate i janë bërë 7(shtatë) ndryshime duke zgjatuar afatin e saj si dhe duke rritur vlerën në 2,894,827 Euro. Financimi i shtesës së kontratës me vlerë 2,022,801 Euro kryhet nga buxheti i shtetit. Konkretisht, ndryshimi i parë (Add.1) afat kohor 01.09.2015 deri 31.12.2016 me kosto shtesë 527,707 Euro ku në të është e përfshirë dhe vlera 142,410 Euro e cila ka qenë fond rezervë në kontratën fillestare; ndryshimi i dytë (Add.2) afat kohor 01.01.2017 deri 31.05.2018 me kosto shtesë 206,000 Euro; ndryshimi tre (Add.3) afat kohor 01.06.2018 deri 31.12.2019 me kosto shtesë 591,810 Euro; ndryshimi katër (Add.4) afat kohor 01.01.2020 deri 31.12.2020 me kosto shtesë 424,460 Euro, ku në këtë ndryshim përfshihen edhe tre muaj për veprimtarinë që do të kryej supervizioni gjatë periudhës së garancisë të punimeve (Defect Liability Period); ndryshimi pesë (Add.5) afat kohor 01.01.2021 deri 31.07.2021 me kosto shtesë 236,150 Euro; ndryshimi gjashtë

(Add.6) afat kohor 01.08.2021 deri 31.12.2021 me kosto shtesë 125,700 Euro dhe ndryshimi shtatë (Add.7) afat kohor 01.01.2022 deri 30.04.2022 me kosto shtesë 67,200 Euro.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se projekti i zbatimit me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Fier” ai fillestar dhe i rishikuar për punimet e mbetura pas ndërprerjes së kontratës fillestare, nuk ka marr miratimin e organeve kompetente (pra është pa leje ndërtimi infrastrukturore dhe leje zhvillimore), në kundërshtim Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 28, pika 1 dhe 2, neni 38 pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 19, pika 1/n, pika 3, neni 25, pika 7, a,b,c, Ligjin nr. 80/2012 datë 13.09.2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI) për projektin “Ndërtimi i by-pass të Fierit”, neni 6.05, pikat d dhe e. Pavarsisht se objekti ka qenë pa leje zhvillimore konstatohet se punimet kanë përfunduar dhe është vendosur në shërbim të komunitetit.

1. Shtesat e kontratave dhe Ndryshimet (VO); arsyt, shkaqet dhe miratimi i tyre.

Kontratës së punimeve civile për ndërtimin e By-Pass-it Fier i janë bërë 8 (tetë) ndryshime duke shtuar vlerën e saj me 11,026,982.38 Euro pa TVSHsi dhe bazuar në këto urdhër ndryshime afati i përfundimit të kontratës është vendosur data 13.03.2022 për kryerjen e plotë të të gjithë komponentëve të kontratës.

Urdhër ndryshimet e bëra konsistojnë si më poshtë ku tabela pasqyron vlerat e tyre të propozuar nga kontraktori dhe vlerat e miratuara nga supervizori dhe punëdhënësi si dhe afatet e ndryshuar për përfundimin e punimeve:

Tabela .nr 2

Nr. VO	Vlera e propozuar nga kontraktori (Euro)	Vlera e miratuar	Vlera e kontratës progresive (Euro)	Zgjatje afati (ditë)
			37,944,221.57	
V.O 1	2,266,220.46	1,868,801.63	39,813,023.20	
V.O 1.1	334,876.83	334,876.83	40,147,900.03	122
V.O 2	(329,280.88)	(164,640.44)	39,983,259.59	
V.O 3	3,324,465.95	3,324,465.95	43,307,725.54	60
V.O 4	1,244,174.20	1,244,174.20	44,551,899.74	15
Për shpronësime				62
VO.5	3,597,100.31	3,597,100.31	48,149,000.05	
Për shpronësime				183
VO.6	73,526.21	73,526.21	48,222,526.26	
VO.7	756,413.25	756,413.25	48,978,939.51	
Për shpronësime				242
VO.8	(7,085.54)	(7,085.54)	48,971,203.88	88
Totali		11,026,982.38	48,971,203.88	(13/03/2022)

Nga auditimi i dokumentacionit të urdhër ndryshimeve u konstatuan:

1. Titulli i gjetjes: Rritje e kostove të projektit.

Situata: Në kontratën me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Fier” është miratuuar me Urdhër Ndryshimin nr.1 (VO.1) kërkesa e punëdhënësit, operim pjesor për trafik. Me letrën Nr. 1871 Prot, datë 25.02.2019, “Operim pjesor për trafik” ARRSH i kërkon supervizorit të udhëzojë kontraktorin të marri masa për rishikimin e grafikut të punimeve që të bëjë të mundur funksionimin e njërën krah të By-Pass-it të Fierit deri në Qershor 2019. Kjo për të evituar trafikun gjatë sezonit turistik. Gjithashtu nga ana e punëdhënësit, në këtë letër, kërkohet që kontraktori të përgatisë një plan për menaxhimin e trafikut. Referuar nën-klauzolës 3.3 “Udhëzimet e inxhinierit” (Instructions

of the Engineer) me letrën Prot.AL/FI-LE/048/19 datë 26.02.2019 ka urdhëruar kontraktorin të marri masa për këto ndryshime në përputhje me nën-klauzolën 13.3 “*Procedurat e ndryshimit*” (*Variation Procedure*). Kontraktori me letrën A-59 datë 12.03.2019 “*Operim pjesor për trafik*” krahas miratimeve që kërkohen për materiale në pikën 3, “*Kosto shtesë për përfundimin e kontratës në prezencë trafiku*”, thekson se operimi pjesor i trafikut do të ketë efekte në aktivitet e mbetura të kontraktorit për përfundimin e kontratës. Gjithashtu, kontraktori thekson se, zona e punimit do të jetë e reduktuar, pjesë të aktivitetit duhet të modifikohen dhe do të kërkohen masa për mirëmbajtjen e rrugës. Në VO. 1 është miratuar edhe zëri “*Plani i menaxhimit të trafikut*” me kosto totale 297,868.20 Euro i cili ka ardhur si rezultat i kërkesës së ARRSH Nr. 1871 Prot, datë 25.02.2019, “*Operim pjesor për trafik*”. Zëri, “*Plani i menaxhimit të trafikut*” nuk është në funksion ose i lidhur me zërat e tjerë të parashikuar në kontratën e lidhur midis ARRSH dhe “*C....G....C....*”-K....., nr. 9719 datë 05.11.2018 si dhe në marrëveshjen financiare të ratifikuar me ligjin nr. 80/2012 datë 13.09.2012. ARRSH me letrën Nr. 3711/1 datë 12.06.2019 ka njoftuar miratimin e VO.1 në parim sipas Vendim të Këshillit Teknik Nr.19, datë. 10/06/2019, si dhe miratimi (no-objection) nga BERZH është më datë 12.11.2019. Referuar punimeve shtesë, që do të kryhen sipas ndryshimeve të miratuara në VO. 1, me VO. 1.1 është miratuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve me 122 ditë, me kosto totale shtesë 334,876.83 Euro ku nga këto 67 ditë shtohen si rezultat i miratimit të zërit “*Plani i menaxhimit të trafikut*”. Për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 67 ditë si rezultat i kërkesës së ARRSH-së për “*Operim pjesor për trafik*” ka kosto shtesë në vlerë 244,476.33 Euro. Pra, për sa më sipër, vlera e projektit nga kërkesa e punëdhënësit, për “*Operim pjesor për trafik*”, është rritur në total me (297,868.20 Euro+244,476.33 Euro) 542,344.53 Euro pa TVSH.

-Në urdhër ndryshimin nr.4 VO.4 është miratuar edhe kërkesa e Bashkisë Fier me Nr. 9363 Prot. datë 13.11.2019 për rehabilitimi e rrugës hyrëse në perëndim të Fierit me vlerë totale 116,640 Euro. Nga ana e ARRSH-së rehabilitimi i rrugës hyrëse me fondet e projektit është bërë me Vendimin e Këshillit Teknik Nr.36 datë 20.07.2020 si dhe miratimi (no-objection) nga BERZH është më datë 08.09.2020. Bashkia Fier si pronare e rrugës duhet ta riparonte atë me financime të tjera pa u prekur fondet e projektit pasi në asnjë pikë të specifikimeve të projektit nuk përcaktohet rehabilitimi i rrugëve dytësore (lidhëse) me rrugën në ndërtim. Pra, për sa më sipër, vlera e projektit nga kërkesa e Bashkisë Fier, për rehabilitimin e rrugës hyrëse, është rritur me 116,640 Euro pa TVSH. Pra në total vlera e rritur e projektit është 658,984.53 Euro e cila konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet i fondeve të projektit.

Kriteri: Ligji nr. 80/2012 datë 13.09.2012 “*Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)*” neni 6, pika 6.02 ‘Përmbushja e projektit’, “*Huamarrësi do të sigurojë që Livruesi ta kryejë projektin në përputhje me përshkrimin teknik që mund të ndryshohet herë pas here me aprovimin e Bankës dhe ta përfundojë atë në datën përfundimtare të përcaktuar*”.

Kontrata e zbatimit të punimeve nr. 9719 prot. datë 05.11.2018.

Ndikimi/Efekti: Rritje e koston së projektit, e pa parashikuar në kontratë me pasojë përdorimin pa EEE në vlerën 658,984.53 Euro pa TVSH.

Shkaku: Miratim i zërave dhe volum punimesh të pa parashikuar në kontratën fillestare dhe në marrëveshjen financiare.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: ARRSH të marri masa që në të ardhmen, për Projektet në proces dhe të reja, të mos miratojë ndryshime, që nuk janë të lidhura me zbatimin teknik të punimeve dhe të pa parashikuar në objektivat e financimit, që risin koston e tyre.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi ish Drejtoresha e ARRSH znj. S Q , Drejtori z. E V, anëtarët e Këshillit Teknik për Vendimin nr. 19, datë 10.06.2019 dhe anëtarët e Këshillit Teknik Nr. 36, datë 20.07.2020 znj. E G, znj. A L, z. S T, znj. I H, z. E S, z. S P, z. E E, Z. E K, z. G G, znj. A H i dhe Z. V H .

2. Auditimi me zgjedhje mbi verifikimin e zbatimit të punimeve civile.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht dosjen teknike të projektit të zbatimit si dhe verifikimit në terren, i disa zërave të punimeve, në prezencë të audituesve shtetërorë të KLSH dhe përfaqësuesit të supervisorit u konstatuan diferenca në volume të situacionuara por të pakryera në fakt në vlerën **8,348.38 Euro pa TVSH.**

2. Titulli i gjetjes: Punime të situacionuara dhe të likuiduara por të pakryera në fakt.

Situata: Për objektin **“Ndërtimi i By-Pass-it Fier”**, midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe OE “C....G....C....”-Kuvajt është lidhur kontrata nr. 9719 datë 05.11.2018, me vlerë 37,944,221.56 Euro pa TVSH me afat përfundimi të punimeve 455 ditë, realizimi i punimeve civile deri në fund të periudhës së audituar është në masën 99%. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e punimeve pjesore, konkretisht:

- *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built);*
- *Pagesat pjesore nga IPC nr. 1 deri tek IPC nr. 27;*
- *Fletët e Matjes (Measurement Sheets);*
- *Praktikat e Urdhër Ndryshimeve (Variation Order) nga VO nr. 1 deri tek VO nr. 8;*
- *Etj.*

- *Korrespondencat mes Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), Konsulentit dhe Kontraktorit të punimeve;*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Përfaqësuesit të ARRSH-së rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm (IPC nr. 27) volume pune të pasqyruara në librezat e masave dhe të situacionuara por të pakryera në fakt (Measurement Sheets). Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kodi i Preventivit	Emërtimi i Zërit	Vlera (Euro) pa TVSH
1	08.01.03	FV pemë të llojit Qeparis dhe Tilia (për lëndën drusore për suport sipas analizës së çmimit)	3,941.34
2	08.01.01	Vendosja e shtresës vegetale në skarpata me trashësi 300mm duke përfshirë dhe vaditjen për të siguruar rritjen e shëndetshme të barit, ku udhëzohet nga inxhinieri dhe sipas klauzolës 9.1 të ST	1,783.65
3	02.02.02	Gërmim i zakonshëm përfshirë transportin final sipas klauzolës 4.5 të ST.	2,623.39
SHUMA			8,348.38

Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara në Aneksin 2.5.1

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”

- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, ku përcaktohet se:

Pika 8.1: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”

- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet

se: "3.2 Librezja e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 21.07.2010 mes ARRSH dhe BOE "S....." s.r.l & "SWS C..... E....." s.r.l & "T....." s.p.a", e ndryshuar.

Artikulli 1.3 "Shërbimet" tek Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Klauzola 1.3.3 "Monitorimi i Progresit të Punimeve" ku thuhet; "Supervizori do të monitorojë në mënyrë efektive progresin e punimeve nëpërmjet grafikut të punimeve në çdo fund muaji, dhe verifikon ndryshimet në përputhje me programin e miratuar. Supervizori rivefikon, në mënyrë të përmuajshme, edhe ndryshimet metrike të llogaritura fillimisht dhe të atyre të ndryshuara, dhe llogarit ndryshimet e buxhetit të nevojshëm për të përfunduar punimet".

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 8,348.38 Euro pa TVSH..

Shkaku: Certifikimi nga ana e Supervizorit i volumeve të punimeve të pakryera në fakt nga ana e sipërmarrësit.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Nga ana e ARrSh të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës 8,348.38 Euro pa TVSH ndaj sipërmarrësit OE "C...G...C..."-Kuvajt, për punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr. 9719 datë 05.11.2018 me objekt "Ndërtimi i By-Pass-it Fier".

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi Konsulentit BOE "S....." s.r.l & "SWS C..... E....." s.r.l & "T....." s.p.a", Inxhinieri rezident z. F R .

Kontrata e zbatimit By-Pass-i Vlorës

Për zbatimin e kontratës së punimeve është lidhur si fillim kontrata me kompaninë "S..... Costruzioni" s.p.a e cila ka falimentuar dhe autoriteti kontraktor ka ndërprerë kontratën më 15.05.2017. Për përfundimin e këtij projekti, zbatimin e punimeve, ARRSH ka lidhur kontratën nr. 9946 datë 08.11.2018 me J.V. "G....." Shpk & "I... C..... Ing. E. M....." me vlerë **35,874,357.4 Euro** pa TVSH me afat përfundimtar të punimeve 823 ditë (22 Shkurt 2021 dhe afat te shtyre deri me 30 Qershor 2022). Nga urdhër ndryshimet e bëra kësaj kontrate vlera e saj e rishikuar është rritur me **13,208,539Euro** ose vlerë totale të rishikuar **49,082,896.67 Euro** pa TVSH. Për projektin By-Pass i Vlorës janë kryer 13 pagesa të ndërmjetme IPC me vlerë totale **39,057,877 Euro** (kjo vlerë përfshin edhe garancinë e mbajtur të punimeve prej 10%).

Tabela nr. 1

Kapitulli	Përshkrimi	Preventivi fillestar (Euro)	Preventivi rishikuar (Euro)	Puna e kryer deri ne IPC 13 (Euro)	Realizimi
Nr.100	Kërkesa të përgjithshme	1,809,114.88	2,409,340.67	1,901,420.35	78.92%
Nr.200	Prishje dhe pastrime të kantierit	80,347.43	100,190.47	38,116.62	47.44%
Nr.400	Barrierat e sigurisë	959,904.00	1190,183.80	1,065,600	100.42 %
Nr.500	Kanalet dhe Drenazhet	2,026,893.86	3,052,539.87	1,974,457.35	93.58%

Nr.600	Punimet e dherave	12,119,184.53	16,757,685.01	14,426,531.47	88.66 %
Nr.700	Punimet e shtresave	8,876,257.99	9,620,629.41	5,952,271.73	64.88 %
Nr.800	Bordura, trotuare, sipërfaqe të shtruara	79,220.82	139,291.28	26,132.50	27.94 %
Nr.900	Punime sinjalistikë	160,927.5	265,459.43	102,958.1	63.51 %
Nr.1300	Ura dhe betone, mure mbajtës	6,913,766.35	11,605,917.85	9,828,219.83	91.45 %
Nr.1700	Përforcime të tokës, muret mbajtës	2,469,540.05	3,892,031.95	3,386,422.18	89.45 %
Nr.1800	Rreth rrotullimet	303,360.00	343,260.00	242,688.00	80.00 %
Nr.1900	Punimet e ndriçimit	75,840.00	111,112.40	86,976.00	114.68%
	Vlerësim inxhinierik		35,739.55		
TOTALI		35,874,357.40	49,523,381.69	39,031,794.13	84.35 %

Kontrata e supervizionit

Supervizionimi dhe konsuleca e këtij projekti kryhet nga kompania BOE "E..... O..... S.A & P..... S.A" sipas kontratës fillestare të lidhur më 22.11.2013 me vlerë **1,663,300 Euro**. Pezullimi i punimeve me arsyen e ndërprerjes së kontratës me kontraktorin "S..... C....." s.p.a për shkak falimentimi kësaj kontrate supervizionimi i janë bërë 6(gjashtë) ndryshime duke zgjatur afatin e saj si dhe duke rritur vlerën në **3,858,500Euro**. Ndryshimet e bëra nr.1 deri nr.4 janë për ndryshimin e stafit dhe ndryshimi nr. 5 datë 12.11.2018, përfshin rritjen e vlerës së kontratës dhe zgjatje të afatit deri më 30.11.2021 dhe ndryshimi nr. 6 datë 14.09.2021, përfshin rritjen e vlerës së kontratës dhe zgjatje të afatit deri më 15.10.2023. Kontrata e supervizionit financohet nga fondet e Delegacionit Evropian (Grant) dhe pjesërisht nga Kosto Lokale (Addendum 6).

1. Afatet e realizimit të punimeve.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se punimet kanë filluar më datën 22.11.2018 me afat përfundimi 823 ditë, ose 22 Shkurt 2021. Deri në fund të periudhës audituese 31.12.2021 punimet nuk kanë përfunduar dhe afati i përfundimit të tyre nuk është ndryshuar pasi kërkesa e kontraktorit është akoma në vlerësim nga ana e supervisorit dhe parashikimi është të përfundojnë në Qershor 2022. Progresi për By-Pass-in Vlorë, deri në fund të periudhës audituese, 31.12.2021, në volume punimesh është realizuar afërsisht në masën 85%, progresi financiar në masën 84.35% (në këtë vlerë është e përfshirë dhe pjesa 10% e mbajtur për garancinë e punimeve). Për sa më sipër, ndryshimet e vazhdueshme për shkak të kushteve të terrenit si dhe vonesat në procesin e shpronësimeve, për pasuritë që preken nga projekti, nga ARRSH dhe instancat e tjera të Shtetit Shqiptar ka sjellë mosrealizimin e punimeve sipas programit të përcaktuar.

2. Shtesat e kontratës dhe Ndryshimet (VO); arsyet, shkaqet dhe miratimi i tyre.

Kontratës së punimeve civile për ndërtimin e By-Pass-it Vlorë i janë bërë 26 (njëzet e gjashtë) ndryshime me vlerë totale **13,208,539 Euro**. Afati i përfundimit të punimeve civile është ndryshuar deri me 30 Qershor 2022.

Urdhër ndryshimet e bëra konsistojnë si më poshtë ku tabela pasqyron vlerat e tyre të propozuar nga kontraktori dhe vlerat e miratuara nga supervisorin dhe punëdhënësi:

Tabela nr. 2

Nr. VO	Vlera e propozuar nga kontraktorit nga (Euro)	Vlera e miratuar (Euro)	Vlera progresive kontratës (Euro)
			35,874,357.40
VO. 1	35,511	20,000	35,894,357.40
VO. 2	1,359,200	208,800	36,103,157.40
VO. 3	375,000	161,000	36,264,157.40
VO. 4	214,000	214,000	36,478,157.40
VO. 5	15,652.79	16,000	36,494,157.40
VO. 6	329,087	317,000	36,811,157.40
VO. 7	3,747,090	526,000	37,337,157.40
VO. 8	46,763	25,000	37,362,157.40
VO. 9	(71,479.10)	(35,739.55)	37,326,417.85

VO. 10	1,210,023	815,000	38,141,417.85
VO.11	403,083.78	403,083.78	38,544,501.63
VO.12	165,235	165,235	38,709,736.63
VO.13	1,108,980	1,108,980	39,818,716.63
VO.14	282,823.31	282,823.31	40,101,539.94
VO.15	639,323	639,323	40,740,862.94
VO.16	643,305.59	417,601	41,158,463.94
VO.17	3,697,493	3,463,316.55	44,621,780.49
VO.18	1,454,769	1,162,471.11	45,784,251.60
VO.19	232,360	174,000	45,958,251.60
VO.20	197,142	197,142	46,155,393.60
VO.21	155,076.3	155,076.3	46,310,469.90
VO.22	718,900	694,240.9	47,004,710.80
VO.23	821,943.47	821,943.47	47,826,654.27
VO.24	500,242.4	500,242.4	48,326,896.67
VO.25	1,230,336	756,000	49,082,896.67
VO.26	1,000,000	440,485.01	49,523,381.68
Totali	19,511,861	13,208,539	49,523,381.68

Nga auditimi i dokumentacionit të urdhër ndryshimeve u konstatuan:

3. Titulli i gjetjes: Vonesa në miratimin e urdhër ndryshimeve (VO) nga ana e punëdhënësit.

Situata: Në kontratën me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Vlorë”, për periudhën objekt auditimi u konstatuan se, nga ana e punëdhënësit janë miratuar 26 (njëzetë e gjashtë) Urdhër Ndryshime por në disa prej tyre ka patuar vonesa në miratimin e tyre të cilat ndikojnë në realizimin e projektit në kohë dhe me cilësi. Konkretisht, urdhër ndryshimi nr.2 (VO.2) miratuar nga supervizori, Nr. 1174 datë 02.04.2020 është miratuar afërsisht pas 5 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr.51, datë. 25.11.2019, urdhër ndryshimi nr.6(VO.6) miratuar nga supervizori, Nr. 1031 datë 13.02.2020 është miratuar afërsisht pas 4 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr.28, datë 03.06.2020, urdhër ndryshimi nr.8 (VO.8) miratuar nga supervizori Nr.1174 datë 02.04.2020 është miratuar afërsisht pas 2 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr. 28, datë 03.06.2020, urdhër ndryshimi nr.10 (VO.10) miratuar nga supervizori Nr. 1266 datë 30.04.202 është miratuar afërsisht pas 1,5 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr. 28, datë 03.06.2020. Për sa më sipër, vonesat në miratimin e urdhër ndryshimeve nga ana e Këshillit Teknik, ndikojnë në realizimin e punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

Kriteri: Ligji nr. 80/2012 datë 13.09.2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)” neni 6, pika 6.02 “Përmbushja e projektit”, “Huamarrësi do të sigurojë që Livruesi ta kryejë projektin në përputhje me përshkriminteknik që mund të ndryshohet herë pas here me aprovimin e Bankës dhe **ta përfundojë atë në datën përfundimtare të përcaktuar**”.

Kontrata e zbatimit të punimeve nr. 9719 prot. datë 05.11.2018. “Kushte të Përgjithshme të Kontratës” nën klauzola 1.1.3.3 “Koha e përfundimit” (Time for Completion)

Ndikimi/Efekti: Mos realizim i punimeve sipas afateve të parashikuara në kontratë.

Shkaku: Vonesa në miratimin e urdhër ndryshimeve nga punëdhënësi.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: ARRSH të marri masa për shmangen e vonesave në miratimin e urdhër ndryshimeve duke përcaktuar afate kohore për miratimin e tyre nga të gjitha shkallët dhe ana e Këshillit Teknik në një kohë sa më optimale, për realizimin e projekteve sipas afateve të përcaktuara në kontratat e tyre.

4. Titulli i gjetjes: Rritje e kostos së projektit.

Situata: ARRSH me Nr.5349/1, datë 08.06.2021 ka përcjellë te Supervizori kërkesa e Policisë së Shtetit Nr.1097/8, datë 02.06.2021 në të cilën kërkohet mbështetja e MIE dhe ARRSH për

përdorimin e aksit të By-Pass-it të Vlorës gjatë sezonit turistik Korrik-Shtator 2021. Supervizori bazuar në klauzolën 13.3 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, “*Procedurat e ndryshimit*” (*Variation Procedure*), me shkresën Nr.2206, datë 10 Qershor 2021 instruktioi Kontraktorin të prezantojë një propozim gjithëpërfshirës me synimin që Supervizori të bëjë vlerësimin e kushteve nën të cilat mund të përdoret gjurma e By-Pass-it për kalimin e trafikut gjatë sezonit veror. Vlerësimi i kontraktorit për punime shtesë, për hapjen e trafikut gjatë sezonit turistik, është 1,000,000 Euro ku në të përfshihen dhe punime përfundimtare të cilat janë pjesë e kontratës. Duke zbritur këto punime përfundimtare vlera e koston shtesë është afërsisht 700,000 Euro. Pas vlerësimit të propozimit të kontraktorit për hapjen e trafikut gjatë sezonit turistik në By-Pass-in e Vlorës supervizori ka paraqitur për miratim këtë urdhër ndryshim me vlerë 440,485.01 Euro tek punëdhënësi pasi vlera e saj e kalon 1% të vlerës së kontratës. Autoriteti Kontraktor (ARRSh) me Vendimin e Këshillit Teknik Nr. 24 datë 08.07.2021 ka miratuar në parim planin e menaxhimit të trafikut, sinjalistikën vertikale provizore si dhe masat e sigurisë duke vlerësuar një kosto përfundimtare pas vlerësimit dhe saktësimit të volume të punimeve shtesë për hapjen e trafikut. Hapja e trafikut ka sjell reduktimin e punimeve të kontraktorit e cila sipas tij do të kërkojë një shtyrje afati prej 77 ditë të përfundimit të kontratës e për rrjedhojë do të shoqërohet me kosto shtesë për zërat e përgjithshëm të saj (garancia e punimeve, menaxhimi i projektit etj.) si dhe kosto shtesë për supervizionimin e punimeve. Vlera prej **440,485.01 Euro pa TVSH** e miratuar për hapjen e trafikut gjatë sezonit veror, përbën rritje të koston së projektin e By-Pass-it Vlorë dhe nga grupi i auditimit konsiderohet **shpenzim i fondeve të projektit pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.**

Kriteri: Ligji nr. 109/2014 datë 31.07.2014 “*Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By Pass-in e Vlorës*” neni 6, pika 6.02 ‘Përmbushja e projektit’, “*Huamarrësi do të sigurojë që Livruesi ta kryejë projektin në përputhje me përshkrimin teknik që mund të ndryshohet herë pas here me aprovimin e Bankës dhe ta përfundojë atë në datën përfundimtare të përcaktuar*”, si dhe kontratën e zbatimit të punimeve nr. 9946 prot. datë 08.11.2018, ku kjo hapje nuk është e parashikuar as në përshkrimin teknik dhe as në kushtet e kontratës.

Ndikimi/Efekti: Rritje e koston së projektit, të pa parashikuar në kontratë, në vlerën 440,485.01 Euro pa TVSH.

Shkaku: Miratim i zërave dhe volum punimesh të pa parashikuar në kontratën fillestare dhe në marrëveshjen financiare.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: ARrSh të marri masa që në të ardhmen, për Projektet në proces dhe të reja, të mos miratojë ndryshime, që nuk janë të lidhura me zbatimin teknik të punimeve dhe të pa parashikuar në objektivat e financimit, që risin koston e tyre.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. E B, z. E E, z. G G, znj. A L, znj. A S, z. E S, si antarë të Këshillit Teknik për Vendimin nr.24, datë 08.07.2021.

3. Auditimi me zgjedhje mbi verifikimin e zbatimit të punimeve civile.

Mbi auditimin e kësaj pike u përzgjedh zbatimi i punimeve civile të kryera deri në përfundim të periudhës audituese 31.08.2020.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht dosjen teknike të projektit të zbatimit si dhe verifikimet në terren, në prezencë të audituesve shtetërorë të KLSH dhe përfaqësuesit të ARRSH, u konstatuan diferenca në volume të situacionuara dhe të likuiduara më tepër në vlerën **59,904 Euro pa TVSH.**

5. Titulli i gjetjes: Punime të situacionuara dhe të likuiduara por të pakryera në fakt.

Situata: Për objektin **“Ndërtimi i By-Pass-it Vlorë”**, midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSh) dhe BOE “G.....” Shpk & “I..... C.... Ing. E. M....” është lidhur kontrata nr. 9946 datë 08.11.2018 me vlerë 35,874,357.4 Euro pa TVSH me afat përfundimtar të punimeve 823 ditë, realizimi i punimeve civile deri në fund të periudhës së audituar është në masën 92%. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e punimeve pjesore, konkretisht:

- *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built);*
- *Pagesat pjesore nga IPC nr. 1 deri tek IPC nr. 13;*
- *Fletët e Matjes (Measurement Sheets);*
- *Praktikat e Urdhër Ndryshimeve (Variation Order) nga VO nr. 1 deri tek VO nr. 26;*
- *Etj.*

- *Korrespondencat mes Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), Konsulentit dhe Kontraktorit të punimeve;*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Përfaqësuesit të ARRSH-së rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm (IPC nr. 13) volume pune të pasqyruara në librezat e masave (Measurement Sheets) dhe të situacionuara por të pakryera në fakt. Këto diferencë rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kodi i Preventivit	Emërtimi i Zërit	Vlera (Euro pa TVSH)
1	403	Barierat mbrojtëse tipi H3” (Safety barrier type H3)	46,080
2	401	Barierat mbrojtëse tipi H2” (Safety barrier type H2)	13,824
SHUMA			59,904

Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara në Aneksin 2.5.2.

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: *“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”*

- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, ku përcaktohet se:

Pika 8.1: *“Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”*

- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se: 3.2 *Libreza e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

3.3 *Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 22.11.2013 mes ARRSH dhe BOE “E..... O..... S.A & P..... S.A”, e ndryshuar.

• Kreu, “Detyrimet e kontraktuesit” shtojca 1 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, neni 7, “Detyrime të Përgjithshme”, pika 7.4 ku thuhet, “Kontraktuesi do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi në vendin përfitues dhe do të sigurojë që personeli i tij, vartësit e tyre dhe punonjësit e tij lokal gjithashtu të respektojnë të gjitha ligjet dhe rregulloret e tilla. Kontraktuesi do të dëmshpërblejë Autoritetin Kontraktues kundër çdo pretendimi dhe procedimi që rrjedh nga ndonjë shkelje nga Kontraktuesi, punonjësit e tij dhe vartësit e tyre nga ligjet dhe rregulloret e tilla”. Shtesa e kontratës Nr. 5 datë 12.11.2018 artikulli 4, “Qëllimi i punimeve” “Scope of Work” pika 4.2.2, “Detyrat gjatë fazës së ndërtimit” “Task during Construction Phase”

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 59,904 Euro pa TVSH deri në këtë fazë të projektit.

Shkaku: Certifikimi nga ana e Supervizorit i volumeve të punimeve të pakryera në fakt nga ana e sipërmarrësit.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: ARrSh dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa për reflektimin e volumeve të punimeve të situacionuara por të pa kryera në fakt, në situacionin pasardhës deri në atë përfundimtar në vlerën 59,904 Euro pa TVSH e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit deri në këtë fazë të projektit, të përfituara më tepër nga sipërmarrësi i punimeve sipas kontratës nr. 9946 datë 08.11.2018. Në rast se këto reflektime nuk kryhen deri në situacioni përfundimtar ana e ARrSh të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Konsulentit BOE “E..... O..... S.A & P..... S.A” Inxhinier Rezident z. D..... T..... dhe zv. Inxhinier Rezident A..... S.....

2.6 Mbi administrimin e veprave të përfunduara.

1. Për punimet e realizuara në këtë fazë për “By-pass-in e Fierit” (deri më datën 31.12.2021), OE “C....G....C....ing Co” së bashku me Supervizorin e Punimeve J.V. “S.....-Tecnic-SËS” ka përcjell tek Autoriteti Kontraktor (ARRSH) situacionin e punimeve IPC nr. 27, datë 31.11.2021, në vlerën 388,749.26 Euro protokolluar në ARRSH me shkresën nr. 11319 prot., datë 14.12.2021, (e fundit për periudhën e audituar).

1.1. “Rruga kryesore”: Deri më datën 31.12.2021, ky segment ka përfunduar duke u bazuar në Certifikatën Përfundimtare të Punimeve të datës 15.06.2020, të lëshuar nga Supervizori i Punimeve J.V. “S.....-T.....-SWS”. Marrja në dorëzim si aset nga ARRSH është kryer nëpërmjet procesverbalit të datës 19.07.2021, me objekt “Mbi marrjen përfundimtare në dorëzim të punimeve të kontratës “Ndërtimi i Segmentit Rrugor by-pass-i Fierit (Aksi kryesor)”, i mbajtur ndërmjet Komisionit të Marrjes në Dorëzim i ngritur në zbatim të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së me shkresën nr. 7259/1 prot., datë 20.11.2014.

1.2. “Rrugët sekondare”: Nga Supervizori i Punimeve nga Mbikëqyrësi i Punimeve J.V. “S.....-T.....-SWS” është lëshuar Certifikata e Përkohshme e Punimeve e datës 22.02.2021. Aktualisht (deri më datën 31.12.2021), ky segment është në periudhën e garancisë.

1.3. “Rruga lidhëse e Apolonisë”: Deri më datën 31.12.2021, ky segment është në proces zbatimi punimesh.

2. Për punimet e realizuara në këtë fazë për “By-pass-in e Vlorës” (deri më datën 31.12.2021), J.V. “G.....” SHPK & “I..... C..... ING M.....” S.P.A së bashku me Supervizorin e Punimeve “E..... O.....” A.E ka përcjell tek Autoriteti Kontraktor (ARRSH) situacionin e punimeve IPC e

nr. 13, datë 30.09.2021, në vlerën 6,931,706.89 Euro protokolluar në ARRSH me shkresën nr. 11259 prot., datë 13.12.2021, (e fundit për periudhën e audituar).

Deri më datën 31.12.2021, ky segment është në proces zbatimi punimesh.

Bazuar në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2008, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi deri më datë 31.12.2021, datë e cila përkon me fundin e vitit ushtrimor 2021, konstatohet si më poshtë.

1. Titulli i gjetjes: Nuk është kryer regjistrimi si aset në regjistrat e kontabilitet me veprim ekstra kontabël në momentin e marrjes në dorëzim të "Aksit Kryesor të by-pass-it të Fierit".

Situata: Marrja në dorëzim e aksit kryesortë "By-pass-it të Fierit" nga Autoriteti rrugor Shqiptar është kryer nëpërmjet procesverbalit të datës 19.07.2021, i mbajtur ndërmjet Komisionit të Marrjes në Dorëzim i ngritur në zbatim të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së me shkresën nr. 7259/1 prot., datë 20.11.2014, dhe OE "C...G...C...ing Co" së bashku me Supervizorin e Punimeve J.V "S.....-T....-SWS". Deri më datë 31.12.2021, datë e cila përkon me fundin e vitit ushtrimor 2021, nga ARRSH nuk është bërë regjistrimi si aset të "Rrugës kryesore të by-pass-it të Fierit" në regjistrat e kontabilitet me veprim ekstra kontabël në momentin e marrjes në dorëzim referuar procesverbalit të datë 19.07.2021, dhe duke u bazuar në këtë regjistrim fillestar të kryhet regjistrimi përfundimtar në pasqyrat financiare të vitit 2021. Gjithashtu ky regjistrim nuk është kryer as në program financiar në kushtet kur nga ARRSH nuk disponohet program financiar për mbajtjen e kontabilitetit. Regjistrimi si aset është i domosdoshëm që nga momenti në të cilën fillon jetën e dobishme aktivi si dhe llogaritja e amortizimit që nga momenti vendosjes në funksion (vlerë e cila mund të përlllogaritet deri në mbylljen e pasqyrave financiare). Ky regjistrim është kryer në muajin mars periudhë në të cilën përfundon afati për mbylljen e pasqyrave financiare për vitin 2021, të cilat janë depozituar pranë MIE dhe MFE me shkresën nr. 4094 prot., datë 29.03.2022.

Kriteri: Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 2, dhe Standardi Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale", pika 10.

2. Klasa 2: "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël),

Klasa 2 e llogarive të kontabilitetit në sektorin publik përbëhet nga:

- *Aktive afatgjata materiale (aktive të qëndrueshme të trupëzuara);*

Aktivet afatgjata materiale të sektorit publik përkufizohen si elemente të aktivitet (pasurisë) që:

- *Kanë substancë ose formë fizike. (Ato janë sende ose objekte konkrete të cilat mund të preken, shihen, maten e numërohen fizikisht).*
- *Kohëzgjatja e përdorimit parashikohet e llogaritet për më shumë se një vit ushtrimor kontabël.*
- *Destinacioni është për t'u përdorur në prodhimin, furnizimin e marrjen e sendeve ose shërbimeve, për t'ua dhënë më qira të tretëve dhe për qëllime administrative.*

Hyrjet e AAGJM-së dokumentohen:

- *Për blerjet, ku si dokumente shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletëhyrja (nëse janë aktive të magazinueshme).*
- *Për hyrjet në cilësinë e kontributeve në natyrë të kapitalit/fondeve, ku si dokument shërben aktmarrëveshja dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitet.*
- *Për përfitimet nga dhurime, ku si dokument është akti i dhurimit dhe akti i marrjes në dorëzim.*
- *Për prodhimin nga vetë njësia, ku si dokument shërben situacioni përfundimtar dhe akti i marrjes në dorëzim.*
- *Për rivlerësimet, shërbejnë aktet ligjore ose nënligjore që autorizojnë një gjë të tillë dhe pasqyrat përkatëse të llogaritjeve.*

Aktivet afatgjata dallohen në tri grupe kryesore:

- Llogaria 20, “Aktive afatgjata jomateriale”;
- Llogaria 21, “Aktive afatgjata materiale”;
- Llogaritë 25 dhe 26, “Aktive afatgjata financiare”.

Llogaria 231, “Investime për aktive afatgjata materiale”, të analizuara në llogari shtatëshifrore. Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara.

Nga pikëpamja e përbërjes dhe e klasifikimit, të grupuara në nivele dyshifrore, aktivet afatgjata në të gjitha format, klasifikohen:

- 20, “Aktive afatgjata jomateriale”;
- 21, “Aktive afatgjata materiale”;

d) Për kapitalizimin e aktivit (kur vihet në funksionim) bëhet hyrje:

- Debitohet 21, “Aktive afatgjata materiale”;

Si dhe,

Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale”:

Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale

Njohja dhe vlerësimi fillestar

Njohja fillestare

10. Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet në bilanc vetëm nëse:

- Ky aktiv kontrollohet nga njësi ekonomike raportuese;
- Është e mundur që, përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivit do të hyjnë në njësinë ekonomike raportuese;
- Kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri;

Regjistrimi fillestar i aktiveve afatgjata materiale (AAM) bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi.

Ndikimi/Efekti: Mos përlogaritje e amortizimit të asetit nga momenti i marrjes në dorëzim.

Shkaku: Kjo situatë vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: ARRSH/Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrë masa që, të kryej regjistrimin e aseteve të përfunduara të Projektit në regjistrat e kontabilitetit me veprim ekstra kontabël në momentin e marrjes së dorëzimit prej saj me qëllim përlogaritjen e amortizimit në momentin në të cilën fillon jetën e dobishme aktivi dhe më pas të kryhet regjistrimi në pasqyrat financiare sipas vitit ushtrimor përkatës.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Sipas nenit 2 të Marrëveshjes data e fundit e disponueshërisë së kredisë është 30.04.2015. Nga auditimi rezulton se me shkresën nr.9280/1.prot, date 23/06/2015 Ministri i Financave i ka kërkuar përfaqësuesit të BERZH shtyrja e afatit të kredisë deri në 2017 me argumentin se sipas marrëveshjes, Data e Fundit e Disponueshmërisë së Transhit A të Huasë, është data 30 prill 2015. Fillimi i zbatimit të pjesës së projektit që lidhet me ndërtimin e Bypass – it të Fierit, pjesë e cila financohet nëpërmjet Transhit A të Huas, ka hasur vonesa të ndryshme. Për rrjedhojë kontrata përkatëse e punimeve e lidhur në muajin Maj 2013 përfundon në muajin Shkurt 2017 (*duke përfshirë edhe periudhën e garancisë së defekteve*). Mbështetur në sa më sipër Ministri i Financave ka kërkuar shtyrjen e Datës së Fundit të Disponueshmërisë së Transhit A të Huas deri në 30 prill 2017.

Deri në përfundim të auditimit nuk u paraqit ndonjë dokument që vërteton se kur është aprovuar shtyrja e afatit nga BERZH. Nga ana e ARRSH dhe Ministrisë së Financave nuk janë marrë masat e nevojshme për zgjatjen e afatit të disbursimit të projektit në kohë duke vendosur në pasigurinë e vazhdimin të disbursimit.

- **Me** Amendamentin Nr.1, datë 14.02.2019, e cila është përcjell me shkresë nr. 149/5, datë 11.07.2019, është miratuar afati i fundit për kryerjen e disbursimeve për transhin A të marrëveshjes së huasë datën 31 Janar 2021. *Nga auditimi konstatohet se ka një periudhë prej 21 muajsh pa marrë miratimin e shtyrjes së disbursimeve.*

ARRSH ka një korrespondencë të vazhdueshme me Ministrinë ku ka kërkuar kryerjen e procedurave për zgjatjen e afatit të disbursimeve por referuar amendamentit, Ministria e ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të disbursimeve në 26.12.2018 (*19 muaj më vonë nga kërkesa e parë e ARRSH*) në kundërshtim me Ligjin e Marrëveshjes.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur asnjë kërkesë për disbursime dhe nuk është kryer asnjë disbursim nga ARRSH pasi kompania e ndërtimit ka ndërprerë punimet “S..... Co..... Spa” dhe ARRSH është duke zhvilluar procedurën e ritenderimit.

- **Me** Amendamentin nr. 2, datë 26.11.2021 (*Vendimi i KM nr. 444, datë 22.07.2021*) është shtyrë afati i disbursimeve deri në 30.06.2022. Referuar shkresës së disbursimit Ministria e Financave i është drejtuar BERZH në 12.04.2021 *ose 6 muaj më vonë se ARRSH ka paraqitur kërkesën e saj. (Me shkresën nr. 7721, datë 14.10.2020 ARRSH ka kërkuar shtyrje të afatit të kredisë së BERZH deri në 30.06.2022).*

Mosamendimi i marrëveshjes brenda afateve të përcaktuara është në kundërshtime me nenin 2 të ligjit nr. 8/2012, datë 09.02.2012 “*Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)*”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: ARRSH në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (ministria e linjës) dhe Ministrinë e Financave (si përfaqësuese e huamarrësit) të marrin masa që të bashkërendojnë punën dhe në çdo rast të kryejnë kërkesat për amendimin e marrëveshjeve të huave brenda afateve të marrëveshjeve duke ulur riskun e ndërprerjes së financimit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se deri në fund të periudhës objekt auditimi nuk u vendosën në dispozicion dokumentet e kërkuara si:

- “*Plani i veprimit për rivendosjen për komponentin I*” ku nënkupton planin e veprimit të rivendosjes për komponentin 1, të përfunduar nga ARRSH dhe të dorëzuar Bankës nga ARRSH-

ja në emër të Huamarrësit, plani i të cilit do të zbatohet në përputhje me kërkesat e politikës sociale dhe mjedisore të Bankës.

- “*Plani i veprimit për rivendosje për komponentin 2*” ku nënkupton planin e veprimit për rivendosje për komponentin 2, i cili do të bihet dakord me Bankën përpara datës së fillimit të transhit B.

- “*Planet e veprimit për rivendosje*” ku nënkupton planin e veprimit për rivendosje për komponentin 1 dhe planin e veprimit për rivendosje për komponentin 2.

- “*Strategjia e taksave rrugore*” ku nënkupton strategjinë e taksave rrugore për Shqipërinë, të përgatitur nga konsulentët për Huamarrësin. Strategjia e taksave rrugore do të formulojë politikën e taksave rrugore dhe do të identifikojë seksionet që mund të jenë të përshtatshme për taksim rrugor në Shqipëri.

- “*Studimi i qëndrueshëm i transportit*” ku nënkupton studimin e qëndrueshëm të transportit të përgatitur nga konsulentët për Huamarrësin. Politika e qëndrueshme e transportit do të identifikojë masat për përmirësimin e qëndrueshmërisë së sektorit të transportit në Shqipëri.

Mos vendosja në dispozicion e dokumenteve të mësipërme referuar Ligjit të marrëveshjes ARRSH bën me përgjegjësi stafin aktual. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 7-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: ARRSH të marrë masa për krijimin e arkivës për projektet me financim të huaj ku të arkivohen të gjitha dokumentet nga fillimi i projektit me qëllim dokumentimin e vijueshmërisë së projektit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se aktualisht Ekipi i Zbatimit të Projektit përbëhet nga staf i strukturës së ARRSH me profesion inxhinier konkretisht: nga përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja; një specialiste e Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja i cili ndjek zbatimin e kontratës së Fierit; një specialiste e Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Brendshme e cila referuar Urdhrit nr. 94 datë 18.06.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH përveç detyrave funksionale në këtë sektor do të ndjekë edhe detyrat e specialistes së Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja, detyra që lidhen me ndjekjen e projektit të ndërtimit të By Passit Vlorë.

Sipas VKM nr. 276 datë 16.05.2018 “*Për miratimin e strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar*”, këto njësi janë në varësi të Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes dhe nuk e kanë të specifikuar llojin e arsimimit të kërkuar për specialistët.

Referuar rregullores së brendshme nr. 7493/2, datë 04.09.2018 miratuar me vendim bordi nr. 10, datë 04.09.2018 detyrat e Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja kanë të bëjnë me marrjen e masave për të siguruar që punimet janë kryer në mënyrë të kënaqshme sipas kontratës.

Sektori i Menaxhimit të Projekteve të Huaja nuk ka në përbërjen e tij një specialist/ekonomist, dhe aktualisht ana financiare e projektit ndiqet nga specialistët e sektorit të financës në Drejtorinë e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës në kundërshtim me marrëveshjen financiare ku përcaktohet se njësi e zbatimit duhet të marrë masa për mbajtjen e llogarive të projektit, librave kontabël dhe hartimit të pasqyrave financiare të projektit.

Për sa më sipër është në kundërshtim me nenin 3 të seksionit 03 i ligjit nr. 8/2012, datë 09.02.2012 “*Marrëveshja e ratifikuar e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)*”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: ARRSH me qëllim eliminimin e problemeve të cilat mund të dalin si pasojë e mos ngritjes së njësisë së zbatimit të projektit sipas kushteve të përcaktuara dhe të rëna dakord

ndërmjet palëve në marrëveshje, si dhe referuar faktit se projekti është drejt përfundimit, të marrë masa që në të ardhmen të respektohet dhe përcaktohet struktura permanente e Njesisë së Zbatimit të Projektit me specialistët e fushës, sipas kushteve të specifikuara në marrëveshjet e ratifikuara.

4. Gjetje nga Auditimi: Referuar marrëveshjes së financimit, qëllimi i projektit të by passit të Fierit është të përmirësohet udhëtimi kohor dhe i sigurt, në veçanti përmes trafikut, si dhe për të lehtësuar kongjestionin dhe problemet mjedisore në qytetin e Fierit, ndërsa By-Passit i Vlorës do të ndihmojë në përmirësimin e integritit rajonal, në facilitetet e tregtisë, mbështetjen e zhvillimit të turizmit në pjesën jugore të Shqipërisë, përmirësimin e kushteve të transportit rrugor në zonën e Vlorës, reduktimi i ngjeshjes/ngarkesës/mbipopullimit në trafikut në qytetin e Vlorës si dhe në rrjetin rrugor të bregdetit jugor të Shqipërisë.

Objektivat e përcaktuara në marrëveshjen e ratifikuar për projektet e sipërpërmendura nuk janë objektiva konkrete dhe të matshme kjo pasi: nuk ka të dhëna të përcaktuara të kohës së shkurtuar me përfundimin e aksit të ri rrugor; nuk ka të dhëna krahasimore të kostos së operimit të automjeteve dhe të dhënave të sigurisë; lehtësimi i probleme mjedisore etj. duke e bërë të vështirë matjen e objektivave të përcaktuara në rast se punimet do të kishin përfunduar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.8/2012, datë 09.02.2012 “Marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)” ligjin nr. 80/2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)” dhe ligjin nr. 109/2014 datë 31.07.2014 “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By-Passin e Vlorës”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: ARRSH në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira në hartimin dhe miratimin e marrëveshjeve të financimit të marrë masa që për projektet që hartohen në të ardhmen të përcaktohen objektiva të qarta dhe të matshme, me synim monitorimin e saktë të përfitimeve që arrihen nga zbatimi i tyre.

Në vijimësi

5. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi rezulton se nuk është realizuar objektivi i përgjithshëm i marrëveshjeve të financimit:

- a. Ndërtimi i një by passit 22 km në qytetin e Fierit i cili referuar kontratës së punimeve civile për By Passin e Fierit punimet duhet të kishin përfunduar brenda datës 03.06.2018, por afati është shtyrë disa herë duke sjellë si pasojë shtyrjen në kohë të arritjes së objektivave dhe përfitimeve nga zbatimi i këtij projekti.
- b. Ndërtimi i një by passit 29 km në qytetin e Vlorës, i cili referuar kontratës së punimeve civile për By Passin e Vlorës, punimet duhet të kishin përfunduar në 30.06.2018, por afati është shtyrë, duke sjellë si pasojë shtyrjen në kohë të arritjes së objektivave dhe përfitimeve nga zbatimi i këtij projekti.

Nevoja për shtyrjen e afateve është argumentuar me problematikat që lidhen kryesisht me shpronësimet për pronat ku kalon gjurma e projektit, si dhe mos bashkëpunimi i Bashkisë Vlorë në lidhje me pajisjen me dokumentacionin e pronësisë për banorët që preken nga ndërtimi i By-Pass-it të Vlorës, problemeve ligjore me kontraktorin “S.....”, si dhe mungesa e financimit për By Passin e Fierit nga BEI si pasojë e vonësive të shkaktuara nga Qeveria Shqiptare për shtyrjen e marrëveshjes së financimit, veprime të cilat kanë dhënë ndikim negativ për të gjithë projektin.

Gjithashtu si pasoje e problematikave të hasura dhe vonesave në zbatimin e projektit nga ana e kontraktorit të punimeve mund të ngrihet pretendimi për llogaritje (claim) në të ardhmen pasi disa prej vonesave janë si pasojë e kontraktuesit.

Sa më lart është në kundërshtim me Ligjin Nr.8/2012, datë 09.02.2012 “Marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)”, Ligjin nr. 80/2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)”; Ligjin nr. 109/2014 datë 31.07.2014 “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By-Passin e Vlorës” dhe kontratat e zbatimit të punimeve nr. 9946 datë 08.11.2018, appendix to tender; nr. 9719 datë 05.11.2018, appendix to tender. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: ARRSH të marrë masa që për projektet në proces si dhe për projekte që do të financohen në të ardhmen, të zbatohen me korrektësi detyrimet kontraktore, duke zgjidhur praktikisht çështjet që kanë të bëjnë me shpronësimin për interes publik, problematika të cilat kanë lidhje me administrimin e pushtetit vendor, ndikimin në mjedis, si dhe problematika të cilat kanë lidhje me shtyrjen në kohë të afatit të disbursimeve etj., me synim minimizimin e riskut të vonesave, të cilat shoqërohen me mos arritjen e objektivave dhe kosto shtesë për Projektin.

Në vijimësi

6. Gjetja nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi nga ARRSH në rolin e Njësisë së Zbatimit të Projektit nuk ka dorëzuar tek Banka Evropiane e Investimeve informacion në përmbajtje dhe formë dhe kohën e specifikuar në Skedulën/Formularin A.2, ose siç është rënë dakord në kontratën e financimit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, neni 8, seksioni 8.01. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: ARRSH në rolin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit referuar kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen e financimit të projektit, me qëllim ecurinë e disbursimeve pa vonesa dhe përfundimin e Projektit në afatin e caktuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi ARRSH nuk ka mbajtur të regjistruara në sistemin e kontabilitetit libra dhe regjistra të rregullt llogarish, ku të pasqyrohen saktë hyrje të plota dhe të sakta për të gjitha transaksionet financiare, duke përfshirë shpenzimet në lidhje me Projektin dhe regjistra të kontratave të financuara nga shumata e huas, por veprimet financiare janë hedhur në programin “Excel”, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, neni 6, seksioni 6.07. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARRSH dhe Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrin masa për implementimin e një programi financiar, me qëllim evidentimin dhe pasqyrimin e saktë të veprimeve financiare, ecurinë e kontratave dhe çdo transaksioni që kryhet për Projektin.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Referuar kushteve të marrëveshjeve të financimit të Projektit parashikohet se, Huamarrësi do të garantojë që zbatuesi do t'i dorëzojë bankës pas përfundimit të secilit prej

viteve të tij financiar raportin vjetor të konsoliduar dhe pakonsoliduar të audituar të zbatuesit nga auditë të pavarur. Për periudhën nga fillimi i projektit deri në 31.12.2021, nuk është kryer asnjë auditim dhe të jetë paraqitur raport nga auditues të pavarur. Për sa më sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, neni 4, seksioni 4.01, dhe Ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, nenin 8, seksioni 8.02. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: ARRSH në rolin e Njesisë së Zbatimit të Projektit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për kryerjen e auditimit të veprimtarisë së Projektit nga auditues të pavarur, me qëllim respektimin e kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen financiare dhe njohjen me problematikat/rekomandimet e audituesve për përmirësimin e punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Referuar nenit 6, seksionet 6.01, dhe 6.04, të Ligjit nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, janë përcaktuar angazhimet të cilat duhet të implementohet nga ARRSH për disponueshmërinë e transheve A dhe B të kësaj marrëveshje. Lidhur me këtë situatë nga ARRSH nuk disponohet asnjë dokumentacion ku të vërtetohet se janë realizuar kushtet e parashkuara në marrëveshje për disponueshmërinë e transhit A dhe B edhe pse disbursimet për këto dy transhe kanë vazhduar nga donatori. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Nga ARRSH të merren masa në të ardhmen në projektet me financime të huaja, për zbatimin e të gjitha angazhimeve dhe kushteve për disponueshmërinë e fondeve me qëllim shmangien e vonesave për kryerjen e disbursimeve.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje mbi realizimin e disburimeve konstatohet se, në 15 raste janë hasur vonesa në lëvrimin e fondeve nga Banka e Shqipërisë në bankat e nivelit të dytë konkretisht në llogaritë speciale të hapura për Projektin “Ndërtimi i by-pass-eve Fier-Vlorë”. Kjo situatë ka ndodhur për arsye të bërjes aktiv të transhit nga MFE/Banka e Shqipërisë dhe kreditimit të transhit në bankat e nivelit të dytë. Vonesat në lëvrimin e fondeve janë në kundërshtim me ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për By-Pass-in e Vlorës”, neni 8, seksioni 8.01. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Nga ARRSH në rolin e Njesisë së Zbatimit të Projektit të marrë masat e duhura që, deri në përfundim të projektit por edhe për projekte të tjera që do të zbatohen prej saj, në rast se do të ketë vonesa në lëvrimin e fondeve nga Banka e Shqipërisë në llogaritë speciale në bankat e nivelit të dytë të bëjë me dije Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për zgjedhjen e kësaj problematike me qëllim shmangien e vonesave në procesin e disbursimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i nivelit të disbursimeve deri më datë 31.12.2021, të Projektit “Ndërtimi i By-pass-eve Fier-Vlorë” konstatohet se, për përfundimin e tij do të duhen fonde shtesë në shumën totale 2,834,313.02 Euro konkretisht:

a) Për përfundimin e kontratës së ndërtimit të punimeve të by-pass-it të Vlorës do të nevojiten fonde shtesë në shumën 2,195,593.08 Euro. Konkretisht për realizimin e kësaj kontrate financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 53,000,000 Euro nga të cilat është disbursuar shuma 41,114,098.94 Euro ose në masën 77.5%. Nga ky fond mbetet për t'u disbursuar shuma 11,885,901 Euro ndërkohë që për përfundimin e kësaj kontrate duhen fonde në shumën 14,081,494.08 Euro. Për financimin e kontratës së supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 700,000 Euro gjithashtu me amendimet e kontratës ka pasur edhe mbështetje buxhetore në shumën 3,158,500 Euro ku totali i financimit shkon në shumën 3,858,500 Euro nga të cilat është disbursuar shuma 3,126,585 Euro ose në masën 81%. Nga ky fond mbetet për t'u disbursuar shuma 731,915 Euro.

b) Për përfundimin e kontratës së ndërtimit të punimeve të by-pass-it të Fierit do të nevojiten fonde shtesë në shumën 224,062.34 Euro. Konkretisht për realizimin e kësaj kontrate financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 70,000,000 Euro nga të cilat është disbursuar shuma 68,562,437 Euro ose në masën 97.9%. Nga ky fond mbetet për t'u disbursuar shuma 1,437,563 Euro ndërkohë që për përfundimin e kësaj kontrate duhen fonde në shumën 1,661,625.34 Euro. Për financimin e kontratës së supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 858,210 Euro gjithashtu me amendimet e kontratës ka pasur edhe mbështetje buxhetore në shumën 1,621,959. Euro ku totali i financimit shkon në shumën 2,480,169.4 Euro nga të cilat është disbursuar shuma 2,480,169.4 Euro ose në masën 10%. Nga ky fond mbetet për t'u disbursuar shuma 414,657.6 Euro. Në lidhje me këtë situatë është parashikuar në marrëveshjet e financimit në rast se do të duhen fonde shtesë për përfundimin e Projektit do të mbulohej me financim nga Qeveria Shqiptare. Gjithashtu kjo situata ka ardhur si pasojë edhe e ndërrej së punimeve nga OE "S..... Co..... S.p.A". Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, "Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës", neni 8, seksioni 8.01 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

11.1 Rekomandimi: ARRSH në rolin e Njësisë së Zbatimit të Projektit të informojë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për sigurimin e fondeve shtesë për përfundimin e Projektit me qëllim shmangien e riskut për ndërprerjen e punimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i pagesave të TVSH-së të kryera nga Qeveria Shqiptare në 44 raste janë konstatuar vonesa në likuidimin e TVSH-së konkretisht, në 10 raste për kontratën e supervizionit të punimeve dhe 6 raste për kontratën e ndërtimit të punimeve të "By-pass-it të Vlorës" si dhe në 12 raste për kontratën e supervizionit të punimeve dhe 16 raste për kontratën e ndërtimit të punimeve të "By-pass-it të Fierit", pra këto pagesa nuk janë kryer brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", neni 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

12.1 Rekomandimi: ARRSH/Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrin masa për likuidimin në kohë të detyrime ndaj kontraktorëve për pagesat e TVSH-së me qëllim eliminimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe respektimin e kushteve kontraktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se janë hasur problematika gjatë procesit të shpronësimeve, të cilat kanë sjellë vonesa në zbatimin e punimeve. Vonesat e shkaktuara nga

procesi i shpronësimeve ngarkojnë me përgjegjësi ARRSH në rolin e agjencisë së zbatimit të projektit, e cila sipas marrëveshjeve të huas duhet të sigurojë të gjitha të drejtat mbi tokën dhe truallin ku do të kalojë projekti, të drejta të cilat duhen të sigurohen para fillimit të punimeve. Referuar pagesave të kryera për këtë qëllim, vlera e mbetur (detyrim) pa u paguar për shpronësime është 789,538,358 lekë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, neni 6, seksioni 6.01, gërma “c”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: ARRSH/Drejtorja e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës së bashku me Drejtorinë e Shpronësimeve të marrin masa dhe ndjekin në kohë problematikat e shkaktuara nga procesi i shpronësimeve si edhe të analizojnë detyrimin e pa paguar në shumën 789,538,358 lekë me qëllim eliminimin e detyrimeve të prapambetura dhe vazhdimin e përfundimit në afat të Projektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Raportimet për realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve janë dorëzuar në MFE ku në përgjithësi janë kryer sipas kuadrit rregullator ligjor por konstatohet se, në 8 raste për vitin 2016, në 4 raste për vitin 2017, në 8 raste për vitin 2018, në 5 raste për vitin 2019, në 3 raste për vitin 2020 dhe në 8 raste për vitin 2021, nga ARRSH nuk janë respektuar afatet për raportimin mbi realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve në MFE në zbatim të përcaktimeve të pikës 5.5, të Udhëzimit nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”. Gjithashtu konstatohet se, në 2 raste për vitin 2016, në 1 rast për vitin 2017, në 1 rast për vitin 2018, në 4 raste për vitin 2019, në 2 raste për vitin 2020 dhe në 2 raste për vitin 2021, nga ARRSH nuk është raportuar mbi realizimin e disbursimeve në MFE. Mosraportimi i realizimit të disbursimeve është në kundërshtim me Udhëzimit nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”. Për muajt që nuk ka pasur disbursime nuk është raportuar në MFE por është quajtur e ezauruar me raportimin vjetor të disbursimeve në të cilën pasqyrohet dhe përfshihet situata e disbursimeve për secilin muaj të vitit ushtrimor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandimi: ARRSH/Drejtorja e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrë masa që të raportojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë realizimin e disbursimeve financiare dhe shpenzimeve të Projektit brenda afateve të parashikuara në kuadrin rregullator ligjor përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Marrja në dorëzim e aksit kryesortë “By-pass-it të Fierit” nga Autoriteti Rrugor Shqiptar është kryer nëpërmjet procesverbalit të datës 19.07.2021, i mbajtur ndërmjet Komisionit të Marrjes në Dorëzim i ngritur në zbatim të urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së me shkresën nr. 7259/1 prot., datë 20.11.2014, dhe OE “C....G....C....ing Co” së bashku me Supervizorin e Punimeve J.V “S.....-T.....-SWS”. Deri më datë 31.12.2021, datë e cila përkon me fundin e vitit ushtrimor 2021, nga ARRSH nuk është bërë regjistrimi si aset të “Rrugës kryesore të by-pass-it të Fierit” në regjistrat e kontabilitet me veprim ekstra kontabël në momentin e marrjes në dorëzim referuar procesverbalit të datë 19.07.2021, dhe duke u bazuar në këtë regjistrim fillestar të kryhet regjistrimi përfundimtar në pasqyrat financiare të vitit 2021. Gjithashtu ky regjistrim nuk është kryer as në program financiar në kushtet kur nga ARRSH nuk disponohet

program financiar për mbajtjen e kontabilitetit. Regjistrimi si aset është i domosdoshëm që nga momenti në të cilën fillon jetën e dobishme aktivi si dhe llogaritja e amortizimit që nga momenti vendosjes në funksion (vlerë e cila mund të përlllogaritet deri në mbylljen e pasqyrave financiare). Ky regjistrim është kryer në muajin mars periudhë në të cilën përfundon afati për mbylljen e pasqyrave financiare për vitin 2021, të cilat janë depozituar pranë MIE dhe MFE me shkresën nr. 4094 prot., datë 29.03.2022. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 2, dhe Standardi Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 82-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: ARRSH/Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrë masa që, të kryej regjistrimin e aseteve të përfunduara të Projektit në regjistrat e kontabilitetit me veprim ekstra kontabël në momentin e marrjes së dorëzimit prej saj me qëllim përlllogaritjen e amortizimit në momentin në të cilën fillon jetën e dobishme aktivi dhe më pas të kryhet regjistrimi në pasqyrat financiare sipas vitit ushtrimor përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga Auditimi: Në kontratën me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Vlorë”, për periudhën objekt auditimi u konstatuan se, nga ana e punëdhënësit janë miratuar 26 (njëzetë e gjashtë) Urdhër Ndryshime por në disa prej tyre ka patuar vonesa në miratimin e tyre të cilat ndikojnë në realizimin e projektit në kohë dhe me cilësi. Konkretisht, urdhër ndryshimi nr.2 (VO.2) miratuar nga supervizori, Nr. 1174 datë 02.04.2020 është miratuar afërsisht pas 5 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr.51, datë. 25.11.2019, urdhër ndryshimi nr.6 (VO.6) miratuar nga supervizori, Nr. 1031 datë 13.02.2020 është miratuar afërsisht pas 4 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr.28, datë 03.06.2020, urdhër ndryshimi nr.8 (VO.8) miratuar nga supervizori Nr. 1174 datë 02.04.2020 është miratuar afërsisht pas 2 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr. 28, datë 03.06.2020, urdhër ndryshimi nr.10 (VO.10) miratuar nga supervizori Nr. 1266 datë 30.04.202 është miratuar afërsisht pas 1,5 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr. 28, datë 03.06.2020. Për sa më sipër, vonesat në miratimin e urdhër ndryshimeve nga ana e Këshillit Teknik, ndikojnë në realizimin e punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Këto vonesa nuk bëjnë të mundur përfundimin e projektit sipas ligjit nr. 80/2012 datë 13.09.2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)” neni 6, pika 6.02 “Përmbushja e projektit” dhe kontratës së zbatimit të punimeve nr. 9719 prot. datë 05.11.2018. “Kushte të Përgjithshme të Kontratës” nën klauzola 1.1.3.3 “Koha e përfundimit” (Time for Completion). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet 60-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: ARrSh të marri masa për shmangen e vonesave në miratimin e urdhër ndryshimeve duke përcaktuar afate kohore për miratimin e tyre nga të gjitha shkallët dhe ana e Këshillit Teknik në një kohë sa më optimale, për realizimin e projekteve sipas afateve të përcaktuara në kontratat e tyre.

Në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “Ndërtimi i By-Pass-it Fier”, sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe OE “C....G....C....” -Kuvajt me nr. 9719 datë 05.11.2018, për zbatimin e punimeve civile, me vlerë me vlerë 37,944,221.56 Euro pa TVSH, me afat

përfundimi të punimeve 455 ditë, realizimi i punimeve civile deri në fund të periudhës së audituar është në masën 99%. Nga auditimi i dokumentacionit dhe verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (mbikëqyrësi i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm (*IPC nr. 27*) volume pune të pasqyruara në librezat e masave dhe të situacionuara por të pakryera në fakt, për 3 (tre) zëra punimesh, në shumën 8,348.38 Euro pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 21.07.2010. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 60-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e ARrSh të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 8,348.38 Euro pa TVSH ndaj sipërmarrësit OE “C....G....C....”-Kuvajt, për punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr. 9719 datë 05.11.2018 me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Fier”.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “*Ndërtimi i By-Pass-it Vlorë*”, sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh) dhe BOE “G.....” Shpk & “I.... di C..... Ing. E. M.....” me nr. 9946 datë 08.11.2018, për zbatimin e punimeve civile, me vlerë me vlerë 35,874,357.4 Euro pa TVSH, me afat përfundimi të punimeve 823 ditë, realizimi i punimeve civile deri në fund të periudhës së audituar është në masën 92%. Nga auditimi i dokumentacionit dhe verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (mbikëqyrësi i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm (*IPC nr. 13*) volume pune të pasqyruara në librezat e masave dhe të situacionuara por të pakryera në fakt deri në këtë fazë të projektit, për 2 (dy) zëra punimesh, në shumën 59,904 Euro pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 22.11.2013, Kreu, “Detyrimet e kontraktuesit” shtojca 1 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, neni 7, “Detyrime të Përgjithshme”, pika 7.4, Shtesa e kontratës Nr. 5 datë 12.11.2018 artikulli 4, “Qëllimi i punimeve” “Scope of Work” pika 4.2.2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 60-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: ARrSh dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa për reflektimin e volumeve të punimeve të situacionuara por të pa kryera në fakt, në situacionin pasardhës deri në atë përfundimtar në vlerën 59,904 Euro pa TVSH e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit deri në këtë fazë të projektit, të përfutuara më tepër nga sipërmarrësi i punimeve sipas kontratës nr. 9946 datë 08.11.2018. Në rast se këto reflektime nuk kryhen deri në situacioni përfundimtar ana e ARrSh të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës.

Menjëherë e në vijimësi

C.2.MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

